REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE PLANIFIKIMIT STRATEGJIK

RELACION

MBI AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR TË NËNSHKRUAR KONTRATËN E GRANTIT TË PROJEKTIT ''RIVITALIZIMI I MJEDISEVE ATRAKTIVE TURISTIKE NË FSHATIN TURISTIK ROSHNIK''

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat,në kuadër të Skemës së Granteve për Zhvillimin Rajonal,me mbështetjen financiare të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Agjencisë Austriake për Zhvillim, në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit,është përzgjedhur fituese e grantit prej 15,000,000 lekësh për projektin ''RIVITALIZIMI I MJEDISEVE ATRAKTIVE TURISTIKE NË FSHATIN TURISTIK ROSHNIK''.

Projekti më sipër është miratuar në parim nga Këshilli Bashkiak Berat më VKB nr. 71 datë 18.10.2021.

Nga ana e Donatorëve kërkohet miratimi i Këshillit Bashkia Berat për autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Berat për të nënshkruar Kontratën e Grantit të Projektit.

Do të kërkonim nga ana juaj, autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Berat për të nënshkruar në emër të Bashkisë Berat Kontratën e Grantit për pjesëmarrjen e Bashkisë Berat në projektin'RIVITALIZIMI I MJEDISEVE ATRAKTIVE TURISTIKE NË FSHATIN TURISTIK ROSHNIK''.

Ju faleminderit,

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Adresa:Blvd. "Republika 2", Berat 5001.Shqipëri,Tel /00355(0) 2 32 34 935,
Ëebsite: ëëë.bashkiaberat.gov.al, Email : info@bashkiaberat.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

DREJTORIA E ARSIMIT

RELACION MBI MIRATIMIN E BURSAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE PËR VITIN ARSIMOR 2021-2022

Të nderuar këshilltarë

Mbështetur në VKM nr.666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike",i ndryshuar me VKM Nr.854, date 24.12.2019 , "Për shtesa dhe ndryshime në VKM nr.666, datë 10.10.2019, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike",

a) në pikën **9** të të cilit shprehimisht citohet se : "Bursat e nxenesve për vitin e parë shqyrtohen dhe miratohen nga Këshilli Bashkiak sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të bursës/kuotës ushqimore "

b) Në pikën **4** të të cilit shprehimisht citohet se : " Njesitë e vetëqeverisjes vendore , për uljen e nivelit të braktisjes shkollore për nxënësit që janë rregjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor , si dhe nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar.

c) Në pikën **10.1.** të të cilit shprehimisht citohet se:" Bursat e nxënësve për vitin e dytë e lart rishqyrtohen dhe miratohen çdo vit nga Këshilli Bashkiak, sipas vendodhjes territoriale e administrative të shkollave profesionale apo konvikteve ku janë vendosur nxënësit, përfitues të bursës/ kuotës ushqimore , sipas planit të bursave të miratuara në vitin paraardhes nga Këshilli Bashkiak i njesive të vetëqeverisjes vendore "

Gjithashtu duke u mbeshtetur në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nr. 19590 dt 8.11.2021 "Mbi planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin vitin e parë në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2021-2022" **(46 bursa janë planifikuar për Bashkinë Berat)**

Shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit , nr.5204/61 dt 24.11.2021 "Mbi planin e numrit të bursave për nxënësit , të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të AP, per vitin 2021-2022 **(100 bursa janë planifikuar për Bashkinë Berat)**

Komisioni për verifikimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit për bursat e nxënësve të arsimit parauniversitar i ngritur nga Kryetari i Bashkisë me urdhër nr.584 dt 25.10.2021, mori në shqyrtim të gjitha kerkesat për bursa të dorezuara nga nxënësit e AML.

Pas verifikimeve komisioni hartoi listen e përfituesve sipas kritereve të percaktuara në ligj.

Në perfundim të procesit u vendos që të propozohen për miratim të bursës së plotë për 74 aplikante për herë të parë, 61 aplikantë nxënës të viteve të dyta e lart që kanë qënë nxënës përfitues në vitin shkollorë 2020-2021 dhe 51 përfitues të propozuar nga ZVA në shkresën me nr.1595 prot date 20.12.2021 si fëmijë me tendencë braktisjeje të arsimimit bazë për arsye ekonomike.

Gjithsej janë 186 (njëqind e tetëdhjetë e gjashtë) nxënës të cilët plotësojnë kriteret për të qënë përfitues burse.

Po ju paraqesim për miratim dhënien e bursave të plota për nxenesit , të cilët plotesojnë kriteret përkatese për të qënë përfitues të bursës bazuar në ligj dhe në planin e percaktuar nga ministritë përkatëse , sipas listës bashkëlidhur:

DREJTORI

Klodiana HOXHA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DREJTORIA E ARSIMIT
BASHKIA BERAT

Lista e aplikantëve për herë të parë që janë përfitues të bursës

per vitin shkollore 2021-2022

	Nr	Emer Mbiemer	Shkolla	Klasa	Statusi	Shenime
		Kriter Ekonomik (Te rinj)				
1	1	Haki Kasemi	Shkolla Tregtare Vlore	11-te	I ri	
2	2	Florenc Kurti	Stiljano Bandilli	11-te	I ri	
3	3	Atem Braho	Stiljano Bandilli	10-te	I ri	
4	4	Stela Kote	Babe Dude Karbunara	10-te	I ri	
5	5	Klajdi Aliaj	Stiljano Bandilli	12-te	I ri	
		Kriter invaliditeti (Te rinj)				
6	1	Enrik Kadena	Ajet Xhindole	11-te	I ri	
7	2	Jemin Fatia	Shyqyri Lakra	11-te	I ri	
8	3	Xhezair Xhaferas	Shyqyri Lakra	10-te	I ri	
9	4	Gersi Xhaxho	Kristaq Capo	11-te	I ri	
10	5	Marsilda Zeka	Riza Mulita	11-te	I ri	
11	6	Fatime Rapanj	Riza Mulita	12-te	I ri	
12	7	Ledjana Mbrakulli	Riza Mulita	12-te	I ri	
13	8	Alina Manuka	Babe Dude Karbunara	10-te	I ri	
14	9	Selina Vrapi	Babe Dude Karbunara	11-te	I ri	
15	10	Loredana Nishani	Babe Dude Karbunara	12-te	I ri	
16	11	Marsel Hodo	Stiljano Bandilli	13-te	I ri	
17	12	Florjado Cankaj	Kristo Isak	12-te	I ri	
18	13	Sara Zenuni	Shyqyri Lakra	10-te	I ri	
		Jetim(Te rinj)				
19	1	Violeta Balla	Babe Dude Karbunara	10-te	I ri	
		Me nje Prind (Te rinj)				
20	1	Ketrina Kapllani	Kristaq Capo	10-te	I ri	
21	2	Kamila Toska	Kristaq Capo	10-te	I ri	
22	3	Aleksandra Gjika	Kristaq Capo	10-te	I ri	
23	4	Keida Demiraj	Kristaq Capo	11-te	I ri	
24	5	Megi Sakolli	Kristaq Capo	11-te	I ri	
25	6	Fiorela Hoxha	Kristaq Capo	11-te	I ri	
26	7	Kleo Veliaj	Kristaq Capo	12-te	I ri	
27	8	Bejde Civeja	Kristaq Capo	11-te	I ri	
28	9	Safije Delibashi	Riza Mulita	12-te	I ri	
29	10	Haxhi Hena	Riza Mulita	10-te	I ri	
30	11	Eljo Isufaj	Babe Dude Karbunara	11-te	I ri	
31	12	Desara Nazeraj	Babe Dude Karbunara	12-te	I ri	
32	13	Tea Braho	Babe Dude Karbunara	12-te	I ri	
33	14	Nexhmije Abazi	Babe Dude Karbunara	12-te	I ri	
34	15	Vilson Toska	Naim Frashri Durres	10-te	I ri	
35	16	Redjon Zhuri	Ajet Xhindole	11-te	I ri	
36	17	Ornela Toska	Shyqyri Lakra	12-te	I ri	
37	18	Noemi Mejdani	Ajet Xhindole	10-te	I ri	

38	19	Eljo Cela	Stiljano Bandilli	10-te	I ri	
39	20	Aleksander Lushka	Stiljano Bandilli	10-te	I ri	
40	21	Oert Dosti	Stiljano Bandilli	11-te	I ri	
41	22	Sami Lilaj	Kristo Isak	11-te	I ri	
42	23	Edra Kurti	Kristo Isak	10-te	I ri	
43	24	Seldi Sakaj	Stiljano Bandilli	10-te	I ri	
44	25	Ardit Salla	Koco Brisku	10-te	I ri	
45	26	Anteo Canko	Koco Brisku	10-te	I ri	
46	27	Erald Tabaku	Koco Brisku	12-te	I ri	
47	28	Orgito Lilo	Koco Brisku	12-te	I ri	
		Kriteri I vendbanimit (Te rinj)				
48	1	Redjan Komshiu	Shyqyri Lakra	11-te	I ri	
49	2	Bledar Toska	Stiljano Bandilli	11-te	I ri	
		Statusi te Verbrit (Te rinj)				
50	1	Alban Dollani	Koco Brisku	11-te	I ri	
51	2	Klauel Kotollaku	Stiljano Bandilli	12-te	I ri	
		Pakicat Kombetare (te rinj)				
52	1	Klejdi Sheko	Kristo Isak	10-te	I ri	
53	2	Lorenc Zhupa	Kristo Isak	10-te	I ri	
54	3	Brunilda Boboci	Kristo Isak	10-te	I ri	
55	4	Erisa Dulla	Kristo Isak	10-te	I ri	
56	5	Nurjada Roli	Kristo Isak	10-te	I ri	
57	6	Jolanda Hasani	Kristo Isak	10-te	I ri	
58	7	Rei Daullxhiu	Kristo Isak	10-te	I ri	
59	8	Kristo Myrteli	Kristo Isak	10-te	I ri	
60	9	Asia Cingo	Kristo Isak	10-te	I ri	
61	10	Francesko Kobuzi	Kristo Isak	10-te	I ri	
62	11	Megina Bobobci	Kristo Isak	10-te	I ri	
63	12	Alehandro Etemaj	Kristo Isak	10-te	I ri	
64	13	Klajdi Sharavolli	Stiliano Bandilli	10-te	I ri	
65	14	Ergi Merdari	Stiliano Bandilli	11-te	I ri	
66	15	Matiel Llano	Stiliano Bandilli	10-te	I ri	
67	16	Besian Llano	Stiliano Bandilli	10-te	I ri	
68	17	Floerd Kungulli	Stiliano Bandilli	10-te	I ri	
69	18	Petref Hodo	Stiliano Bandilli	10-te	I ri	
		Kriteri I Rezultateve te arritura				
70	1	Fjoralba Hyskaj	Kristo Isak	13-te	I ri	
71	2	Higerta Kanaci	Kristo Isak	11-te	I ri	
72	3	Lorenc Cela	Kristo Isak	13-te	I ri	
73	4	Manuela Dosti	Kristo Isak	10-te	I ri	
74	5	Besim Papa	Kristo Isak	10-te	I ri	

74 nxenes aplikant per here te pare nga këta 37 nxenes jane ne klasen e 10-te

37 nxenes aplikantë per here te pare nga shkollat profesionale nga keta 24 jane klasa e 10-te

37 nxenes fitues aplikantë per here te pare nga shkollat e mesme te pergjithsme
nga keta 13-të nxenes jane ne klasen e 10-të

Lista e nxënësve ish përfitues të bursës për vitin 2020-2021 të cilëve nuk I kanë ndryshuar kriteret

	Nr	Emer Mbiemer	Shkolla	Klasa	Statusi	Shenime
		Kriter Ekonomik (Ish perfitues)				
1	1	Qani Kubeja	Kristaq Capo	12-te	ish perfitues	
2	2	Arsion Flataraku	Kristaq Capo	12-te	ish perfitues	
3	3	Anelza Bufi	Bab Dud Karbunara	12-te	ish perfitues	
4	4	Xhulja Kotollaku	Bab Dud Karbunara	12-te	ish perfitues	
5	5	Lorena Guce	Bab Dud Karbunara	12-te	ish perfitues	
6	6	Petref Jenishi	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
7	7	Vilson Kurti	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
8	8	Ervis Kala	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
9	9	Endri Muska	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
		Kriter invaliditeti (Ish perfitues)				
10	1	Emili Kazazi	Ajet Xhindole	12-te	ish perfitues	
11	2	Emirhan Lato	Ajet Xhindole	12-te	ish perfitues	
12	3	Veliko Sheme	Bab Dud Karbunara	11-te	ish perfitues	
13	4	Refit Marra	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
14	5	Hakli Mucogllava	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
		Me nji Prind (Ish perfitus)				
15	1	Mimoza Hysenji	Ajet Xhindole	11-te	ish perfitues	
16	2	Rexhina Rotani	Shyqyri Lakra	11-te	ish perfitues	
17	3	Andi Korro	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
18	4	Klajdi Ymeraliaj	Shyqyri Lakra	12-te	ish perfitues	
19	5	Orgito Sefa	Stiliano Bandilli	12-te	ish perfitues	
20	6	Denis Toska	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
21	7	Marsela Calaj	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
		Kriteri Paraplegjik				
22	1	Fabiola Zeneli	Ajet Xhindole	11-te	ish perfitues	
23	2	Markeljan Gjata	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
		Kriteri I vendbanimit				
24	1	Shpetim Xheja	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
25	2	Albert Pano	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
26	3	Muhamed Carkanji	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
27	4	Myfjord Zykollari	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
28	5	Rosela Toska	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
		Pakicat Kombetare				
29	1	Marselino Kotorri	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
30	2	Xhejson Brushi	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
31	3	Brisilda Nazifi	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	

32	4	Eljon Shtembari	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
33	5	Kristos Pema	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
34	6	Kristjana Anastasiu	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
35	7	Anisa Roli	Kristo Isak	11-te	ish perfitues	
36	8	Sara Caco	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
37	9	Ledjon Fusha	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
38	10	Luis Kobuzi	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
39	11	Klaudio Haruni	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
40	12	Ramadan Hodo	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
41	13	Elisabeata Sheko	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
42	14	Brunilda Meleqi	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
43	15	Eralda Hoxha	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
44	16	Gabriella Cune	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
45	17	Arkeo Kobuzi	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
46	18	Laura Arapi	Kristo Isak	12-te	ish perfitues	
47	19	Stela Broka	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
48	20	Mynevere Taipi	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
49	21	Sheqere Kasollja	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
50	22	Edison Sali	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
51	23	Fjorela Fusha	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
52	24	Gabriel Cuni	Kristo Isak	13-te	ish perfitues	
53	25	Ylvi Kovaci	Stiliano Bandilli	13-te	ish perfitues	
54	26	Daniel Lushi	Stiliano Bandilli	12-te	ish perfitues	
55	27	Xhuljano Bardhi	Stiliano Bandilli	12-te	ish perfitues	
56	28	Hyrije Hoxhaj	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
57	29	Samira Hoxhaj	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
58	30	Franko Kungulli	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
59	31	Klevisio Kanani	Stiliano Bandilli	11-te	ish perfitues	
60	32	Mario Brahimi	Stiliano Bandilli	12-te	ish perfitues	
61	33	Klevis Kungulli	Stiliano Bandilli	13-te	ish perfitues	

61 nxenes fitues burse si ish perfitues qe nuk I kane ndryshuar kriteret MASR dhe MFE

12 nxenes ish perfitues nga gjimnazet e pergjithshme

49 nxënës aplikantë që kanë fituar bursën si ish perfitues që nuk I kanë ndryshuar kriteret nga shkollat profesionale

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT , SPORTIT DHE RINISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR KORÇË
ZYRA VENDORE ARSIMORE BERAT

Lista e nxënësve me tendencë braktisjeje në arsimin bazë që duhet të përfitojnë bursë për arsye ekonomike për vitin mësimor 2021-2022

Nr	Emër	Atësia	Mbiemër	Shkolla	Klasa
1	Dashmir	Afrim	Maloku	9-vjeçare "22 Tetori"	V
2	Alisia	Afrim	Maloku	9-vjeçare "22 Tetori"	VIII
3	Ajete	Kastriot	Gjinollari	9-vjeçare "22 Tetori"	VI
4	Alesia	Engjell	Muka	9-vjeçare "22 Tetori"	IX
5	Ermir	Engjell	Muka	9-vjeçare "22 Tetori"	VII
6	Denada	Dorjan	Koreci	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	I
7	Migel	Shpëtim	Keci	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	I
8	Nexhmije	Rodolf	Hodo	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	I
9	Amanda	Shpëtim	Kovaçi	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	II
10	Melisa	Maksim	Brushi	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	II
11	Kasandra	Nuri	Fusha	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	III
12	Ramadan	Zabelin	Kazanxhiu	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	III
13	Selvia	Alban	Gjata	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	IV
14	Adelajda	Dritan	Metani	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	V
15	Sara	Zenel	Fusha	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	V
16	Eriken	Adrian	Fusha	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	VI
17	Brunilda	Artan	Shkurti	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	VI
18	Anxhelina	Ilir	Koreci	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	VII
19	Natalia	Taulant	Tufa	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	VII
20	Izaura	Klodian	Gjata	E mesme e bashkuar "Shyqyri Lakra"	VIII
21	Orgito	Alfred	Hoxhaj	9-vjeçare "Hasan Ngjela"Veterik	I
22	Samuel	Arben	Arapi	9-vjecare "Thimi Tani"	III
23	Klevis	Stavri	Mice	9-vjecare "Thimi Tani"	V
24	Aleksander	Gentjan	Kanani	9-vjecare "Thimi Tani"	VI
25	Elidion	Burhan	Rubani	9-vjecare "Thimi Tani"	VII
26	Sabian	Afrim	Berisha	9-vjecare "Thimi Tani"	VII
27	Rafaela	Arben	Fusha	9-vjecare "Thimi Tani"	V
28	Samuel	Shkelqim	Daullxhiu	9-vjecare "Thimi Tani"	VII
29	Emiljano	Fejzi	Sherri	9-vjecare Paftal	VI
30	Hristina	Xxx	Toraj	9-vjecare Paftal	VII
31	Maksi	Gazment	Metani	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	IV
32	Ramadan	Fatos	Zeqiri	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	VII
33	Anxhelo	Kudret	Myrteli	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	VI
34	Besjana	Leonard	Metani	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	IX

35	Vionis	Bashkim	Yzeiri	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	VIII
36	Aleksandros	Vullnet	Myrteli	9-vjeçare"Shaban Sollaku" Moravë	IX
37	Xhensila	Fatmir	Ymeraj	9-vjeçare Otllak	II
38	Anxhelo	Azbi	Zanellari	E mesme e bashkuar Roshnik	I
39	Esmeralda	Shpëtim	Zylali	E mesme e bashkuar Roshnik	VI
40	Vitrina	Bashkim	Zanellari	E mesme e bashkuar Roshnik	VIII
41	Ergisa	Blerti	Doraci	E mesme e bashkuar Roshnik	IX
42	Sonilda	Feçor	Deli	E mesme e bashkuar Roshnik	IX
43	Anisa	Fatos	Kiptiu	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	II
44	Xhorxhina	Ismail	Diko	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	VI
45	Resilda	Uliks	Shoshari	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	IV
46	Alehandro	Hysenj	Zylali	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	IV
47	Adelajda	Kujtim	Liço	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	VI
48	Vanesa	Astrit	Çekini	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	VII
49	Dejvid	Sazan	Boboçi	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	VI
50	Eljona	Aurel	Etemaj	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	II
51	Nexhmie	Renato	Çekini	9-vjeçare"Xhemal Çekini"	V

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR
MIRATIMIN E SISTEMIT TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË QYTETIN E BERATIT

Të nderuar këshilltar !

Paraqesim për miratim paketën fiskale për vitin 2022.
Ky propozim vjen në kuadër të gjithë procesit të buxhetimit dhe mbeshtetur në urdhërin e Kryetarit nr.658 datë 03.12.2021 për ngritjen e grupit të punës për draftimin e saj me të gjithë elementet e nevojshëm dhe të domosdoshëm.
Si dokument i domosdoshëm i gjithë procesit të planifikimit, grupi i punës pasi analizoi, rishqyrtoi dhe mori në konsideratë gjithë ndryshimet e bëra në periudhen nga paketa e mëparshme e miratuar me VKB nr.60 datë 18.12.2019 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Beratit", të ndryshuar, konkludoi si më poshtë:
Në periudhën nga paketa ekzistuese e vitit 2020, kanë ndodhur ndryshime të cilat janë diktuar nga situata pandemike. Kanë ndodhur ndryshime për lehtësime tatimore për tarifat dhe taksat vendore nisur nga ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në këtë periudhë dy vjeçare.
Sa me sipër dhe me qëllim që këto ndryshime të mos kenë referenca VKB të ndryshme por të jetë një dokument i unifikuar për ta bërë lehtësisht të kuptueshme dhe një dokument tërësisht të konsoliduar grupi i punës arrin në këto përfundime:
Paketa e re fiskale që sjellim për miratim të jetë e hartuar si një dokument cilësor bashkëkohor dhe tërësisht i bazuar në legjislacionin e përditësuar.
Nuk sjell ndryshime të tarifave vendore krahasimisht me paketën ekzistuese.
Saktëson qartësisht çdo tarifë duke u bërë lehtësisht e identifikueshme dhe e qarte për të gjitha llojet e tatimpaguesve individë apo dhe biznese.
Përshtat emërtimin e përditësuar në të njëjtën shkallë me emërtesat e klasifikimit të bizneseve që ka Drejtoria Rajonale e Tatimeve.
Bën pjesë tarifat e shërbimeve të shtuara të cilat duke filluar nga 01.01.2022 do të ofrohen nga bashkia sikurse janë tarifat e shërbimit të varrimit të cilat nuk ndryshojnë por do të arkëtohen në bashki.
Për të tarifuar aty ku shërbehet është ndryshuar referenca e përcaktimit te tarifës së mirëmbajtjes së kanaleve vaditës jo me për familje por për ha sipërfaqe të ujitur. Kjo për të tarifuar aty ku shërbehet dhe sipas sasisë së shërbimit që ofrohet.
Në formën e dokumentit për ti dhënë vlerën dhe rendësin qe ajo ka, është ndryshuar struktura e ndërtimit si dhe janë përcaktuar qartë për çdo tarife e taksë drejtoritë

47

përgjegjëse edhe agjentet tatimore qe e implementojnë atë. Kjo në funksion të rritjes së përgjegjshmërisë qoftë për përmbajtjen por dhe implementimin e saj.
Tarifa e vendeve të rezervuara të parkimit e cila nuk është përditesuar në paketën e vitit 2020 është sjellë një ndryshim në vlerë vjetore nga 12,000 lekë në 36,000 lekë.
Për hartimin e saj grupi i punës ka tërhequr mendimin te gjithë administratës në bashki dhe në dëgjesat publike të organizuara jo vetëm nga administrata por edhe nga dëgjesat e organizuara nga Këshilli Bashkiak.
Nga ana e strukturës së ndërtimit të saj paketa është ndërtuar në konceptin juridik, me nene dhe jo në formë teksti.

Luçiano Bojaxhiu, Drejtor i Planifikimit Urban, Lejeve dhe Monitorimit të Investimeve

Sokol Toska, Drejtor i Taksave dhe Tarifave

Erlin Kuçi, Drejtoria e Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve

Klodiana Hoxha, Drejtoria e Arsimit

Bledar Cili, Drejtoria e Bujësisë

Ervin Hoxhallari, Drejoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi

BASHKIA BERAT

RELACION

PËR PROJEKT BUXHETIN VJETOR 2022 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM PËRFUNDIMTAR

2022 - 2024

Përmbajtja e Plan Buxhetit 2022 dhe PBA Përfundimtare 2022-2024

Mesazhi Kryetarit të Bashkisë Berat për buxhetin e vitit 2022

1. Hyrje

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

2. Buxheti i Vitit 2022 dhe Afatmesëm i Bashkisë Berat 2022-2024

2.1 Situata e njësisë së vetëqeverisjes vendore

2.2 Informacion përmbledhës për përgatitjen e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA 2022 – 2024

2.3 Të ardhurat dhe shpenzimet publike të bashkisë berat në vitet 2022-2024

3. Të ardhurat dhe shpenzimet publike të bashkisë berat në vitet 2022-2024

3. 1 Plani i të ardhurave në bashkinë berat për vitin 2022 dhe PBA 2022-2024

3.1.1 Tw ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 dhe PBA 2022-2022

3.1.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme

3.1.3 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

3.1.4 Transferta të Kushtëzuar për funksione të deleguara.

3.1.5 Fonde për Ndihmën Ekonomike për Pagesën e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe për Përkujdesjen Shoqërore

3.1.6 Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

3.2 Plani i shpenzimeve të bashkisë berat për vitin 2022 dhe periudhën afatmesme 2022-2024

3.2.1 Plani i shpenzimeve sipas ndarjes ekonomike

3.2.2 Informacion mbi detyrimet e prapambetura dhe të krijuara

3.2.3 Buxheti i vitit 2022 dhe afatmesëm 2022-2024 për programet buxhetore

MESAZHI I KRYETARIT TË BASHKISË BERAT PËR BUXHETIN E VITIT 2022

I nderuar z. Ervin CECA, Kryetar i Këshillit të Bashkisë Berat!

Të nderuar këshilltarë!

Dokumenti i plan buxhetit të vitit 2022 dhe PBA 2022-2024, i sjelle për miratim, ka marre gjithë përgjegjshmërinë e domosdoshme ne te gjithë hapat e hartimit te tij dhe tanimë është një dokument i plote ne formën e përmbajtje, në përmbushje të vizionit të Strategjisë së Zhvillimit të Ekonomisë Lokale të Bashkisë Berat.

Me moton mbi të cilën orientojmë zhvillimin ekonomik, ambicies sonë për të përmirësuar jetën e komunitetit dhe në përgjigje te përmbushjes te kërkesave në rritje të tij, ky dokument materializon objektiva të qarta, të matshme dhe të implementueshme, si në planin afat shkurtër dhe në afatgjatë për një periudhe tre vjeçare.

Ne përmbushje te legjislacionit ne fuqi, te vendimeve te Këshillit Bashkiak, dhe metodologjisë se planifikimit për treguesit ekonomik e financiar, i shoqëruar me Paketën Fiskale dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm argumentues, materializon moton: **Buxhet i konsoliduar-Zhvillim i Qëndrueshëm.**

Për më tepër pasqyron objektiva ne rritje krahasuar me periudhën para pandemike dhe ruan stabilitetin financiar te Bashkisë. Kjo pasi treguesit e realizuar kane shërbyer si një baze e rëndësishme për planifikimin e treguesve te tij.

Ai vjen pas një sere arritjesh te cilat janë materializuar ne infrastrukture, ne arsim, dhe ne jetën e komunitetit nëpërmjet investimeve te realizuara e atyre ne vijim, zgjerimit te shërbimeve, përmirësimit dhe shtimit cilësor te mirëmbajtjes se objekteve arsimore ne gjithë territorin e bashkisë, përmirësimin e jetës kulturore nëpërmjet shtimit te aktiviteteve dhe gjallërimit te jetës.

Jo me pak ndjeshmëri dhe produktivitet, janë ndërhyrjet për në fushën e mirëmbajtjes apo të pastrimit, mirëmbajtjes e shtimi i ndriçimit publik, përmirësimi e sistemit te ujitjes apo te rrugëve rurale e atyre me asfalt ne qytet.

Gjithçka e prekshme flet me shume se këto rreshta nëpërmjet te cilëve do te nënvizonim:

- Shërbimin e zjarrfikëses se Bashkisë te ri konstruktuar e pajisur me mjete te reja e ambiente bashkëkohore, ndërtimin e Qendrës Rinore ne Qytet, cilësinë e shërbimit ne kopshte e çerdhe, mirëmbajtjen e ambienteve shkollore, pastrimin e hapësirave urbane, landfillin e te tjera investime qe janë duke u nisur apo ne përfundim.

Gjithashtu, është shumë ambicioz krahasimisht me buxhetet e mëparshme dhe kjo pasi :

1- Shton shërbimet qe do te përballohen nga Buxheti i bashkisë sikurse është mirëmbajtja e varrezave publike dhe shërbimi i varrimit ne qytet.
2- Krahas shtimit te shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve arsimore, kopshte e çerdhe, planifikon investime ne rikonstruksion te disa objekteve me shtrirje territoriale ne gjithë territorin e bashkisë.

3- Planifikon rritje te shpenzimeve për bujqësinë sidomos ne sistemin e ujitjes dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues me vëmendje te veçantë ne ato territore ku ka një bujqësi intensive por dhe ne zonat e tjera duke ndërhyrë me riparimin e sistemit te ujitjes aty ku ekziston. Ne bujqësi ky buxhet është me i mire kalkuluar por dhe i detajuar për çdo njësi administrative shprehur ne anekset e pasqyrave te buxhetit për çdo njësi shpenzuese.
4- Vjen me nje strukture administrative te formatuar mbi përvojën e përfituar, ndryshime këto ne funksion te shtimit dhe përmirësimit te cilësisë se shërbimeve qe i ofrohen komunitetit.
5- Miradministrimi financiar nuk është një slogan teorik por i materializuar ne efektivitetin e shpenzimeve te realizuar si dhe ne fuqizimin e kapaciteteve qofte ne kapital njerëzor ashtu dhe ne mjete. Theksi i shtimit te te cilave krijoji domosdoshmërinë e krijimit te sektorit te transportit pjese e Agjencisë se shërbimeve.

Sfida qe ne u përballëm për te konsoliduar financat e Bashkisë Berat edhe pse ne një kohe te shkurtër, tashme quhet e tejkaluar. Performanca financiare e Bashkisë e materializon këtë sukses, ndaj ne vendosim te tjera objektiva me te larta për te siguruar qëndrueshmërinë financiare dhe implementuar shume nga objektivat tona te mandatit.

Eliminimi i një borxhi sa tre buxhete së bashku, dhe çlirimi i financave te bashkisë prej tyre, vërtetë na ka penguar për te realizuar edhe me shume por ne kemi arritur te përmbysim raportet ne sensin pozitiv sidomos ne treguesit e burimeve te financimit. Ndaj buxheti i vitit 2022 me plote te drejte ne historinë financiare te Bashkisë Berat është **i pari buxhet ku të ardhurat e veta janë ne indeks me të madh se të ardhurat nga transferat.**

Edhe ne vitin 2020, po ashtu edhe ne buxhetin e vitit 2021, investimet nga te ardhurat tona kane njohur rritje, dhe tregues kuptimplote dhe kjo duke u përfshirë si kontributiore ne vlere monetare ne projektet e përbashkëta me partneret tanë, ne investime ne infrastrukture apo dhe ne pagesat e bëra për pjesën e bashkisë ne fuqizimin e flotës se mjeteve te reja si për shërbimin e MZSH ashtu dhe ne mjetet për shërbimet.

Serioziteti, korrektesa e profesionalizmi i shprehur ka bere te mundur qe te jemi përfitues ne rreth 52 milion euro projekte gjate vitit 2021. Te tjerë projekte jemi duke aplikuar dhe te tjera objektiva ne rritje kemi te shprehur ne këtë buxhet.

Ndryshimet strukturore ne funksionet e administratës, marrja e shërbimeve te shtuara dhe shtimi i kapaciteteve me mjete ne përdorim janë indikatorë te rëndësishëm mbi te cilat mbështeten objektivat e reja ne nivele te larta krahasimisht kjo dhe me vitet e mëparshme apo dhe me tavanet buxhetore ne PBA e mëparshme.

Është një buxhet social pasi ruan treguesit e arritur ne këtë fushe dhe vijimësi e programeve sikurse është rikonstruksioni banesave për familjet ne nevoje, apo dhe projekteve te tjera për nxitjen e punësimit dhe trajtimin e shtresave te marxhinalizuara.

Ben pjese te treguesve te tij, prioritetet e kërkesave te komunitetit te tërhequra ne te dy llojet e dëgjesave te zhvilluara për këtë qellim, ato te organizuara nga Administrata e Bashkisë apo dhe rekomandimet e dërguara nga këshilli Bashkiak tërhequr nga dëgjesat e zhvilluara prej tij. |Është për këtë arsye pse ky buxhet është me cilësor ne treguesit e tij pasi këshilli bashkiak për here te pare behet pjese e këtij procesi jo vetëm me vendimmarrje por dhe me organizimet e tij për dëgjesat me publikun dhe tërheqjen e mendimeve e kërkesave te tij.

Shoqëruar me dokumentet e tij analitike qe janë Paketa fiskale, Kalendari Buxhetor dhe gjithë treguesit financiar sipas njësive shpenzuese, i materializuar me buxhetin sipas njësive administrative është një buxhet i objektivave te mëdha dhe përgjegjësive te mire drejtuara sipas drejtorive qe e implementojnë këtë buxhet.

Koncept ky si një risi e procesit te planifikimit te buxhetit te njësisë sonë i cili duhet dhe sigurisht presim te sjelle tregues shume me te larte ne implementimin e tij.

Ne jemi shprese plote qe ne vitin 2022 Bashkia Berat do te ketë një tjetër performance pozitive dhe një nivel tjetër jetese dhe kjo pasi kërkesa për investime nga biznesi dhe komuniteti është shtuar, shprehur kjo ne rritjen e kërkesave për leje ndërtimi si ne rikonstruksionin e banesave ashtu dhe ne ndërtimet e reja.

Berati tashmë është një qytet jo i braktisur, një qytet i jetueshem dhe me një nivel jetese ne rritje.

Por jo vetëm!

Berati është i aksesueshëm dhe një qendër e rëndësishme jo vetëm turistike, por dhe me një ekonomi në rritje sidomos në fushën e investimeve.

Përballoi situatën e rëndë pandemike dhe ruan në nivele të qendrueshme numrin e bizneseve tregues ky që të ngarkon me përgjegjësi për të rritur me shume performancën e burimeve njerëzore dhe kapacitetet menaxhuese për shërbime cilësore dhe zgjerimin e tyre ne gjithë territorin e bashkisë.

Ambicia jonë për të aktivizuar kapitalin e heshtur dhe për të ulur nivelin e debisë së trashëguar në vite nëpërmjet krijimit te strukturës se re brenda drejtorisë së Taksave dhe tarifave, është një tjetër premisë e rëndësishme që viti financiar 2022 të jetë viti i kthesës historike buxhetore në bashkinë Berat.

Në vitin 2022 do ketë vëmendje të shtuar për rritjen e cilësisë së shërbimeve në zonat jourbane.

Të nderuar këshilltarë!

Plan buxheti i vitit financiar 2022 dhe PBA 2022-2024 i sjellë për miratim, me bindjen se do të marrë miratimin tuaj, konsolidon performancën financiare të bashkisë sonë dhe krijon premisa të dukshme për një zhvillim të qendrueshëm.

Ju faleminderit!

Ervin DEMO

KRYETAR I BASHKISË BERAT

1. HYRJE

1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve .

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin

e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës* së *Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

[1] **S**pecifike, **M**atshme, **A**rritshme, **R**ëndësishme, **T**erma **K**ohore.

[2] 'Afatgjat' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MFE-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore"

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2022-2024 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT) dhe Formatet e reja për planifikimin e shpenzimeve të programit.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MFE, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor. Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Për periudhën nga tetori deri në muajin dhjetor njvqv-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin Plotësues të PBA-së). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së

2. BUXHETI I VITIT 2022 DHE AFATMESËM I BASHKISË BERAT 2022-2024

Ky seksion i kushtohet alokimit të burimeve për shpenzime publike të Bashkisë Berat gjatë periudhës 2022-2024. Nënseksioni i parë, prezanton të ardhurat e parashikuara për periudhën 2022-2024, me një shpjegim për secilin grup të të ardhurave së bashku me supozimet kryesore të bëra gjatë parashikimit. Nënseksioni i dytë, paraqet një përmbledhje të planeve të shpenzimeve të Bashkisë për vitet 2022-2024. Ky nënseksion prezanton informacionin mbi shpenzimet totale sipas kategorive ekonomike, programit dhe funksioneve qeverisëse.

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

Tabela 1. Të dhëna mbi Bashkinë Berat

	Të Pergjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i Njësive Administrative	5					
Numri i Fshatrave	50					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	380 Km2					
Qyteti	19					
Njësitë Administrative	361					
Sipërfaqja e Bashkisë (km2)	380 Km2					
Zonë Urbane	6,3Km2					
Tokë Bujqësore	160Km2					
Kullota	537,10Ha					
Pyje	2,827.99Ha					
Popullsia e Bashkisë		99,484	98,968	100,209	99,970	99,796
Qyteti		63,042	62,747	63,519	63,425	63,389
Njësitë Administrative		36,442	36,221	36,690	36,545	36,407
Mosha Mesatare e Popullsisë		38	38	39	40	40
Numri i Lindjeve		814	744	1,010	990	907
Numri i Vdekjeve		548	501	541	653	611
Numri i Bizneseve Aktive		1,889	2,400	2,198	2,325	2,410
Numri i Familjeve		31,790	32,368	33,261	33,555	34,040
Qyteti		21,746	22,066	22,659	22,801	23,177
Njësitë Administrative		10,044	10,302	10,602	10,754	10,863
Numri i Punonjësve të Bashkisë		684	704	724	724	740
Administrata e Bashkisë		148	148	135	156	156
Njësitë Shpenzuese		499	514	546	530	546
Numri i Programeve Buxhetore		14	17	28	24	23

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE

E shtrirë në Krahinën Malore të Shqipërisë Jugore dhe pjesërisht në Ultësirën Perëndimore në të dy anët e rrjedhës së mesme dhe të poshtme të lumit Osum, Bashkia Berat është një atraksion jo vetëm turistik, por edhe një njësi ekonomike me resurse të mëdha zhvillimi.
Ajo përfshin brenda juridiksionit të saj administrativ qytetin e Beratit, njësitë: Otllak, Velabisht, Roshnik, dhe Sinjë. Në total nga 7 njësi administrative.

Tregues të rëndësishëm statistikorë bazë të saj janë:
Sipërfaqja: Bashkia Berat ka një sipërfaqe totale 380 km² e cila klasifikohet në tokë bujqësore prej 170 km^2, (përfshirë këtu tokat e kultivuara dhe jo të kultivuara) dhe tokë natyrore 180 km^2 (përfshirë këtu pyjet dhe kullotat)
Karakteristika të veçanta kanë njësitë përbërëse të bashkisë pjesë e ish komunave si : Njësitë Otllak dhe Velabisht të cilat në sipërfaqen e tyre kanë më shumë tokë bujqësore, dhe njësitë Roshnik e Sinjë që kanë në strukturën e sipërfaqes së tyre teritoriale tokë bujqësore të fragmentarizuar me siperfaqe më të madhe të tokës natyrore, dhe reliev kodrinor malor.
Bashkia Berat përshkohet nga lumi i Osumit dhe është tepër e pasur me ujëra nëntokësore e burime ujore sipërfaqësore .
Siperfaqja totale ujore është 9 km^2. Sipërfaqet banuara janë 4.63 km^2.
Industria dhe ekonomia shtrihen në një siperfaqe prej 1.34 km$^{2.}$
Bashkia përshkohet nga 812 km rrugë
Qyteti i Beratit gjendet 58 m mbi nivelin e detit dhe ka nje sip. 22.4 km^2 nga e cila 6.3 km^2 janë sipërfaqe urbane.
Ai pozicionohet:

- 125 km larg kryeqytetit të Shqipërisë dhe aeroportit "Nënë Tereza"
- 92 km nga porti i Durrësit
- 85 km nga porti i Vlorës
- 212 km nga porti i Sarandës
- 250 km nga pikat kufitare të Kakavijës dhe Kapshticës.

Ndarja administrative e Bashkisë Berat

Njësitë admin. përbërëse	**Sipërfaqja (km²)**	**Fshatrat/Qytetet në përbërje të tyre**
Berat	19 km²	Qyteti Berat
Otllak	52.7 km²	Lapardha1,Lapardha2,Qereshnik, Balibardhë,Dyshnik,
		Moravë, Ullinjas, Vodëz e sipërme, Orizaj, Otllak.
Velabisht	93.2 km²	Malinat, Bilçë, Drobonik, Bardhaj i Ri, Starovë,Veterrik,
		Remanicë, Gjoroven, Palikësht,Veleshnjë, Duhanas, Kodras, Velabisht.
Sinjë	138.5 km²	Mbolan, Mjeshovë, Mbreshtan, Galinë, Sadovicë, Paftal,
		Kamçisht, Levan, Velçan, Osmenezez 1, Osmenezez 2, Plashnik i Vogël, Molisht, Sinjë.
Roshnik	78.7 km²	Bogdan i Poshtëm, Bogdan i Sipërm, Dardhë, Karkanjoz, Kostren i Madh, Kostren i Vogël, Mimias, Perisnak, Qafë Dardhë, Vojnik, Rabjak, Roshnik Qendër, Roshnik i Vogël.

Berati është qendër ndërkombëtare e trashëgimisë kulturore (lagjet tradicionale të Mangalemit, Goricës dhe Kalasë, Muzeu Kombëtar i Ikonografisë "Onufri"' dhe galeritë tjera, muze, kishat, xhamitë).
Historia mbi 2400 vjeçare e bën atë ndër qytetet më të vjetër të vendit tonë."Qytet Muze" nga viti 1961 dhe aktualisht pjesë e listës të UNESCO-s si një qytet i Trashëgimisë Kulturore Botërore. Në skajin lindor të territorit të saj, bashkia ka një pjesë të Parkut Kombëtar të Tomorrit (2,416m), ndërsa në perëndim përfshin Malin e Shpiragut (1,218 m).

Sektorët kryesorë mbi të cilët mbështetet ekonomia e Bashkisë Berat janë bujqësia, turizmi, agro përpunimi dhe sektori i shërbimeve.
Njësitë Otllak, Roshnik, Velabisht dhe Sinjë kanë si sektor bazë bujqësinë. Kultivimi i pemëve frutore, ullinjve dhe vreshtarisë është parësor në këto zona.
Në Berat prodhimi i ullirit është në nivele të larta dhe është një nga produktet bujqësore të rëndësishme ,ku sipërfaqja e mbjellë me ullinj është 31.9 km^2.
Berati është zhvilluar si qendër rajonale për agrobiznesin, tregtinë dhe turizmin. Kjo si rrjedhojë e pozicinomit gjeografik, traditës historike, resurseve që mbart në këtë fushë dhe aksesit me rrugët kombëtare.
E rëndësishme të citojmë si tregues mesatar se Qyteti i Beratit ka si sektor kryesor ekonomik shërbimet, 66.9% është raporti i numrit të punësuarve në këtë sektor ndaj numrit të punësuarve gjithsej. Duke u pasuar nga industria me 29% dhe në fund bujqesia me 4.1 %.
Njesitë OtIlak, Velabisht, Sinje dhe Roshnik kanë si sektor kryesor të ekonomisë bujqesinë. Në njësinë Sinjë dhe Roshnik punësimi në bujqësi me rreth vleren 90%.
Krahasimisht për pozicionimin e vëndodhjes së biznesit treguesit statistikor janë :
Biznesi i madh përbën 22 % të totalit të numrit të bizneseve, biznesi i vogël përbën 75 % dhe ai ambulant dhe institucionet 3% të tij.
Numri total i bizneseve është 2325, prej të cilave biznes i madh 502 dhe biznes i vogël 1745 biznese, dhe kanë këtë shpërndarje të tyre
Qyteti Berat nga totali prej 2325 biznese ka 1,792 biznese ose 77 % të numrit total. Nga të cilat 80% të biznesit të madh (402 biznese në numër) dhe 75 % të biznesit të vogël (1311 biznese në numër)
Njësia Otllak ka 306 biznese në total ose 13.1 % të totali, prej të cilave 68 biznese të mëdha dhe 238 biznese të vogla që shprehur në përqindje ndaj totalit të bashkisë janë biznesi i madh 13.5 % dhe 13.6 % biznesi i vogël.
Njësia Velabisht ka 7% të numrit total ose 155 biznese nga të cilat 3% të totalit të biznesit të madh ose 13 biznese dhe 8 % të totalit të biznesit të vogël ose 132 biznese.
Njësia Roshnik ka 1% të numrit total të bizneseve ose 31 biznese nga të cilat 1% të totalit të biznesit të madh ose 3 biznese dhe 2 % të totalit të biznesit të vogël ose 28 biznese.
Njësia Sinjë ka 2% të numrit total të bizneseve ose 41 biznese nga të cilat 3% të totalit të biznesit të madh ose 15 biznese dhe 1 % të totalit të biznesit të vogël ose 26 biznese.
Njohur si në potencial jo më pak ndikim në të ardhurat vëndore Bashkia është përfshirë në një pune të plotë projektuese për tregjet me qëllim që të stabilizohen dhe të krijohen kushtet për zhvillim normal të aktivitetit të tyre sidomas për sa ju përket tregjeve sezonal të produkteve bujqësore.
Treguesit demografikë kanë rëndësinë e tyre , të cilët kanë treguar stabilitet në këtë drejtimduke ruajtur një numër popullsie mbi 100 mijë banorë.
Analizuar gjëndjen financiare të bashkisë, e rëndësishme të theksojme se Bashkia Berat, nuk është Bashki në krizë, dhe viti financiar korent e përmirëson me tej situatën me premis qe ne vitin 2023 detyrimet e prapambetura te jene me te vogla se 1%. Kjo si pasoje e harmonizimit e

implementimit te projekteve, ka ekonomizuar fondet pa cënuar shërbimet përkundrazi i ka shtuar, përmirësuar ato dhe ka bërë të mundur të shtohet numri i përfituesve të komunitetit për shërbime që kurrë nuk ishin bërë më parë.
Ka përballuar në maksimumin e saj më të mundshëm situatën e krijuar, dhe ecën e sigurt në objektivat e programuara qoftë në objektivat afatshkurtër apo dhe në afatgjatë.

Strategjia e zhvillimit afatgjatë/ strategjia territoriale . **Orientimi afatgjatë i bashkisë (drejtimet kryesore të saj. Burimi i informacionit: PPV/PZhS)**

Vizioni strategjik, që do të udhëheqë zhvillimin e Bashkisë së Beratit gjatë 15 viteve të ardhshme" *"Berati është një qytet i trashëgimisë kulturore botërore, me një strukturë të unifikuar e të konsoliduar, urbane dhe rurale, me cilësi të lartë jetese, i lidhur mirë me zonat qendrore të Shqipërisë përmes një infrastrukturë moderne, si një destination i fuqishëm turistik dhe portë hyrese/pritëse për një rajon të pasur natyror.*
Një nga asetet me me vlerë të Bashkisë Berat janë qytetarët e saj, ndaj rëndësi e veçantë i jepet nxitjes së kualifikimit të kapitalit njerëzor, për të rritur integrimin e të gjithë qytetarëve aktive në tregun e punës.
Qëllimi kryesor: ***harmonizimi i zhvillimit ekonomik, infrastrukturor dhe hapësinor me mbrojtjen e burimeve natyrore, zbutjen e pabarazive sociale dhe promovimin e zhvillimit intelektual të shoqërisë*** **përmes parimit të zhvillimit të qëndrueshëm të territorit.**

Misioni i bashkisë *në funksion të këtij vizioni zhvillimi është:*
Vënia në dispozicion në mënyrë inteligjente e të gjitha burimeve financiare e njerëzore përharmonizimin e interesave publike dhe private, për zhvillim ekonomik e social në të gjithë territorin e Bashkisë Berat.

2.2 INFORMACION PËRMBLEDHËS PËR PËRGATITJEN E BUXHETIT TË VITIT 2022 DHE PBA 2022 - 2024

Hartimi i projektit buxhetor 2022 dhe afatmesëm 2022-2024 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015"Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 datë 27.4.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " , udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 " Për procedurat standarte të pëgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vendore" , të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024", si edhe Udhëzimit Plotësues nr 20 datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024", dhe shtojcat plotësuese, të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Berat,
Në zbatim të tyre u ngrit Grupi për Menaxhimin Strategjik me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë si dhe Ekipet e Menaxhimit të Programit, u përgatit Udhëzimi për përgatitjen e PBA 2022-2024 dhe u vu në dispozicion të Grupit për Menaxhim Sstrategjik dhe Ekipeve të Menaxhimit të Programit.
Në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", neni 36, si dhe të Kalendarit Buxhetor për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesem, Bashkia Berat përgatiti fazën e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, i cili u miratua nw Keshillin Bashkiak. .
Bashkia Berat ka depozituar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë projektdokumentin e parë të Programit Buxhetor Afatmesëm, brenda afateve ligjore.

Theksojmë se në hartimin e plan buxhetit, sikurse dhe ligjërisht është e përcaktuar, administrata e bashkisë dhe këshilltarët e këshillit bashkiak, udhëhoqën procesin e konsultimit të projektit me publikun, duke organizuar dëgjesat publike. dhe u bënë pjesë e këtij procesi. U zhvilluan 21 dëgjesa publike . *Plani i veprimit, proces verbalet e dëgjesave publike si dhe lista e pjesëmarrësve janë pjesë e dokumetëve të përgatitjes dhe miratimit të PBA 2022-2024.*
Në këtë kuadër u kryen aktivitetet e mëposhtme:
Aktiviteti nr. 1 - Organizimi i dëgjesave publike me komunitetin ne lagjet e qytetit dhe katër Njësitë Administrative**.**
Aktiviteti nr. 2 - Organizimi i dëgjesave publike me grupet e interesit.
Aktiviteti nr. 3 - Zhvillim i dëgjesave publike me komunitetin në lagjet e qytetit, njësitë administrative dhe grupet e ineteresit
Aktiviteti nr. 4 - Miratimi i dokumentit të rishikuar të PBA 2022-2024.

a. Përgatitja e materialit të rishikuar të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 -2024, dhe miratimi në Këshillin Bashkiak
b. Dërgimi i materialit të këtyre aktiviteteve në Ministrinë e Financave, brenda datës 15 shtator 2021.

Propozimet e tërhequra nga komuniteti dhe grupet e interesit u administruan nga GMS dhe sipas problematikave iu adresuan Ndërmarrjeve të vartësise së bashkisë, si dhe Sh.A.Ujesjëllës-Kanalizime Berat - Kuçovë, për t'i integruar në programet përkatëse buxhetore, sipas listimit të prioriteteve brenda mundësive financiare. (në mënyre të detajuar janë në proçesverbalet e takimeve pjesë përbërëse e dosjes së Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, faza e rishikuar)
Problematikat e trajtuara në dëgjesat publike, kërkesat dhe propozimet e bëra nga qytetarët u shqyrtuan nga grupi i hartimit të buxhetit .Një pjesë e tyre janë pasqyruar në këtë projekt buxhet, në fushën e shërbimeve publike, arsimit dhe bujqësisë.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka konstatuar se: Bashkia Berat ka respektuar standartet e përcaktuara në Udhëzimin *e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr 23 datë 30.07.2018, 'Për proçedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të qeverisjes vëndore",* të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 7 datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024", si edhe Udhëzimit Plotësues nr 20 datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e PBA vendor 2022-2024", dhe shtojcat plotësuese.

- Projektdokumenti i Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024, i Bashkisë Berat është përgatitur në Instrumentin e Planifikimit Financiar (FPT);
- Bashkia Berat ka depozituar pranë MFE projekt dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm faza e rishikuar, brenda datës 15.09.2021.
- Raportet e projektdokumentit të PBA-së, dërguar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, janë sipas formateve te përcaktuara në udhëzimin plotësues.

Ministria e Financës dhe Ekonomisë ka vlerësuar angazhimin e Bashkisë Berat në përmirësimin e procesit të hartimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, duke e kthyer PBA-në, në një mjet të realizimit të Strategjive të Zhvillimit. Mirëpërcaktimi i Qëllimeve, Objektivave dhe Produkteve për çdo program buxhetor me tregues të matshëm si dhe planifikimi i shpenzimeve mbi bazë kosto për njësi produkti, bëjnë të mundur realizimin e Planit Stategjik të Zhvillimit.

Në dokumentin e PBA-së të Bashkisë Berat shpërndarja e burimeve është realizuar mbi bazë programi buxhetor dhe totali i tavaneve të shpenzimeve është brenda tavaneve të të ardhurave të parashikuara. Parashikimi buxhetor është i balancuar.
Dokumentet, mbi të cilët është mbështetur hartimi i Programi Buxhetor Afatmesëm dhe buxheti vjetor 2022 janë :

- Programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për periudhën 2019-2023.
- Strategjia e Zhvillimit për Territorin e Bashkisë.

- Strategjia dhe Plani i Veprimit i Turizmit.
- Strategjitë sektoriale që janë të lidhura me kompetencat e pushtetit vendor.

BUXHETI I VITIT 2022 DHE BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË BERAT 2022-2024

Buxheti total i Bashkisë Berat për vitin 2022 është 1,211,327 mijë lekë, për vitin 2023 është programuar 1,206,894 mijë lekë, dhe për vitin 2024 është programuar 1,246,910 mijë lekë.

Financimi i buxhetit realizohet nga :

- **Nga burimet e veta vendore,** ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, te ardhurat nga tarifat vendore, te ardhura te tjera dhe të ardhura që trashëgohen.
- **Nga burimet qendrore,** ku përfshihen transferta e pakushtëzuar, transferta e pakushtëzuar sektoriale për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë, transferta specifike dhe transferta e kushtëzuar.

Tabela 3 . Burimet e fianncimit të buxhetit të Bashkisë Berat

në 000 lekë

BURIMET E FINANCIMIT TË BUXHETIT TË BASHKISË BERAT		viti 2022	Pesha Specifike ne % ndaj totalit v. 2022	viti 2023	Pesha Specifike ne % ndaj totalit v. 2023	viti 2024	Pesha Specifike ne % ndaj totalit v. 2024
I	**BURIMET E VETA VENDORE**	**627,817**	**52%**	**615,542**	**51%**	**634,008**	**51%**
1	Te ardhurat Vendore (taksa&tarifa vendore)	597,614	49%	615,542	51%	634,008	51%
	Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja	30,203	2%	0	0%	0	0%
II	**BURIMET QENDRORE**	**583,510**	**48%**	**591,352**	**49%**	**612,902**	**49%**
1	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	308,280	25%	316,122	26%	337,672	27%
2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	275,230	23%	275,230	23%	275,230	22%
	TOTAL FONDE	**1,211,327**	**100%**	**1,206,894**	**100%**	**1,246,910**	**100%**

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E BUXHETIT TË VITIT 2022 KUNDREJT VITIT 2021
(Referuar planit fillestar dhe atij të korrigjuar)

Tabela 4 . në 000 lekë

Nr.	Pershkrimi	Buxheti fillestar 2021	Pesha Specifike ne -%	Buxheti i rishikuar 2021	Pesha Specifike ne -%	Buxheti i planifikuar 2022	Pesha Specifike ne -%
I	**Totali i te ardhurave**	**1,065,417**	**100%**	**1,247,712**	**100%**	**1,211,327**	**100%**

1	***Total Transferta***	**565,244**	**53%**	**656,673**	**53%**	**583,510**	**48%**
a	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	298,960	28%	298,960	24%	308,280	25%
b	Trans. e pakushtezuar trasheguar nga viti paraardhes	0	0%	27,743	2%	0	0%
c	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	258,148	24%	258,148	21%	275,230	23%
d	Transferta Specifike (mbrojtja civile+det.prapamb.))	8,135	1%	24,576	2%	0	0%
e	Transf. e Specifike trasheguar nga viti paraardhes	0	0%	47,246	4%	0	0%
2	***Total te ardhura te veta***	**500,173**	**47%**	**591,039**	**47%**	**627,817**	**52%**
a	Te ardhura te veta	500,173	47%	500,173	40%	597,614	49%
	Te ardhura te pritshme nga bashkefinancimet e huaja	0	0%	45,034	4%	30,203	2%
b	Te ardhura te veta trasheguar nga viti paraardhes	0	0%	45,832	4%	0	0%
II	**Totali i Shpenzimeve**	**1,065,417**	**100%**	**1,247,712**	**100%**	**1,211,327**	**100%**
1	**Totali shpenzime operative (korrente)**	**897,374**	**84%**	**967,161**	**78%**	**953,175**	**79%**
a	Shpenzime personeli	521,158	49%	526,568	42%	552,625	46%
b	Shp.operative & mirembajtje & te tjera transferta	376,216	35%	440,593	35%	400,551	33%
2	**Shpenzime kapitale**	**168,043**	**16%**	**280,551**	**22%**	**258,151**	**21%**

PLANI FINANCIAR I BASHKISË BERAT PËR PERIUDHËN AFATMESME 2022-2024

Tabela 5 në 000 lekë

Nr.	Pershkrimi	Buxheti i planifikuar 2022	Buxheti i planifikuar 2023	Buxheti i planifikuar 2024
I	**Totali i te ardhurave**	**1,211,327**	**1,206,894**	**1,246,910**
1	***Total Transferta***	***583,510***	***591,352***	***612,902***
a	Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme	308,280	316,122	337,672
b	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	275,230	275,230	275,230
c	Transferta Specifike(mbrojtja civile)	0	0	0
2	***Total te ardhura te veta***	***627,817***	***615,542***	***634,008***
a	Te ardhura te veta	627,817	615,542	634,008
II	**Totali i Shpenzimeve**	**1,211,327**	**1,206,894**	**1,246,910**
1	**Totali shpenzime operative (korrente)**	**953,175**	**981,770**	**1,011,223**
a	Shpenzime personeli	552,625	569,204	586,280
b	Shp.operative, & mirembajtjes& te tjera transferta	400,551	412,566	424,943
2	**Shpenzime kapitale**	**258,151**	**225,124**	**235,687**

Disa tregues të buxhetit :

- Buxheti i vitit 2022 vjen me rritje 167,690 mijë lekë në krahasim me vitin 2021, ose në masën 16%.
- Të ardhurat e veta nga taksa dhe tarifa për vitin 2022 rriten me 97,441 mijë lekë ose në masën 19.5 %
- Të ardhurat nga burimet qendrore për transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe transfertën e pakushtëzuar sektoriale për vitin 2022 rriten me 18,267 mijë lekë ose në masën 3.2%.
- Pjesë e të ardhurave të veta të buxhetit të vitit 2022 janë programuar fonde të financimit të përkohshëm të projekteve me donatorë të huaj të cilat rimbursohen nga donatori, në shumën 30,203 mijë lekë.
- Buxheti i vitit 2022 financohet me 52% nga të ardhurat e veta dhe 48% me burim transfertat e pakushtëzuara.
- Shpenzimet kapitale në vitin 2022 rriten me 101,153 mijë lekë ose në masën 64%.
- Shpenzimet e personelit në vitin 2022 rriten me 31,469 mijë lekë ose në masën 6%.
- Shpenzimet për mallra dhe shërbime në vitin 2022 rriten me 34,331 mijë lekë ose në masën 11%.
- Të ardhurat e veta nga taksat dhe tarifat vendore për vitet 2022-2024, zënë mesatarisht 52 % të totalit të buxhetit dhe të ardhurat nga burimet qendrore zënë 48% të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për vitet 2022-2024 zë mesatarisht 26 % të totalit të buxhetit.
- Transferta e pakushtëzuar sektoriale për vitet 2022-2024 zë mesatarisht 22 % të totalit të buxhetit.
- Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 janë parashikuar në shumën 597,614 mijë lekë. Krahasuar me planin e vitit 2021 (500,173 mijë lekë), rritja në vitin 2022 është parashikuar me 19%. Për vitin 2023 janë programuar në shumën 615,542 mijë lekë, dhe për vitin 2024 në shumën 634,008 mijë lekë, me rritje 3% për çdo vit.
- Totali i transfertave për vitin 2022 është 583,510 mijë lekë, për vitin 2023 është planifikuar 591,352 mijë lekë dhe për vitin 2024 është planifikuar 612,902 mijë lekë. Fondet nga burimet qendrore (transfertat) zënë mesatarisht 48 % të totalit të buxhetit .

  Burimet qendrore për vitin 2022 janë parashikuar me rritje 3.2% në krahasim me vitin 2021, për vitiet 2023 dhe 2024 janë parashikuar me rritje përkatësisht 1.3% dhe 3.6%.
- Shpenzimet e personelit në total për vitin 2022 janë planifikuar në shumën 552,625 mijë lekë dhe zënë 45.6 % të totalit të shpenzimeve , për vitin 2023 janë planifikuar 569,204 mijë lekë dhe zënë 47.2 % të shpenzimeve dhe për vitin 2024 janë planifikuar 586,280 mijë lekë dhe zënë 47 % të totalit të buxhetit të shpenzimeve.
- Shpenzimet operative në total për vitin 2022 janë planifikuar në shumën 400,551 mijë lekë, për vitin 2023 janë planifikuar 412,566 mijë lekë dhe për vitin 2024 janë planifikuar 424,943 mijë lekë. Shpenzimet operative zënë mesatarisht 33.8 % të totalit të buxhetit .
- Shpenzimet kapitale për vitin 2022 janë planifikuar në shumën 258,151 mijë lekë dhe zënë 21.3 % të buxhetit, për vitin 2023 janë planifikuar 225,124 mijë lekë dhe zënë 18.7 % të totalit të shpenzimeve dhe në vitin 2024 janë planifikuar 235,687 mijë lekë dhe zënë 19 % të totalit të shpenzimeve.

TREGUES TË BUXHETIT 2022/2020 :

Indikatorë të rëndësishëm:

Tabela 6 në 000 lekë

Nr	Treguesit kyc financiare	Buxheti 2020	Buxheti 2021	Buxheti 2022
1	Shpenzime te pergjithshme / Te ardhurave te pergjithshme	100%	100%	100%
2	Taksa + tarifa vendore /Totali i te ardhurave	76%	72%	71%
3	Te ardhura te veta / Totali i te ardhurave	49%	47%	52%
4	Shpenzime kapitale / Totali i shpenzimeve	16%	16%	21%
5	Shpenzime korrente / Totali i shpenzimeve	84%	84%	79%
6	Shpenzime personeli / Shpenzimeve te pergjithshme	48%	49%	46%
7	Shpenzime operative / Totali i shpenzimeve	16%	35%	33%
8	Shpenzime per detyrim. prapambetura / Total shpenzime vjetore	14%	11%	7.8%
9	Shpenzime te politikave sociale/ Totali i shpenzimeve	6%	3%	5%

3. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË BERAT NË VITET 2022-2024

3. 1 PLANI I TË ARDHURAVE NË BASHKINË BERAT PËR VITIN 2022 DHE PBA 2022-2024

3.1.1 Tw ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 dhe PBA 2022-2022

Planifikimi i të ardhurave, është mbështetur në legjislacionin fiskal të përditësuar si dhe paketës fiskale të vitit 2022 të sjellë për miratim.
Është e domosdoshme të theksojme qysh në fillim sikurse e kemi shpjeguar dhe në materialin e Paketës së sjellë për miratim, se paketa e re fiskale nuk ka ndryshim krahasimisht me paketën e vjetër, përveçse bën pjesë të saj gjithë ndryshimet e bëra me VKB në hapësirën midis dy paketave fiskale (2020-2021). Gjithashtu, pa ndryshim në tarifë krahasimisht me tarifën që paguhet për shërbimin e varrimit aktualisht nga qytetaret tek operatorët privat, për shkak të marrjes së këtij shërbimi nga bashkia, janë bërë pjesë e kësaj pakete fiskale tarifat për sherbimin e varrimit.
Normalisht edhe të ardhurat që do të akumunohen nga ofrimi i ketij shërbimi janë pjesë e të ardhurave.
Ky plan është hartuar mbështetur në kalendarin buxhetor, gjithë ecurinë e programit buxhetor të përcaktuar sipas udhëzimeve përkatëse të Ministrisë së Financave për proçesin e buxhetimit nëpërmjet komunikimeve të pa ndërprera, si dhe një programi pune të detajuar për të cilin është punuar në vijimësi.

Risi e këtij procesi ka qënë përfshirja e gjithe administratës dhe drejtorive që gjenerojnë të ardhura, analizat ekonomike periodike dhe dëgjesat publike të zhvilluara, nga administrata dhe ky Këshill Bashkiak.
Ky hap edhe ligjor por edhe administrativ, rrit përmirësimin e proçesit të planifikimit dhe e bën atë të jetë një buxhet për komunitetin, lehtësisht të monitorueshëm dhe ambicioz në treguesit e tij të implementimit.
I kalkuluar e mbështetur mbi objektiva shumë ambicioze, bazuar në atë çka kemi arritur dhe synojmë të arrijmë, për te rritur me tej stabilitetin financiar të Bashkisë, qendrueshmërinë e zhvillimit ekonomik dhe rritjen e mundësive për cilesi e sasi të shtuar për sherbime ndaj komunitetit dhe për më tepër për të ndryshuar strukturën e burimeve të financimit ku peshën specifike më të madhe e mbajnë burimet e veta, ky plan i të ardhurave të veta mund të quhet me plotë të drejtë **plan ambicioz** .
I ndërtuar duke shfrytëzuar maksimalisht burimet tona njerëzore dhe profesionale, **pa ndryshuar taksat dhe tarifat vendore**, mbështetur në një matrice të plotë menaxheriale në kohë dhe të mirë ndërtuar, mbart risite pozitive të evidentuara në eksperiencën dy vjeçare të kësaj administrate, krijon të ardhura më të mëdha krahasimisht me planinin e vitit financiar 2021, dhe bën pjesë të objektivave të veta atë indeks rritës që kanë pësuar të ardhurat faktike krahasimisht me vitet e mëparshme. Thënë më direkt, indeksi i rritjes së të ardhurave faktike në dinamike është pjesë e rëndësishme faktoriale e rritjes së totalit të të ardhurave.
Ne i njohim faktorët negativ që na krijoi situata pandemike ashtu sikurse vlerësojmë faktin që biznesi në bashkinë tonë u përshtat ne nivelet më të mirë të mundshme, duke ruajtur numrin në një trend të qendrueshëm ndonse pa rritje, dhe që projektohet në -3% kundrejt planit të vitit 2021, shprehur në numër biznesesh -46 biznese.
Faktorë të rëndësishëm që ndikuan në përcaktimin e tregueve janë:

1- **Klima e krijuar në Bashki si rezultat i investimeve që kanë nisur, atyre që vijojnë dhe të atyre investimeve që presim të nisin.**

Qartësisht, dukshëm dhe të prekshme janë **investimet e realizuara** filluar nga :- Rruga Ura e re- Ura e Goricës, rruga e re e Kalasë, Land Filli, sistemim asfaltimi nga Spitali në Ish Kombinat, Godina e re e Zjarrfikses, sistemim asfaltim rrugë në Pjeshkore, Ndriçimi i ri i Kalasë, Qendra e re Rinore, rruga Ura e re – Drobonik, etj, **atyre në vijim**:- Investimi në lagjen Goricë, Bypassi i ri, Parkimi nëntokësor, Sistemim asfaltim trotuare, ndriçim Spital- Rotondo e re e baypass-it Uznovë, Investimi Selamllëk- ish Axhensia, investimet në Ujesjelles Kanalizime për furnizimin me ujë 24 orë, dhe **investimet që pritet të nisin** :- Ura e re Bilçë – Ish Bonifikim, investimi në shkolla, rrugë rurale, apo investimet në kuadrin e njëqind Fshatrave në fshatin Roshnik, Lista është më e gjatë, dhe shtrihet në tërë territorin e bashkisë, por këto investime shoqëruar me shërbime publike cilësore dhe të shtuara e kanë përmirësuar cilësinë e jetës në komunitet dhe kanë ripërtërirë interesin për investime nga biznesi dhe familje. Materializuar kjo në kërkesat për leje ndërtimi, rikonstruksione e investime të tjera nga biznesi dhe familjet jo vetëm në fushën e turizmit dhe shtimit të kapaciteteve akomoduese por dhe në ndërtimin e banesave kolektive.
Citojmë gjithashtu, se si rezultat i punës së bërë dhe asaj çka projektojmë të bëjmë në fushën e bujqësisë dhe shërbimeve të shtuara në zonat rurale, agro- turizmi ka rritje dhe është faktor tjetër ndikues edhe në këtë plan të ardhurash.
Ky fluks investimesh, shoqëruar me gjallërimin e jetës kulturore dhe të aktiviteteve që Bashkia Zhvillon e ka bërë Beratin jo më një qytet të braktisur dhe të fjetur por të jetueshëm e me shumë të vizitueshëm. Është ky një faktor jo pak i rëndësishëm në planin e të ardhurave që sjellim për miratim.

2- **Struktura e biznesit sipas llojit.**

Situata në të cilën e nis vitin 2022 biznesi në strukturën sipas llojit krahasimisht me planin 2021, natyrshëm marrë për bazë llogaritese edhe për planin e të ardhurave që sjellim për miratim në biznesin e vogël paraqitet në të dhënat e pasqyrës së më poshtme:
NJËSI TREGTARE BIZNES ME TATIM TE THJESHTUAR:
Tabela 7

	P/ 2021	%	BERAT	OTLLAK	VELA BISHT	ROSH NIK	SINJE	P/ 2022	NR	%
TOTALI	1780		1,310	239	137	27	21	1,734	-46	-3%
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	70	4%	39	14	1	2	7	63	-7	-10%
Prodhim	113	6%	76	15	16	1	4	112	-1	-1%
Shitje me pakicë	631	35%	432	100	51	9	5	597	-34	-5%
Bar - Kafe	245	14%	173	27	26	3	0	229	-16	-7%
Ushqimore	112	6%	90	10	9	0	2	111	-1	-1%
Profesione të lira	86	5%	128	7	2	0	0	137	51	59%
Shërbime	329	18%	245	54	16	1	0	316	-13	-4%
Transport	117	7%	97	12	15	11	3	138	21	18%
AMBULANT	35	2%	30	0	1	0		31	-4	-11%

Grafikisht të dhënat e mësipërme do të shpreheshin:

Grafiku nr 1

Citojmë se biznesi administrohet nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave në Administratën e Bashkisë filluar nga viti 2020, dhe efekti i këtij administrimi ka qënë ndjeshmërisht poizitiv. Nëse shikojmë dhe biznesin me tatim fitimi (emertimi sipas paketës së re fiskale, emertimi i mëparshëm Biznes i madh)
Të dhënat janë si më poshtë krahasimisht sipas llojit dhe krahasimisht me planin 2021:

Tabela 8

	BERAT	OTLLAK	ROSHNIK	SINJE	P/2022	P/2021	# NR 2022-2021
Njesi tregtare biznes i madh	437	66	10	12	525	502	23
Transport	57	49	7	7	120	68	52
Import eksport	271	11	3	3	288	305	-17
Prodhim	46	4	0	0	50	62	-12
Ndertim	29	2	0	2	33	30	3
OJF	16	0	0	0	16	11	5
Banka	18	0	0	0	0	0	0

Sipas llojit të dhënat grafikisht do të shpreheshin :

Grafiku nr 2



Ecuria dhe përshtatja e bizneseve ka sjellë një ndryshim brënda grup biznesit kryesisht për bineset e reja të shtuara dhe pezullim aktiviteti apo mbyllje aktiviteti.

Ndryshimi strukturor për të dy llojet a- biznes me tatim të thjeshtuar dhe b – biznesi me tatim fitim, nga plani fillestar 2021 deri në fazën e hartimit të këtij plani të ardhurave ka pësuar ndryshime.

Biznesi me tatim fitim përbën **22.4 %** të numrit total, biznesi me tatim të thjeshtuar **75.4 %**, institucionet dhe ambulantët nga **2.52 %** të tij. Ç'ka shpreh biznesi është i fokusuar më shumë në sektorin e shërbimit dhe rritje krahasimisht me vitet 2020-2021 në vitin 2022 ka dhe në biznesin e transportit.

3- Trendi i aktivitetit të biznesit të hoteleri turizmit, transportit urban, dhe bizneseve të tjera shërbimi.

Për këto lloj biznesi plani i të ardhurave referuar situatës pandemike merr në konsideratë variantin më optimal. Nëse gjatë implementimit tëe këtij plani situata pandemike do të kërkojë ndërhyrje në përshtatje me të dhe në mbështetje të biznesit ne sërisht do ti drejtohemi këtij këshilli për të bërë ndryshimet përkatëse.

Ndërkohë monitorimi i ushtrimit të aktivitetit sipas një plani me optimal monitorimi me inspektorët e terrenit do të luftojmë evazionin fiskal nisur nga fakti që okupimi është mbi baza vetë deklarimi.

4- Migrimi dhe emigrimi i familjeve dhe administrimi i grumbullimit të taksave dhe tarifave për to.

Edhe nga analizat periodike, dëgjesat publike dhe nga administrata e njësive është konstatuar se :

- Ka një numër familjesh që kanë emigruar, por që kane prona në njësi. Ligji nuk i përjashton. Në pjesën më të madhe të njësive atë databaze që programuam në buxhetin e vitit 2021 për ta plotësuar, kemi arritur ta bëjmë por në qytet ky fluks është shumë fluid dhe i luhatshëm e na krijon mangësi cilësore në këtë proces. Në njësitë administrative të zonës jo urbane, ne jemi në proces përditësimi. Këto të dhëna programojmë ti përmirësojmë duke kërkuar angazhim konkret nga kryetarët e fshatrave dhe me tej programojmë të aplikojmë metodat ligjore të bllokimit të llogarive dhe bllokimin e mundësive për të marrë shërbime në njësi pa likujduar detyrimet ndaj bashkisë.
- Do të krijojme kushte infrastrukturore të plota për inspektorët e njësive duke ripërtërirë paisjet e tyre informatike të cilat për nga niveli janë të amortizuara.
- Do të rrisim bashkëpunimin me institucionet që ofrojnë shërbime në fushën e kadastrës, Drejtorinë e Barrës Siguruese për përdorur masa ndëshkuese për ata që nuk likujdojnë detyrimin ndaj bashkisë.
- Njëkohësisht do të pastrojmë regjistrat e trashëguara për detyrimet e prapambetura nga dublime apo pasaktësi të tyre duke njohur të plote dhe të saktë detyrimet që kanë familjaret ndaj bashkisë e duke hequr detyrimet e falura apo të parashkruara nga ligji.

5- Provigjonet financiare të Bashkisë Berat

Bashkia njeh detyrimet që biznesi ka ndaj saj. Është në proces gjyqësor me disa prej debitoreve të saj.

Deri në përfundimin e këtyre proceseve, për këto të ardhura të munguara, bashkia nuk planifikon të arketohen në shumën e plotë, por i trajton ato si provigjone financiare.

Sipas llojit këto të ardhura të munguara kanë të bëjnë me debi të shpallura nga bashkia apo dhe KLSH.

Njëkohësisht, sipas ligjit ne planifikojmë taksë qera toke për Guroret, të cilat janë gjithësej **6 (gjashtë**) në territorin e bashkisë. Edhe në këtë plan ne kemi planifikuar por jo në shumë totale të llogaritur, pasi Bizneset kanë hapur proces gjyqësor, dhe ecuria e tyre tregon se priten vendime të formës përfundimtare, të cilat do të burojnë të ardhura aq sa dhe ne planifikojmë. Kjo mbi bazën e një probabiliteti mbi mundësin e fitimit të këtyre vendimeve gjyqësore.

E cituam qysh në fillim të këtij kapitulli të materialit për buxhetin e vitit 2022, që ky plan është një plan me objektiva ambicioze e tille bëhet edhe për faktin që ndryshon struktura e gjenerimit të të ardhurave duke shtuar dy të ardhura të reja:

1- Të ardhura nga tarifa e varrimit, të cilat kur ky shërbim kryhej nga operatorët privat, i arkëtonin po ata kundrejt një tarifë të vendimuar nga Këshilli Bashkiak në viti 2015. Tani që ky shërbim ofrohet nga Bashkia kjo tarifë e pa ndryshuar për banoret e pasqyruar edhe në paketën e re fiskale, do të arketohet nga Bashkia. Këto të ardhura përbëjnë 1.4 % të plani të të ardhurave të planifikuara.

2- Ne jemi të perfshirë në projektete të përbashkëta me partnerët tanë, dhe natyrshëm kemi dhe kontributin tonë si bashki. Gjatë implementimit të projekteve, donatori nuk levron fonde pjesore por kur mbaron investimi likujdon premtimin për levrimin e plotë të fondeve. Nga burimet tona gjatë vitit ne ju japim me të drejtë kthimi mjete financiare. (gjë që ka marrë dhe vendimarrjen e këtij këshilli). Në momentin që ne i marrim ato, ato quhen në konceptin financiar të ardhura dhe në terma reale janë fonde në dispozicion të bashkisë.

Sa më sipër në vitin financiar 2022 ne planifikojmë të marrim rreth 30 milion të ardhura qoftë nga sa kemi dhënë apo dhe nga projektet e përbashkëta që mbyllen në vitin 2022. Shumë kjo që përbën rreth 5% të totalit të të ardhurave

3- Në strukturën organizative të bashkisë është krijuar sektori i borxhit. Tremujori i katërt i vititi financiar 2021, kohë kur ne dhe testuam kete strukture tregoi se ne i kemi kapacitetet dha aftësinë që kjo strukturë të jetë efektive. Vetëm në 40 ditë ne akumuluam nga debia e prapambetur 7.5 milon lekë të reja. Sfida jonë është ulja e kësaj debie që ne trashëgojmë nga administatat e mëparshme në një përqindje të lartë apo dhe ajo që krijohet ndonse në % më të ulët nga mos realizimi i planeve të periudhës së mandatit tonë. Për rrjedhim edhe ky zë i të ardhurave ka një peshë specifike të lartë në totalin e ndryshimit të planit të të ardhurave të vitit 2022 krahasimisht me planin e vitit 2021.

4- **Rritja e të ardhurave në vitin 2022 kundrejt planit të vitit 2021 është në indeksin + 19%,** i cili është një indeks relativisht i lartë, por sa trajtuam janë argumenta të qartë, faktorë të rëndesishëm që e bëjnë atë të realizueshëm. Ne bëjmë çfarë premtojmë dhe premtojmë atë çka kemi aftësi të realizojme. Periudha e deri tanishme e materializon këtë dhe kjo dukshëm evidentohet nëse sjellim në kujtesë qw detyrimet në afat shkurtër ishin në shumën 323 milion e në afatgjatë ato ishin mbi 460 milion. Sot, këto vlera i përkasin një kohe të shkuar, kemi disponibilitete të cilat na lejojnë që të kryejmë funksionet tona shtojmë shërbimet dhe rrisim cilësine e tyre, pa krijuar borxhe të reja. Sa cituam për kujtesë, u realizua edhe pse kur erdhëm ne premtuam se kështu do të ndodhte. Sot është fakt! Edhe në këtë sfidë të re të vendosur ne besojmë në sukses, ne e kemi ndëruar planin operacional manaxherial që gjykojmë se do të na çojë edhe tek përmbushja e kësaj sfide.

Qysh në planifikim në vijmë me objektiva të përcaktuar sipas Drejtorive dhe njësive administrative, dhe kemi bërë pjesë të këtij plani njësitë drejtoritë dhe specialistet sipas funksionit pjesë të rëndësishme të tij.

Tabela 9 në 000 lekë

DREJTORIA	VITI 2022	STRUKTURA
TAKSAT	**377,616**	60%
NJESIT QYTET + BIZNESI	283,368	45%
OTLLAK	41,214	7%
VELABISHT	28,863	5%
ROSHNIK	7,636	1%
SINJE	16,536	3%
DREJTORITE TJERA	219,998	35%
SHERBIMET	33,062	5%
BUJQESIA	32,756	5%
URBANISTIK	89,118	14%
ARSIM	19,422	3%
KULTURA	25	0%
MZSH	315	0%
AGJENTET TATIMORE	42,300	7%
DREJTORITE + DREJTORIA JURIDIKE DEBITORE	3,000	0%
AGJENSIA	9,526	2%
Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja	30,203	5%
TOTALI	**627,817**	100%

Grafikisht të ardhurat sipas drejtorive:

Grafiku nr.3



Parë Bashkinë Berat si një të tëre, në vitin 2022 bizneset aktivë në sistemin tatimor janë si më poshtë:
A – Në Njesitë Administrative Berat për vitin 2021 ushtrojnë aktivitetin ekonomik **1,747** biznese, nga të cilat **1,310** janë biznese të vogla të cilat mbështeten kryesisht në shërbime e më pak në prodhim. Klasifikuar në grupe si më poshtë:

Tabela 10

II	**Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël**	**1,310**
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	39
2	Prodhim	76
3	Shitje me pakicë	432
4	Bar - Kafe	173
5	Ushqimore	90
6	Profesione të lira	128
-	Noter, Farmaci, Avokat, Permbarues, Stomatolog, Labrator mjeksor & dentar	84
-	Profesione te lira te tjera	44
9	Shërbime	245
10	Transport	97
11	Ambulant	30

Grafikisht të dhënat e mësipërme janë: Grafiku nr.4



Biznesi me tatim fitim:

Karakteristikë është struktura e biznesit të madh i cili në strukturën e tij mbështetet në fushën import eksport dhe në transport. Kjo pasi kjo degë e ekonomisë ka zhvillim dhe në të shumtën e tij mbështetet në shoqëritë fason:

Tabela 11

Njësi tregtare biznes me tatim fitim	Nr
Klasifikimi	437
Transport	57
Import eksport	271
Prodhim	46
Ndërtim	29
Banka	18
OJF	16

Grafikisht të dhënat e mësipërme janë: Grafiku nr.5



Sikurse shprehet import – eksport dhe shërbimi i transportit kanë numrin më të madh.

Në Bashkinë Berat ushtrojnë aktivitet institucionet si më poshtë:

Tabela 12

Institucione (Numri)	**40**
Institucionet, Me numër të punësuarish ≤ 5 vetë	4
Institucionet, Me numër të punësuarish 5 deri 20 vetë	16
Institucionet, Me numër të punësuarish ≥ 20 vetë	20

B- Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :

Otllak

Tabela 13

Nr	**Grupet e tarifë paguesve**	**Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)**
I	**Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël**	**239**
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	14
2	Prodhim	15
3	Shitje me pakicë	100
4	Bar - Kafe	27
5	Ushqimore	10
6	Profesione të lira avokate noter stomatolog permbarues kabinet mjekesor dhe dentar	3
7	Profesione te lira te tjera	4
8	Shërbime	54
9	Transport	12

II	**Subjekte të tatim fitimit**	**66**
1	Transport	0
2	Import eksport	49
3	Prodhim	11
4	Ndertim	4
5	Perpunim guri	2

C-Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :

Velabisht

Tabela 14

Nr	Grupet e tarifë paguesve	Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)
I	**Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël**	**137**
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	1
2	Prodhim	16
3	Shitje me pakicë	51
4	Bar - Kafe	26
5	Ushqimore	9
6	Profesione të lira avokate noter stomatolog permbarues kabinet mjekesor dhe dentar	-
7	Profesione te lira te tjera	2
8	Shërbime	16
9	Transport	15
10	Ambulant	1
II	**Subjekte të tatim fitimit**	**10**
1	Transport	-
2	Import eksport	7
3	Prodhim	3
4	Ndertim	
5	Përpunim guri	-

D - Në njësitë administrative bizneset janë si më poshtë :

Sinjë

Tabela 15

Nr	Grupet e tarifë paguesve	Baza e llogaritjes (Nr. Bizneseve)
I	**Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël**	**21**
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	7
2	Prodhim	4

3	Shitje me pakicë	5
4	Ushqimore	2
5	Transport	3
II	**Subjekte të tatim fitimit**	**12**
1	Import eksport	7
2	Prodhim	3
3	Përpunim guri	2

E - Në njësitë administrative bizneset të mëdha dhe të vogla janë si më poshtë :
Roshnik:

Tabela 16

Nr	Grupet e tarifë paguesve	Baza e llogaritjes (Nr. bizneseve)
I	**Subjekte të tatimit të thjeshtuar mbi biznesin e vogël**	**27**
1	Restorant, ushqim i shpejte, piceri	2
2	Prodhim	1
3	Shitje me pakicë	9
4	Bar - Kafe	3
5	Shërbime	1
6	Transport	11
II	**Subjekte të tatim fitimit**	**3**
1	Perpunim guri	3

Sikurse shihet nga të dhenat e pasqyruara analitikisht për biznesin sipas klasifikimit, dhe vendodhjes së tij administrative, kemi një përqëndrim të tij në Njësinë Administrative Berat, e duke vijuar në Njësin Otllak, e Velabisht.
Sa më sipër në mënyrë te përmbledhur kemi :

Tabela 17

Njësia	Totali	Biznese të vogla	Biznese të mëdha
Berat	1747	1310	437
Otllak	305	66	239
Velabisht	147	137	10
Roshnik	30	27	3
Sinjë	41	26	15

Grafikisht të dhënat e mësipërme do të paraqiteshin

Grafiku nr.6



Sa lexohet përligj sa trajtuam më sipër për shpërndarjen gjeografike te biznesit sipas ndarjes administrative dhe qartësisht dallohet se zonat më ekonomike ku biznesi ka më shumë shtrirje kanë renditjen:

1- Berat
2- Otllak
3- Velabisht
4- Sinje
5- Roshnik.

Renditje kjo e ndërtuar sipas ndarjes adiministrative të bashkisë.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore për vitin 2022 mbështetet në :

- Implementimin e Paketës së re Fiskale të vitit 2022 .

Trajtuar sipas zërave dhe burimit të tyre:

Ecuria në vite e të ardhurave që mblidhen nga agjentet tatimore

Tabela 17 në 000 lekë

Vitet	Fakt 2017	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 11/2021	Plani 2022
Taksa AP + Tatimi i Thjeshtuar	4,014	1,939	3,801	20,094	10,931	10,000

Drejtoria Rajonale Tatimore në rolin e agjentit tatimorë, shërbim për të cilin përfitonë 1% të vlerës së arkëtuar është ndjeksja e planifikimit dhe realizimit të këtij tatimi.

I. Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5

(pesë) deri në 14 (katërmbëdhjetë) milionë lekë, është 0 %.

Referuar kjo ndyshimeve përkatëse ligjore në fuqi.

Grafikisht paraqesim të ardhurat nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël si dhe nga tatimi mbi te ardhurat personale (në kohën kjo taksë ekzistonte).

Grafiku nr.7



- **Ecuria në vite e të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin dhe nga tatimi mbi te ardhurat personale**

Ecuria në vite e të ardhurave nga taksat vendore në/000 lekë

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Taksë e tabelës, Takse fjetje në hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike, taksa mbi tokën bujqësore.

Tabela 18 në 000 lekë

Vitet	Fakt 2017	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 11/2021	Plani 2022
Taksat vendore	220,668	100,229	148,768	128,668	101,644	139,435

Në se lexojmë të dhënat e mësipërme dallueshëm lexohet një ritje kundrejt faktit 2020, kjo për dy arsye:

- Plani 2022 është më madh se fakti 2020 por ende më i vogël se fakti 2019 sepse ndikojnë faktorët e trajtuar në paragrafët e mësipërm.
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë edhe në vitin 2022 planifikohet më e lartë krahasimisht me periudhat e mëparshme dhe kjo është shprehje e gjallërimit të biznesit në sektorin e ndërtimit.

Grafiku nr.8



Ecuria në vite e të ardhurave nga tarifat vendore në /000 lekë

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave

Tabela 19 në 000 lekë

Vitet	Fakt 2017	Fakt 2018	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 11/2021	Plani 2022
Tarifat vendore	111,847	128,637	156,526	155,824	196,258	304,031

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit që mblidhen nga biznesi dhe nga familjet dhe institucionet.

Grafiku nr.9



Për vitin 2022 të ardhurat nga taksat dhe tarifat parashikohen në shumën **627,817,000** lekë. Këto të ardhura përbëhen nga të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, taksa mbi ndërtesën, tabelën etj.
Njësia Administrative Berat planifikon të arkëtojë **283,368,000** lekë ose **75 %** kundrejt planit total të të ardhurave të drejtorisë, dhe **45 % t**ë planit të vitit 2022.
Të katër njësitë e tjera administrative planifikojnë të arkëtojnë **25 %**

Grafikisht të dhenat e mesipërme shprehen:

Grafiku Nr.10



- **LEHTËSIRAT TATIMORE**

Theksojmë se nuk kemi ndryshime të paketës fiskale por, i risjellim të plota lehtësirat tatimore sipas pakës ekzistuese, pasi janë pjesë e rëndësishme e përllogaritjes së treguesve të planifikuar.
Pjesë kjo që përligj faktin që edhe plan buxheti i vitit 2021 është buxhet social.
1 . **Përjashtohen nga taksa mbi ndërtesat**:
1.pronat e shtetit dhe të njësive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
2. pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
3.ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
4.banesat sociale në pronësi të bashkive;
5.pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
6. ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
7.strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";

8.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
9.ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
10.ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.
11.ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, veteranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë" si dhe familjet me një pjestarë.
2.Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi tokën bujqësore :
1.Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.
2.Taksapaguesit që i përkasin kategorive me status invalid të punës, invalid të luftës, të verbër, vet-eranë të luftës, të sëmurë para dhe tetraplegjikë, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë" si dhe familjet me një pjestarë
3. Përjashtimet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë :
a. investimet e kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese "Hotel/Resort me pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name".
b. investimet e subjekteve, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si "agroturizëm", sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit.
c. investimet për rindërtimin, riparimin apo restaurimin e ndërtesave të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore, sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile. Kushtet, rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përjashtimin nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, sipas kësaj pike, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
ç. investimet në kuadër të programeve të rindërtimit, sipas dispozitave të ligjit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

4. Përjashtohen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme:

a. Enti Kombëtar i Banesave, ministria përgjegjëse për financat dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore.
b. Personat, të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake, në mbështetje të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar;
c. Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë:
(i) institucionet dhe entet shtetërore e publike, qendrore e vendore;
(ii)bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse, kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi. Në këto raste dhuruesi, pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak apo struktura e deleguar nga ky i fundit për përjashtimin nga taksa, bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar. Në çastin e regjistrimit, dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave.

Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje, për shmangie nga taksa, zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës, pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi.
5. Përjashtimet nga tarifa për infrastrukturën arsimore:
1.Tregtarët ambulantë që tregëtojnë në tregun industrial për Njësinë Administrative Berat, përjashtohen nga pagesa për tarifën për infrastrukturën arsimore.
2.Subjektet në zonën depresive ekonomike:

-"Rruga "Rilindja- shkolla “Thimi Tani” ish fillimi i rrugës Toska në lagjien “Jani Vruho”. Rruga “Kondas” - fillimi i rrugës “Toska” shkolla “Kristo Isak”.
-Bizneset e reja për vitin e parë janë të perjashtuara nga tarifa për infrastrukturën arsimore, për vitin e dytë do të paguajnë 50% të tyre dhe në vitet në vazhdim, vlerën e plotë të tarifës
3.Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.
4.Familjet që kanë kryefamiljarë që janë persona me aftësi të kufizuar.
5.Personat që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë.
6. Përjashtimet nga Tarifa e Pastrimit e largimit të mbeturinave dhe mirëmbatjes së hapësirave publike, Tarifa e Ndriçimit, Tarifa e Gjelberimit
1.Tregtarët ambulantë që tregëtojnë në tregun industrial për Njësinë Administrative Berat, përjashtohen nga pagesa për tarifën e gjelbërimit publik
2.Subjektet në zonën depresive ekonomike:
-"Rruga "Rilindja- shkolla “Thimi Tani” ish fillimi i rrugës Toska në lagjien “Jani Vruho”. Rruga “Kondas” - fillimi i rrugës “Toska” shkolla “Kristo Isak”.
-Bizneset e reja për vitin e parë janë të perjashtuara nga tarifa gjelbërimit publik, për vitin e dytë do të paguajnë 50% të tyre dhe në vitet në vazhdim, vlerën e plotë të tarifës.Në pasqyrat e mëposhtme paraqitet analitikisht planifikimi i çdo takse dhe tarife vëndore për vitin 2021.

Pasqyra përmbledhëse e planit të të ardhurave të vitit 2022 të Bashkisë Berat.

Të dhënat ne 000/lekë

PASQYRA PËRMBLEDHËSE SIPAS DREJTORIVE

Tabela 20

Nr	Emertimi	Plani 2022
I	**Agjentet Tatimore**	**42,300**
1	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	4,000
2	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	6,000
3	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise(ZRPP)	3,000
4	Takse e mjeteve te perdorura	29,300
II	**Drejtoria e Taksave dhe Tarifave**	**377,616**
1	Takse tabele	2,818
	Tabelë për qëllime identifikimi	1,986
	Tabelë për qëllime reklamimi	832
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	16,893
3	Takse fjetje ne hotel	2,158
4	Takse mbi token bujqesore	18,564
5	Takse mbi ndertesat	49,807
	Biznes	23,800
	Familje	26,007
6	Takse trualli	7,368
	Biznes	6,227
	Familje	1,141
7	Tarife e pastrimit	104,777
	Biznes	54,848
	Familje	47,561
	Institucione	2,368
8	Tarife e ndriçimit publik	47,683
	Biznes	18,090
	Familje	29,129
	Institucione	464

9	Tarife gjelberimi publik	40,250
	Biznes	12,191
	Familje	27,535
	Institucione	524
10	Tarife Arsimi publik	11,135
	Biznes	4,351
	Familje	6,584
	Institucione	200
11	Te tjera tarifa(Ambjenti)	740
12	Tarife per linjat ajerore nentokesore (Kablloret)	780
13	Te ardhura nga parkimi	4,379
14	Debitore Familje	33,952
15	Debitore Biznesi	36,311
III	**Drejtoria E Mbrojtjes Civile, Pronave, Transportit dhe Shërbimeve**	**23,536**
1	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	9,523
2	Te ardhura nga qerate	14,013
IV	**Drejtoria E Planifikimit Urban, Lejeve Dhe Monitorimit Të Investimeve**	**89,118**
1	Tarife urbanistike	89,118
V	**Drejtoria Bujqsise,Administrimit te Pyjeve,Ujerave dhe Sherbimit Veterinar**	**32,756**
1	Tarife per lende drusore	3,100
2	Tarife ujitje	3,400
3	Tarife therje	-
4	Te tjera te ardhura nga pronesia	26,256
VI	**Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit**	**19,422**
1	Te ardhura nga konviktet	2,867
2	Te ardhurat per regjistrim	853
3	Te ardhura nga kopshtet dhe cerdhet	15,702
VII	**Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes**	**25**
	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	25
VIII	**Te ardhura nga MZSH**	**315**
IX	**Te tjere debitore (gjyqe dhe klsh)**	**3,000**
X	**Tarife e sherbimit administrativ**	**-**
XI	**Agjencia e sherbime publike**	**9,526**
1	**Tarifa e sherbimit te varrimit**	**9,526**
XII	**Te ardhura te priteshme nga bashkefinancimet e huaja**	**30,203**
	TOTALI	**627,817**

Si një risi planifikuese është ndarja korrekte e planit dhe përqëndrimi i tyre sipas burimit dhe njësive administrative, dhe jo vetëm por çdo drejtori që ka në funksionin e vet akses në të ardhurat vendore dhe janë vendimarrëse në proces kanë të detajuar planin e tyre.
Ndryshimi qëndron sidomos për njësitë adminstrative të cilat u përfshinë gjatë gjithë procesit dhe sollë jo pak ndryshime në te dhënat bazë përllogaritëse.
Faktor ky që rrit përgjegjësinë e punonjësve në njësinë administrative dhe mat performancën e tre ne mënyrë korrekte.

PLANI I TË ARDHURAVE TË NJËSISË ADMINISTRATIVE BERAT DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE

Të dhënat ne 000/lekë

Tabela 21

Nr	Emertimi	Plani 2022
I	**Taksat vendore**	**64,807**

1	Takse tabele	**2,568**
•	Tabelë për qëllime identifikimi	**1,735**
•	Tabelë për qëllime reklamimi	**832**
2	Te ardhura nga zenia e hapsirave publike	**16,893**
3	Takse fjetje ne hotel	**1,694**
4	Takse mbi token bujqesore	**1,059**
5	Takse mbi ndertesat	**38,862**
•	Biznes	**18,876**
•	Familje	**19,986**
6	Takse trualli	**3,731**
•	Biznes	**3,536**
•	Familje	**195**
II	**Tarifat vendore**	**177,407**
1	Tarife e pastrimit	**86,491**
•	Biznes	**43,597**
•	Familje	**40,526**
•	Institucione	**2,368**
2	Tarife e ndriçimit publik	**43,603**
•	Biznes	**15,664**
•	Familje	**27,475**
•	Institucione	**464**
3	Tarife gjelberimi publik	**37,732**
•	Biznes	**10,139**
•	Familje	**27,069**
•	Institucione	**524**
4	Tarife Arsimi publik	**8,801**
•	Biznes	**3,483**
•	Familje	**5,118**
•	Institucione	**200**
5	Tarife per linjat ajerore nentokesore (Kablloret)	**780**
III	**Te ardhura te tjera**	**40,414**
1	Te ardhura nga parkimi	**4,356**
2	Debitore Familje	**5,446**
3	Debitore Biznesi	**30,612**
TOTAL I		**282,628**

Pasqyra e planifikimit të të ardhurave nga taksa e tabelës në /000 lekë

Të dhënat në 000/lekë

Tabela 22

Nr.	Emertimi	Niveli i Takses		sip ne m2	Plani 2022
a	Deri në 2 m²	lekë /m²/vit		-	
b	Mbi 2 m² deri në 10 m²			-	
	E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë /m²/vit	10,000	-	
	Me ndriçim të thjeshtë	lekë /m²/vit	15,000	96	**1,434**
	Elektronike	lekë /m²/vit	20,000	-	-
c	Mbi 10 m² deri në 20 m²			-	-

	E thjeshtë (pa ndriçim)	lekë /m²/vit	8,500	-	-
	Me ndriçim të thjeshtë	lekë /m²/vit	12,750	18	**225**
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	124	162,895	97,366	16,099	40,160		3,270	5,000		1,000
1710	Pagesa për shërbimin e borxhit		7,300								7,300
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	17	13,136	10,120	1,673	1,343	0	0	0	0	0
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	38	86,410	27,533	4,552	6,050	0	0	17,000	0	31,275
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore		1,695								1,695
4520	Rrjeti rrugor rural		126,899							12,774	114,126
5100	Menaxhimi i mbetjeve		79,124			73,724					5,400
5200	Menaxhimi i ujerave të zeza dhe kanalizimeve		16,764								16,764
6260	Shërbimet publike vendore		6,295								6,295
6330	Furnizimi me ujë		17,021								17,021
6440	Ndricimi Publik		6,190								6,190
7220	Shërbimet e kujdesit parësor		0								0
8130	Sport dhe argëtim		33,000				33,000				
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore		20,610								20,610
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor		0								0
10430	Kujdesi social për familjet dhe	16	17,991	11,978	1,981				2,500		1,532
10661	Strehimi social	3	13,825	2,235	370	350			4,200		6,670
2	Agjencia e Sherbimeve Publike	153	223,847	76,667	12,678	133,502	0	0	0	0	1,000
4520	Rrjeti rrugor	46	90,274	22,340	3,694	64,240					
6440	Ndricimi Publik	7	43,786	3,592	594	39,600					
6260	Dekori		1,697			1,697					
6260	Sektori i Gjelbërimit dhe Pastrim	54	33,017	25,993	4,298	1,726	0	0	0	0	1,000
6260	Sektori Mekanik dhe Transporti	13	28,697	6,748	1,116	20,833					
6260	Sektori i Mirëmbajtjes së Varrez	18	15,198	9,072	1,500	4,626					
6260	Administrata e Agjencise	6	6,213	4,662	771	780					
6260	Roje & sanitare ne objekte dhe t	9	4,965	4,260	705						
3	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	334	280,607	191,576	31,678	51,853	0	0	0	0	5,500
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	250	203,362	150,353	24,861	24,438					3,710
9230	Arsimi parauniversitar	20	15,836	10,061	1,664	2,821					1,290
9240	Konviktet e arsimit parauniversitar	18	27,665	9,481	1,568	16,616					0
10430	Familja dhe femijet (Cerdhet)	46	33,744	21,681	3,585	7,978					500
4	Qendra Kulturore "M. Tutulani"	29	34,780	19,125	3,163	11,992	0	0	0	0	500
8130	Sport dhe argëtim	2	5,570	1,278	212	4,080					0
8220	Trashëgimia kulturore, eventet	27	29,210	17,847	2,951	7,912					500
5	Drejtoria e Bujqësisë	40	38,953	21,767	3,599	11,087	0	0	0	0	2,500
4220	Shërbimet bujqësore,	24	17,361	14,715	2,433	213					0
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	7	15,699	3,962	655	9,882	0	0	0	0	1,200
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	9	5,893	3,090	511	992					1,300
6	Qendra LIRA	22	23,984	15,845	2,620	5,519	0	0	0	0	0
	Total	776	1,211,327	474,212	78,413	335,580	33,000	3,270	28,700	12,774	245,378

3.2.2 INFORMACION MBI DETYRIMET E PRAPAMBETURA DHE TË KRIJUARA

Sipas përcaktimit në Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 37 datë 06.10.2020 "Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme", detyrime të prapambetura konsiderohen detyrimet financiare të konstatuara dhe të papaguara ndaj palëve të treta , të të gjitha llojeve të detyrimeve financiare, të përcaktuara nga një ligj/kontratë/marrëveshje /vendim gjykate i formës së prerë që mbeten të papaguara 60 ditë pas datës së specifikuar në kontratë apo me ligj, duke përfshirë edhe periudhën kontraktuale të shtyrjes së pagesës, të cilat kanë lindur në njësitë e vetëqeverisjes vendore (kontratat e financuara nga qeveria qendrore).

Sipas këtij përcaktimi stoku i detyrimeve të prapambetura në mbyllje të vitit 2021 pritet të jetë në shumën 93,997,140 lekë dhe përbëhet nga : 70,918,253 lekë detyrime për investime ose 75.5% e totalit, 17,272,717 lekë detyrime për mallra dhe shërbime ose 18.4% e totalit, 4,954,630 lekë detyrime për vendime gjyqësore ose 5.3 % e totalit dhe 851,540 lekë për detyrime të tjera ose 0.9 % e totalit.
Në mbyllje të vitit 2020 Bashkia Berat rezultoi me detyrime të prapambetura në shumën 143,347,084 lekë.

Në vitin 2022 programohen të likujdohen plotësisht detyrimet për shpenzime korrente dhe 77.6% e detyrimeve për investime, në total 72,997,140 lekë detyrime ose 77.6 % e totalit.
Në vitin 2023 programohen të likujdohen detyrime për investime në shumën 21,000,000 lekë ose 22.4% e totalit të detyrimeve.

Detyrimet e prapambetura zënë 7.8% të buxhetit të vitit 2022

Plani i shlyerjes së detyrimeve të prapambetura

në lekë

Tabela nr.55

Kategoritë e Detyrimeve	Total	Pesha ne %	Plani i shlyerjes se detyrimeve	
			2022	2023
Investimet	70,918,253	75.45%	49,918,253	21,000,000
TVSH dhe Kosto lokale	0	0.00%	0	0
Mallra dhe Shërbime	17,272,717	18.38%	17,272,717	0
Vendime Gjyqësore	4,954,630	5.27%	4,954,630	0
Të tjera	851,540	0.91%	851,540	0.00%
Vlera Totale	**93,997,140**	**100.00%**	**72,997,140**	**21,000,000**

3.2.3 BUXHETI I VITIT 2022 DHE AFATMESËM 2022-2024 PËR PROGRAMET BUXHETORE

Buxheti total i Bashkisë Berat menaxhohet sipas 22 programeve të shpenzimeve. Ky seksion i dokumentit paraqet planet e shpenzimeve që lidhen me performancën për vitin 2022 dhe secilin vit të PBA-së, për secilin nga programet e shpenzimeve të Bashkisë.

Buxheti i vitit 2022 për programet buxhetore në 000 lekë

Tabela nr.56

Titulli Progr.	Emertimi Programit	Pesha specifike	Totali
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	13.4%	162,895
1710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	0.6%	7,300
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	1.1%	13,136
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	7.1%	86,410
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	1.6%	19,056
4220	Bashkia Berat	0.1%	1,695
4220	Drejtoria e Bujqesise	1.4%	17,361
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	1.3%	15,699
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	0.5%	5,893
4520	Rrjeti rrugor rural	17.9%	217,173
4520	Agjencia e Sherbimeve Publike	7.5%	90,274
4520	Bashkia Berat	10.5%	126,899
5100	Menaxhimi i mbetjeve	6.5%	79,124
5200	Menaxhimi i ujerave të zeza dhe kanalizimeve	1.4%	16,764
6260	Shërbimet publike vendore	7.9%	96,082
6260	Bashkia Berat	0.5%	6,295
6260	Agjencia e Sherbimeve Publike	7.4%	89,787
6330	Furnizimi me ujë	1.4%	17,021
6440	Ndricimi Publik	4.1%	49,976
6440	Bashkia Berat	0.5%	6,190
6440	Agjencia e Sherbimeve Publike	3.6%	43,786
7220	Shërbimet e kujdesit parësor	0.0%	0
8130	Sport dhe argëtim	3.2%	38,570
8130	Bashkia Berat	2.7%	33,000
8130	Qendra Kulturore "M. Tutulani"	0.5%	5,570
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	4.1%	49,820
8220	Bashkia Berat	1.7%	20,610
8220	Qendra Kulturore "M. Tutulani"	2.4%	29,210
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	16.8%	203,362
9230	Arsimi parauniversitar	1.3%	15,836
9240	Konviktet e arsimit parauniversitar	2.3%	27,665
10140	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	2.0%	23,984
10430	**Kujdesi social për familjet dhe fëmijët**	**4.3%**	**51,735**
10430	Bashkia Berat	1.5%	17,991
10430	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	2.8%	33,744
10661	Strehimi social	1.1%	13,825
Totali		**100%**	**1,211,327**

PROGRAMI 01110: PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

Vështrim i përgjithshëm		
Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	• Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
		• Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, parqe qendrore automjetesh, zyrave të printimit dhe IT etj.
		• Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë.
		• Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;
		• Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit;
Njësia shpenzuese që menaxhon programin		**Bashkia Berat (qendra)**

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Ky program parashikon menaxhimin financiar të Bashkisë Berat dhe përfshin shpenzimet e nevojshme administrative për mbarëvajtjen e punës në përmbushjen e funksioneve të përcaktuara në legjislacion.

Qëllimet e politikës së programit:

- Përmiresimi i funksionimit dhe menaxhimit te Bashkisë Berat, zhvillimi i kapaciteteve menaxhuese dhe garantimi i përmirësimit te vazhdueshëm të burimeve njerëzore, ofrimi i shërbimeve cilësore dhe përdorimi me efektivitet i burimeve financiare të Bashkisë.
- Vendosja e standardeve të reja në menaxhimin e burimeve njerëzore mbi bazën e meritokracisë dhe profesionalizmit në rekrutimet në shërbimin civil dhe fuqizimi i kapaciteteve ekzistuese në mënyrë që t'i përgjigjen realizimit të vizionit për të ardhmen e qytetit.

- Ofrimi i shërbimeve cilësore komunitetit duke u bazuar në krijimin e kushteve optimale të punës dhe një klime motivimi dhe bashkëpunimi midis punonjësve, koordimi dhe mirëkuptim midis palëve duke garantuar mbarevajtje optimale te punës
- Krijimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me aktorët shtetërorë, shoqërinë civile vendase apo organizata ndërkombëtare e përfaqësi të vendeve të huaja

Objektivat e politikës së programit:

- Menaxhim me efikasitet të Burimeve Njerëzore, për krijimin e një administrate vendore profesionale në bazë të meritës, aftësive dhe profesionalizmit, t'i përgjigjen standarteve më të larta që kërkohen në Qeverisjen Vendore.
- Sigurimi i informimit të vazhdueshëm, transparent për publikun dhe mediat me qëllim krijimin e një mjedisi pozitiv komunikimi dhe bashkëpunimi institucion – komunitet, duke rritur nivelin e shërbimit cilësor për komunitetin.
- Kualifikimi në vijueshmëri i burimeve njerëzore.
- Nxitjen efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore.

Produktet që synohen të ofrohen:

- Plotësimi me burime njerëzore të gjitha vendeve të lira sipas strukturës së miratuar në mbështetje të planit vjetor të rekrutimit sipas afateve të përcatuara në legjislacionin në fuqi
- Përmiresim i funksionimit të zyrës me një ndalesë si në qendër ashtu edhe në Njësitë Administrative .
- Përmirësimi i infrastrukturës në lidhje me kushtet e punës (blerja e paisjeve kompjuterike për administratën dhe softëareve të nevojshme).
- Implementimi i sistemeve HRMIS, Administrata.al si pjesë e rregjistrit qendror tëpersonelit të administratës vendore(me mbështetjen e DAP, ASPA Këshillit të Evropës, Qeverisë Zvicerane), pasi reforma në Administatë është një kusht i rëndësishëm për t'u përmbushur për hapjen e negociatave për në BE.
- Vazhdimi i funksionimit të sistemit E-PAV (platforma e administratës vendore) sinjë hallkë bashkëpunimi me ASPAS për trajnimet e detyrueshme të nëpunësave civil në periudhe prove.
- Përditësimi i sistemit të taksave (TAIS) me soft më bashkëkohor.
- Informatizimi i kontabilitetit te Bashkise dhe njesive shpenzuese me soft të licencuar.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 01110 Planifikim, menaxhim dhe administrim është planifikuar në shumën 162,895 mijë Lekë, dhe zë 13.4 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 31,165 mijë Lekë ose në masën 24 %.

Për vitin 2022:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 111,465 mijë lekë, për 124 punonjës. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 62,862 mijë lekë ose në masën 124%. Rritja vjen për shkak të riklasifikimit të punonjësve në programe buxhetore. Numri i punonjësve të programit është rritur me 3.

Shpenzime operative **për mallra dhe shërbime**(art. 602) janë planifikuar në shumën 40,160 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar më pak në shumën 7,009 mijë lekë ose – 15%, pasi jemi bazuar në nivelin e faktit të 11-mujorit.

Transfertat e brendshme (art. 604) janë planifikuar në shumën 3,270 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 210 mijë lekë ose në masën 7%. Në vitin 2022 parashikohet që agjentët tatimorë të arkëtojnë në rritje tarifat dhe taksat, duke përfituar kështu transfertë më të lartë se në vitin 2021.
Transfertat për buxhete familjare dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 5,000 mijë lekë. Fondi rezervë dhe fondi i kontingjencës është planifikuar i njëjtë me vitin 2021.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 1,000 mijë lekë.
Në këtë program përfshihet 1 projekt :

1. Pajisje zyre, computera, scaner, softëare , në shumën 1,000 mijë lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje vjetore 3%.
Shpenzimet kapitale janë planifikuar në shumë vjetore 500 mijë lekë.

Shpenzimet e programit 01110 për vitin 2022 — në 000 lekë

Tabela nr.57

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korrente te	Transf.per Buxhet. Famili.	Shp. Kapitale patrupezua	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
1110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	124	162,895	97,366	16,099	40,160		3,270	5,000		1,000

Shpenzimet analitike për mallra e shërbime të programit 01110 — në 000 lekë

Tabela nr.58

Art.	Emertimi	Plani fillestar 2021	Plani i korrigjuar vjetor	I pritshmi 2021	Plan 2022
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	2,500	3,400	3,026	3,290
6020	Kancelari	1,200	1,200	943	1,000
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	150	150	119	150
6020	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.	700	700	377	490
6020	Blerje dokumentacioni	300	950	977	1,000
6020	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	150	400	610	650
6022	Sherbime nga te trete	5,030	8,110	8,089	8,100
6022	Elektricitet	2,260	2,710	2,708	2,800
6022	Uje	1,000	1,500	1,470	1,500
6022	Posta dhe sherbimi korrier	500	1,350	1,433	1,200
6022	Sherbime te printimit dhe publikimit	100	150	81	100
6022	Sherbime rregjistrim pronash, Njoftome televizive, te tjera sherbime nga te trete	1,170	2,400	2,397	2,500
6023	Shpenzime transporti	3,675	3,675	2,850	3,800
6023	Karburant dhe vaj	2,405	2,405	2,565	2,600
6023	Pjese kembimi, goma dhe bateri	865	865	80	900
6023	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	405	405	205	300
6024	Shpenzime udhetimi	1,300	1,300	606	750
6024	Udhetime e dieta	1,300	1,300	606	750
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	200	200	0	0
6025	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes	200	200	0	0
6028	Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua	150	150	0	0
6028	Shpenzime per kuota qe rrjedhin nga detyrimet	150	150	0	0

6029	Shpenzime te tjera operative	30,746	29,614	22,796	24,220
6029	Shpenzime per pritje e percjellje.	700	700	373	500
6029	Shpenzime per aktivitete sociale	0	0	0	0
6029	Shpenzime gjyqesore.	9,000	9,298	9,125	5,000
6029	Shpenzime per honorare	726	726	448	600
6029	Shpenzime kompensimi per anetaret e Keshillit Bashkiak/ Kryetaret e fshatrave	8,020	8,020	7,874	8,020
6029	Pjesemarrje ne konferenca	300	300	0	100
6029	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative	12,000	10,570	4,975	10,000
	Totali	43,601	46,449	37,366	40,160

Shpenzimet për transfertat e brendshme (art.604)

Tabela nr.59 në 000 lekë

Nr	Emertimi i Transfertes	Plan 2021 Fillestar	Plani i Ndryshuar	Fakti 11-m	Plan 2022
1	Transferte per DRT per Tatimi e Thjeshtuar	500	500	52	60
2	Transferte UKBK agjent tatimor	1,000	1,000	1,261	1,560
3	Transferte Keshillit te Qarkut	650	650	0	650
4	Transferte per BID Berati	1,000	1,000	1,000	1,000
	Total Transferta Korrente te brendshme	3,150	3,150	2,313	3,270

Shënim : Në programin 01110 janë përfshirë shpenzime për aktivitetet e Këshillit Bashkiak

Buxheti për Këshillin Bashkiak : në 000 lekë

Tabela nr.60

Nr	Emertimi i Shpenzimeve	Numri	Plan 2022
a.	**Shpenzime personeli për këshillin (artikulli 600 & 601)**	**31**	9,244
1	Shpërblim për Këshillin (1/10 e pagës së kryetarit)(Honorare)	31	4,275
2	Sekretari i Këshillit(paga +sigurime shoqërore)	1	920
3	Specialist i Këshillit (paga +sigurime shoqërore)	1	707
4	Shpërblim për Kryetarët e Fshatrave	36	3342
b.	**Shpenzime Operative (sipas planit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për 2021) (Artikulli 602)**		294
1	Shpenzime për konsultime (seance konsultimi me bashkësinë, dëgjesat publike, transparenca e informimit)		35
2	Shpenzime për dhurata ceremoniale (buqeta lulesh, kurora,)		42
3	Blerje çertifikata, karta, kartolina urimi për festat zyrtare		12
4	Shpenzime për mirëmbajtje pajisje kompjuterike		55
5	Kancelari zyre		150
Totali i Shpenzime (a + b)			9,538

Shpenzimet e Programit 0110 sipas Kategorive ekonomike

Tabela 61

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia	**Berat**
Programi	01110 **Planifikim, menaxhim, administrim**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	44,317	39,544	43,424	40,852	97,366	100,287	103,296
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	7,568	6,357	7,180	7,180	16,099	16,582	17,079
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	26,126	54,673	47,169	46,442	40,160	41,365	42,606
Subvencion	**603**	0	0	0	0	0	0	0
Transferta të Brendshme	**604**	1,458	3,945	3,060	3,060	3,270	3,368	3,469
Transferta të Jashtme	**605**	0	0	0	0	0	0	0
Transferta për Familje & Individë	**606**	645	854	26,945	26,945	5,000	5,150	5,305
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**	0	0	0	0	0	0	0
Aktive të Prekshme	**231**	26,739	186	3,952	7,452	1,000	500	500
TOTALI		**106,854**	**105,561**	**131,730**	**131,932**	**162,895**	**167,252**	**172,254**

Projektet e Investimeve të Programit

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.62 000 lekë

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Finan	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
01110	Pajisje Aparati I Bashkise		186		186	1,814	1,000	500	500
01110	Rikonstruksion ndertesa e Bashkise	Fondet e veta	92,085	10,409					
01110	Sistemi i kondicionimit godina e bashkise	Fondet e veta	21,558	16,330		5,228			
01110	Projekti "Transparenca e Keshillit Bashkiak	Fondet e veta				410			

Të Dhëna mbi Programin

Ky seksion i dokumentit paraqet të dhëna dhe statistika specifike të programit, që mund ta ndihmojnë lexuesin të kuptojë më mirë profilin dhe kontekstin e programit.

Të dhënat e Programit 01110

Tabela nr.63

Të Dhëna Bazë mbi Programin

	Të Përgjithshme	2017	2018	2019	2020	2021
Numri i konsultimeve me publikun		6	13	14	14	15
Numri i konsultimeve me publikun që parashikohen me ligj		6	6	6	6	6
Numri total i mbledhjeve të hapura me/ për qytetarët		6	12	12	12	12
Numri total i VKB të marra në konsultim me qytetarët		7	10	10	10	10
Numri total i vendimeve të Këshillit të Bashkisë		80	80	82	84	85
Numri i punonjësve që kanë lëvizur (transferuar) brenda vitit		16		-		
Numri total i punonjësve		136	156	156	156	156
Masa disiplinore të marra nga stafi bashkisë		6				
Ditë trajnimi të punonjësve në total		140	150	155	rritës	rritës
Numri total i personave të trajnuar		28	38	42	46	46

2. PROGRAMI 01710: PAGESA PËR SHËRBIMIN E BORXHIT TË BRENDSHËM

Vështrim i përgjithshëm		
Ky nënfunksion përfshin marrëdhëniet e njësisë vendore me kreditorët dhe shërbimin e borxhit tëbrendshëm të njësisë vendore.		
Kodi i programit	Emri i programit	Përshkrimi i programit
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	• Pagesat e interesave për borxhin publik të njësisë vendore. • Amortizimi i huave të marra etj.
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :		Bashkia Berat (qendra)

Qëllimi i politikës së programit :

Menaxhim i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm i borxhit

Objektivat e politikës së programit :

Ulja e nivelit të borxhit

Produktet e programit :
Shërbimi i borxhit të brendshëm brenda kufijve ligjorë.

Në bazë të marrëveshjes të nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministravetë Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat, për projektin " Ndërtimi i Banesave me Qëllim social" , Bashkisë Berat i është disbursuar shuma e kredisë 587,707 Euro.

Në këtë marrëveshje janë përcaktuar kështet e shlyerjes së huasë sipas viteve, pra plani i amortizimit për periudhat 12/2014 – 07/2026.

Bashkia Berat i ka respektur afatet e shlyerjese së detyrimeve sipas grafikut të përcaktuar.
Në fund të vitit 2021 detyrimi i mbetur pritet të jetë : 173,282.80 eur.
Në vitet 2022 – 2024 është programuar shlyerja e kësteve vjetore, përkatësisht : në vitin 2022 kësti 58,770.70 eur, në vitin 2023 kësti 58,770.70 dhe në vitin 2024 kësti 40,070.70 eur .

Shpenzimet e Programit 01710 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.64

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	1710	**Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm**

		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2019**	**2020**	**2021**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**
		Fakt	**Fakt**	**Buxhet Fillestar**	**Buxhet i Pritshëm**	**Plani**	**Plani**	**Plani**
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**							
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**							
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**							
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	7,267	7,321	8,413	8,413	7,300	7,300	4,980
TOTALI		**7,267**	**7,321**	**8,413**	**8,413**	**7,300**	**7,300**	**4,980**

3. PROGRAMI 03140: SHËRBIMET E POLICISË VENDORE

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjesvendore.		
Kodi i programit	Emri i Programit	Përshkrimi i programit

03140	Shërbimet e Policisë Vendore	• Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje medispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror; • Ekzekutimi dhe zbatimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Njësisë dhe i vendimeve të Këshillit të Njësisë;
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :		• Bashkia Berat (qendra)

Buxheti i vitit 2022 për programin 03140 Shërbimet e Policisë Vendore është planifikuar në shumën 13,136 mijë Lekë, dhe zë 1.1% të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 669 mijë Lekë ose në masën 5.4 %. Rritja bëhet në artikullin paga&sigurime si rezultat i shtimit të strukturës me 1 punonjës. Ndërkohë që shpenzimet operative janë parashikuar më pak se plani i vitit 2021, por me rritje në krahasim me realizimin e faktit të pritshëm.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 11,793 mijë lekë, për 17 punonjës. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 777 mijë lekë ose në masën 7%, për shkak të shtimit të strukturës me 1 punonjës.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 1,343 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar më pak në shumën 107 mijë lekë ose – 7%, por në krahasim me faktin e pritshëm 2021 janë planifikuar me rritje.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 0 lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet e këtij programi janë planifikuar me rritje vjetore 3%.

Shpenzimet e programit 03140 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.65

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transferta korrente te	Transf.per Buxhet. Familj.	Shp. Kapitale patrupez	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
3140	Shërbimet e Policisë Vendore	17	13,136	10,120	1,673	1,343	0	0	0	0	0

Shpenzimet operative analitike të programit 03140 në 000 lekë
Tabela nr.66

Art.	Emertimi	Plani fillestar 2021	Plani i korrigjuar vjetor	I pritshim 2021	Program 2022
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	0	0	0	0
6020	Kancelari	0	0	0	0
6021	Materiale dhe sherbime speciale	700	700	599	550
6021	Uniforma dhe pajisje speciale	700	700	599	550
6023	Shpenzime transporti	750	750	596	793

6023	Karburant dhe vaj	615	615	550	643
6023	Pjese kembimi, goma, bateri	90	90	29	100
6023	Te tjera shpenzime transporti	45	45	17	50
Totali		1,450	1,450	1,195	1,343

Shpenzimet e Programit 03140 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.67

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	03140	**Shërbimet e Policisë Vendore**

		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2019**	**2020**	**2021**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**
		Fakt	**Fakt**	**Buxhet Fillestar**	**Buxhet i Pritshëm**	**Plani**	**Plani**	**Plani**
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	7,560	7,783	9,454	9,422	10,120	10,424	10,736
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	1,309	1,299	1,563	1,563	1,673	1,723	1,775
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	287	329	1,450	1,450	1,343	1,383	1,425
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**				32			
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	684						
TOTALI		**9,840**	**9,411**	**12,467**	**12,467**	**13,136**	**13,530**	**13,936**

4. PROGRAMI 03280: MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përballimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	• Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Shërbime të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit; • Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :		• Bashkia Berat (qendra)

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 03280 Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile është planifikuar në shumën 86,410 mijë Lekë dhe zë 7.1% të buxhetit total.

Në këtë program parashikohen fondet për mbrojtjen civile, e cila konsiston në tërësinë e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit.
Parashikimi i fondeve për mbrojtjen civile bëhet në zbatim të ligjit 49/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 65 Buxheti i Bashkive, pika 1, sipas të cilit "*Bashkitë, për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të këtij ligji, mbështeten në parashikimin minimal prej 4 për qind të totalit të buxhetit vjetor të tyre**, **të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit.**"***
Deri tani nuk kemi akordim të fondeve nga buxheti i shtetit, por jemi njoftuar në ëebinaret e zhvilluara për PBA-në (komunikim i fundit i datës 09.12.2021) se transferta specifike për mbrojtjen civile do të akordohet në nisje të vitit 2022 dhe do të jetë në masën 200 % të shumës së akorduar për vitin 2021. Pra, transferta specifike për mbrojtjen civile do të jetë 16,270 mijë lekë.
Nga ana e bashkisë janë programuar nga fondet e veta shpenzime për mbrojtjen civile në shumën 48,275 mijë lekë, nga të cilat 17,000 mijë lekë për transferta për familje dhe individë, dhe 31,275 mijë lekë për shpenzime kapitale për blerje të mjeteve zjarrfikëse.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 32,085 mijë lekë, për 38 punonjës. Numri i punonjësve është i pandryshuar nga v. 2021. Në krahasim me planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 935 mijë lekë ose në masën 3%.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 6,050 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar me rritje shpenzimet e transportit , pasi në vitin 2021 u shtua numri i mjeteve zjarrfikëse me 1 dhe në vitin 2022 do të blihen edhe 2 mjete të reja zjarrfikëse. Po ashtu me rritje janë parashikuar shpenzimet për energjinë elektrike, pasi me përmirësimin e cilësisë dhe kushteve të punës e të qëndrimit , zyrat e reja, fjetinat e punonjësve, kuzhina dhe ambientet akomoduese janë pajisur me kondicionerë, do të ketë më tepër konsum të energjisë elektrike.
Transferta për familje dhe individë (art. 606) janë planifikuar në shumën 17,000 mijë lekë.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 31,275 mijë lekë.
Në këtë program përfshihet 1 projekt :

1. Bashkëfinancim për projektin me financim të huaj FIRE PREP

Projekti konsiston në: Rikonstruksionin e godinës së MZSH-së, Blerjen e pajisjeve të zyrës për MZSH-në, dhe Blerje mjete zjarrfikëse. Viti i fillimit të projektit 2020 dhe viti i përfundimit 2022.
Aktivitetet e këtij projekti financohen plotësisht nga fondet e Bashkimit Europian, përveç vlerës së TVSH-së, e cila përballohet nga buxheti i bashkisë.
Vlera e plotë e projektit është 102,129 mijë lekë, nga e cila shuma e programuar për bashkëfinancim (kosto lokale TVSH dhe partneritet) është 17,611 mijë lekë.
Përveç shumës së bashkëfinancimit për pagesën e kostove lokale të aktiviteteve të këtij projekti, Bashkia Berat do të angazhohet të kryejë edhe financim të përkohshmën të projektit në shumën 13,664 mijë lekë. Ky fond është i rimbursueshëm nga donatori.

Projekti FIRE PREP- Përmirësimi i mbrojtjes nga zjarri në Shqipëri dhe Greqi. Programi IPA Shqipëri Greqi 2014-2020. Bashkia Berat është Partner Koordinues. Partnerë : Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Mjedisit dhe Turizmit dhe Korpusi Grek i Zjarrfikeses.
Rezultatet e projektit për Bashkinë e Beratit, do të jenë si më poshtë:
1-Blerja e dy mjeteve zjarrfikëse për Bashkinë Berat për mbrojtjen nga zjarri në pyje.
2- Rikonstruksion i plotë dhe blerje pajisjesh për godinën e Stacionit të Zjarrfikëseve Berat.
3- Blerje uniformash për zjarrfikësit e Bashkisë Berat.
4-Pjesëmarrja në trajnime e zjarrfikësve të Bashkisë Berat.
Buxheti i Projektit është 826,000 euro, ku 85 % eshte grant i BE dhe 15% eshte bashkëfinancim i Bashkisë. Projekti ka filluar në Korrik 2020 dhe mbyllet në Dhjetor 2022.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet e këtij programi janë planifikuar me rritje vjetore 3% në shpenzimet korrente, ndërsa për shpenzime kapitale janë programuar 0 lekë.

Shpenzimet e programit 03280 për vitin 2022 në 000 lekë

Tabela nr.68

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transferta korrente te	Transf.per Buxhet. Familj.	Shp. Kapitale patrupez	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
3280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	38	86,410	27,533	4,552	6,050	0	0	17,000	0	31,275

Shpenzimet operative analitike të programit 03280 në 000 lekë

Tabela nr.69

Art.	Emertimi	Plani fillestar 2021	Plani i korrigjuar vjetor	I pritshim 2021	Program 2022
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	50	50	0	100
6020	Kancelari	50	50	0	100
6021	Materiale dhe sherbime speciale	570	2,020	1,361	1,500
6021	Uniforma	320	520	0	500
6021	Pajisje speciale	250	1,500	1,361	1,000
6022	Sherbime nga te trete	800	1,250	990	900
6022	Energji	470	470	237	500
6022	Uje	300	750	736	350
6022	Te tjera sherbime	30	30	17	50
6023	Shpenzime transporti	2,150	3,750	2,649	3,550
6023	Karburant dhe vaj	1,570	2,270	1,707	2,000
6023	Pjese kembimi, goma dhe bateri	500	1,200	751	1,200
6023	Shp. e siguracionit te mjeteve te transportit	80	280	192	350
6029	Te tjera mallra dhe sherbime	0	1,902	10	
	Totali	3,570	8,972	5,010	6,050

Shpenzimet e Programit 03280 sipas Kategorive ekonomike

Tabela nr.70

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	03280	**Mbrotja nga zjarri dhe mbrojtja civile**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	25,954	22,645	26,730	26,730	27,533	28,359	29,210
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	4,349	3,750	4,420	4,420	4,552	4,689	4,829

Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	2,292	3,660	3,570	8,972	6,050	6,232	6,418
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**				8,135	17,000	17,510	18,035
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**		1,696		43,463	31,275		
TOTALI		**32,595**	**31,750**	**34,720**	**91,720**	**86,410**	**56,789**	**58,493**

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.71

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
03280	Kosto lokale, TVSH per blerje automjet zjarrfikese	Fondet e veta	1,696		1,696				
03280	Projekti Fire Prep (per permiresimin e sherbimit zjarrfikes)	Fondet e veta				42,713	31,275		
03280	Blerje Pajisje per MZSH	Fondet e veta				750			
03280	Blerje mjeti zjarrfikes Sponsorizim Ambasada Japoneze	Donatore	9,248		8,480				
03280	Kthim Amb. Japoneze fondeve te mbetura nga Spons.	Donatore			768				

5. PROGRAMI 04240: MENAXHIMI I INFRASTRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Mbështetja e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtja e konsumatorëve, menaxhimi i ujitjes dhe kullimit; Përmirësimi i politikave për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja në përshtatje me ndryshimet klimaterike		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
04240	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	• Ndërtim ose organizim i sistemeve të kontrollit të përmbytjeve, sistemeve të ujitjes dhe kullimit, duke përfshirë grante, hua dhe financime për punime të tilla • Administrim, shfrytëzim dhe mirëmbajtje e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit nën përgjegjësinë e njësive të vetqeverisjes vendore
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin:		• Drejtoria e Bujqësisë

Politika e Programit

Konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë territorin e Bashkise Berat, me qëllim që t'ju mundësojë fermerëve ujitje dhe kullim normal në cdo parcelë toke, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të kanaleve ujitëse dhe kulluese. Në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Neni 27, Funksionet e bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit, parashikohet që "Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, pika1: Administrimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të transferuar në pronësi të tyre, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj".

Aktivitetet kryesore të programit Ujitje dhe Kullim

- Evidentimi në vazhdimësi i problematikave kryesore të sistemit ujitës dhe kullues.
- Hartimi i planeve të ndërhyrjeve për pastrim dhe rehabilitim te kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese.
- Përcaktimi i volumeve të punës në objektet ku do të ndërhyhet.
- Kryerje e punimeve për pastrimin dhe rehabilitimin e kanaleve ujitëse dhe kanaleve kulluese në të gjithë territorin e bashkisë Berat dhe Njësitë Administrative.

Programi 04240 Menaxhimi i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit financohet tërësisht nga Buxheti i shtetit nga granti i transfertës së pakushtëzuar sektoriale për paga personeli , sigurime shëndetësore dhe shoqërore si dhe për shpenzime operative dhe shpenzime kapitale.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 04240 Menaxhimi i infrastrukturës së Ujitjes dhe Kullimit është planifikuar në shumën 15,699 mijë Lekë, dhe zë 1.3% të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 604 mijë Lekë ose në masën 4 %. Rritja bëhet në artikujt paga&sigurime dhe në shpenzimet operative.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 4,617 mijë lekë, për 7 punonjës. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 401 mijë lekë ose në masën 9.5%.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 9,882 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar me rritje në shumën 292 mijë lekë ose në masën 3%,
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 1,200 mijë lekë.

Në këtë program përfshihet 1 projekt :
1. Shpenzime konstruksioni për realizimin e vepra ujore me vlerë 1,200 mijë lekë

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet e këtij programi janë planifikuar të pandryshuara, pasi transferta e pakushtëzuar sektoriale nuk është parashikuar me rritje.

Shpenzimet e programit 04240 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.72

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korrente te	Transf.per Buxhet. Familj.	Shp. Kapitale patrupez	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
4240	Menaxhimi i Infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	7	15,699	3,962	655	9,882	0	0	0	0	1,200

- Në buxhetin e vitit 2022 në zërin shpenzime operative kemi parashikuar shërbimet kryesore :

o Blerje karburant për pastrimin e 40 km kanale vaditëse dhe 28 km për kanaleve kulluesese me mjetet e drejtorisë me vlerë 2,800,000 lekë .

o Kryerjen e procedurave për pastrimin e kanaleve vaditëse me krah aty ku nuk mund të ndërhyet me mjete të rënda dhe mirëmbajtje të kanaleve vaditëse ku kaproblematika të dëmtimeve të betonit dhe sistemime të prizave janë parashikuar, me vlerë 3,030,000 lekë.

o Kryerjen e procedurave për mirëmbajtjen e veprave ujore , mbrojtje lumore janë parashikuar ndërhyrje me vlerë 500,000 lekë.

o Kryerjen e procedurave për mirëmbajtje dhe pastrim Rezervuare parashikohet të ndërhyet në mirëmbajtje dhe sistemim katastrofikut në rezervuare me vlerë 1,000,000 lekë.

o Kryerjen e procedurave për mirëmbajtjen e mjete të transportit ku janë parashikuar mirëmbajtje në dy makina transporti të punonjësve dhe në 3 mjete transporti të rënda tip skrep me vlerë totale 500,000 lekë

o Kryerjen e procedurës për qeramarrje mjete transporti për transportimin e materialeve që do të nxirren nga pastrimi i kanaleve kulluese dhe vaditëse, me shumë 300,000 lekë.

o Shërbimet indirekte dhe materialet zyre dhe shpenzime për të zhvilluar aktivitetin e sektorit të ujitjes dhe kullimit me kosto 832,000 lekë.

Shpenzimet operative analitike të programit 04240 në 000 lekë
Tabela nr.73

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Plan 2021	Fakt 11 mujori 2021	I Pritshmi 2021	Plan 2022
6020	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**550**	**480**	**480**	**119**	**234**	**530**
6020	Kancelari	111	120	120			120
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	120	120	120		115	120
6020	Materiale per funksionimin e pajisjeve te zyres.(bojra Printeri)	118	120	120	119	119	120
6020	Blerje dokumentacioni						50
6020	Furnizime dhe materiale te tjera zyre dhe te pergjishme	201	120	120			120
6022	**Sherbime nga te trete**	**230**	**390**	**390**	**149**	**180**	**302**
6022	Elektricitet	120	150	100	63	75	100
6022	Uje	110	120	120	32	40	52
6022	Posta dhe sherbim korrier		120	120	22	25	50
6022	Internet			50	32	40	100
6023	**Shpenzime transporti**	**5,053**	**5,681**	**5,600**	**3,089**	**3,480**	**4,500**
6023	Karburant dhe vaj	2,981	3,734	3,550	2,537	2,928	3,800
6023	Pjese kembimi, goma dhe bateri	1,872	1,747	1,900	467	467	500

6023	Shpenzimet e siguracionit te mjeteve te transportit	200	200	150	85	85	200
6024	**Shpenzime udhetimi**	**75**	**100**	**100**	**32**	**60**	**100**
6024	Udhetim i brendshem.	75	100	100	32	60	100
6024	Udhetim jashte shtetit.						
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**5,707**	**6,727**	**5,525**	**4,583**	**4,668**	**4,450**
6025	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore Rezervuar +	950	1,267	960	775	775	1,000
6025	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore ,Kanalet Klluese dhe Ujitese	2,900	3,780	2,385	2,091	2,091	3,030
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	292	120	960	800	800	
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike Saracineska	865	960	960	780	780	
6025	Shpenzime per mirembajtjen e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes			90		85	120
6025	Shpenzime qiramarrje mjeti transporti	700	600	170	137	137	300
Totali		11,615	13,378	12,095	7,972	8,622	9,882

Shpenzimet e Programit 04240 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.74

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia	**Berat**
Programi	04240 **Menaxhimi i Infrastruktuës së ujitjes dhe kullimit**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	2,815	2,582	3,618	3,618	3,962	3,962	3,962
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	454	480	598	598	655	655	655
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	10,370	11,296	9,590	12,095	9,882	11,082	11,082
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	3,836	4,870	1,289	1,289	1,200		
TOTALI		**17,475**	**19,228**	**15,095**	**17,600**	**15,699**	**15,699**	**15,699**

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit :

- Përmirësimi i politikave kombëtare për ujitjen, kullimin dhe mbrojtjen nga përmbytja në përshtatje me ndryshimet klimaterike, duke kordinuar ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytja si dhe reformimin e menaxhimit të këtyre sistemeve,

Objektivat

- Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe të besueshme të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit dhe përmirësimit / mirëmbajtjes të sistemeve kryesore ujitëse dhe kullimit.
- Rritja e prodhimeve bujqësore dhe zvogëlimi i rrezikut nga përmbyjtjet duke marrë masa mbrojtjeje nëpërmjet hartimit të projekteve për rehabilitimin/ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes, kullimit.

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.75

Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Pajisje+Mjete Drejtoria e Bujqesise	Transf. sektoriale	350	280	70	350			
Konstruksione te veprave ujore D. e Bujqesise	Transf. sektoriale				939	1,200		
Mirembajtje Kanale Ujitese e Kulluese	Transf. sektoriale	3,560	3,556					

Të Dhëna mbi Programin

Tabela nr.76

Të dhëna bazë mbi programin							
Shërbimi i ujitjes dhe kullimit							
EMERTIMI	njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Diga funksionale	Numer	10	10	10	10	10	10
Diga të mirëmbajtura	Nr	9	9	11	11	11	11
Familje përfituese nga ujitja	Nr	850	875	940	960	970	970
Kanale ujitëse të pastruara	Km	15	28	31.5	40	45	55
Kanale kullues të pastruar	Km	5.2	35	21.5	28	36	40
Rezervuarefunksionale	Nr	9	9	9	9	9	9
Rezervuare ujitës të mirëmbajtur	Nr	7	7	8	9	9	9
Shtesë e tokës bujqësore, mbuluar me ujitje	Ha	150	180	220	250	275	300
Rrjeti total i Kanaleve kulluese	Km	490	490	490	490	490	490
Rrjeti total i kanaleve ujitëse	Km	824	824	824	824	824	824

6. PROGRAMI 04260: MENAXHIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Përshkrimi Përgjithshëm i Programit

Programi i administrimit të pyjeve përfshin hartimin e politikave për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve dhe kullotave, zhvillimin e një ekonomie të gjelbër, të praktikave më të mira në fondin pyjor dhe kullosor, efecientë nga pikëpamja ekonomike, miqësore me mjedisin dhe tëpranuara nga shoqëria. Automatizimi i bazës së të dhënave për regjistrin pyjore dhe digjitalizimi i hartave, mbështetjen e kërkimit, zhvillimit teknologjik e inovacioneve në pyje, dhënia e shërbimit këshillimor dhe aftësimin e kapaciteteve tëpersonelit pyjor dhe administrativ lokal, harmonizimi ligjor e nënligjore, bashkëpunimi institucional me struktura të tjera të interesuara për menaxhimin e qëndrueshëm e ruajtjen e biodiversitetit.

Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
04260	Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave	• Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve pyjore; • Konservim, zgjerim dhe shfytëzim i racionalizuar i rezervave pyjore; • Administrim i fondit pyjor dhe kullosor publik; • Mbikëqyrje dhe disiplinim i operacioneve pyjore dhe dhënie e liçencave për prerje pemësh. • Organizim ose mbështetje për veprimtarinë ripyllëzuese, kontrollin e dëmtuesve dhe sëmundjeve, shërbimet pyjore për luftën kundër zjarrit dhe për parandalimin e zjarrit si dhe ofrimi ishërbimeve për operatorët pyjorë; • Prodhim dhe përhapje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet pyjore; • Grante, hua ose financime për të mbështetur veprimtaritë tregtare pyjore; • Shpërndarja e kullotave, duke përshirë menaxhimin e kullotjes;.
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		• Drejtoria e Bujqësisë

Të dhëna mbi zonat pyjore

Tabela nr.77

Të dhëna rreth Pyjeve						
Ekonomia	*Diam. Mesatar*	*Lartësia mesatare*	*Nr.drurëve për ha*	*Sip bazimetrike*	*Volumi*	*Rritja mes.vjetore*
	Cm	m		m2/ha	m3/ha	m3
Bregu e Bali Bardhës	18.3	7.1	5,862	11.3	48	1.6
Hija e Roshnikut	10.5	7.4	3,761	15.8	71	2.2
Mali i Bardhë	17.9	7.9	5,138	23.3	107	3.6
Mali Molishtit	13.8	6.6	2,515	15.6	76	2.2
Mali Terpan	24.8	10.5	724	20.2	125	2.8

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 04260 Menaxhimi i Pyjeve dhe Kullotave është planifikuar në shumën 5,893 mijë Lekë, dhe zë 0.5% të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 227 mijë Lekë ose në masën 4 %. Rritja bëhet në artikullin paga&sigurime me 1.8 %, në shpenzimet kapitale të cilat dyfishohen. Ndërsa shpenzimet operative parashikohen me ulje.

Për vitin 2022:

Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 3,601 mijë lekë, për 9 punonjës. nga të cilët 3 punonjës administrate dhe 6 roje sezonale pyjesh me kontratë 6 mujore gjatë sezonit të verës për parandalimin e zjarreve në fondin pyjor dhe kullosor. Numri i punonjësve mbetet i pandryshuar nga viti 2021. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 65 mijë lekë ose në masën 1.8%.

Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 992 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar me rënie në shumën 488 mijë lekë ose në masën -33%.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 1,300 mijë lekë.

Në këtë program përfshihen 2 projekte :

1. Blerje pemë për shtimin e fondit pyjror, me vlerë 700 mijë lekë.
2. Ndërtim lera në kullota , me vlerë 600 mijë lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet e këtij programi janë planifikuar të pandryshuara, pasi transferta e pakushtëzuar sektoriale nuk është parashikuar me rritje.

Shpenzimet e programit 04260 për vitin 2022 në 000 lekë

Tabela nr.78

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korrente te	Transf.per Buxhet. Famili.	Shp. Kapitale patrupez	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
4260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	9	5,893	3,090	511	992					1,300

- Në buxhetin e vitit 2022 në zërin shpenzime operative kemi parashikuar :
  - Shpenzime për qera mjeti për transportimin e lëndës drusore nga parcela pyjore në magazinën e drejtorisë së bujqësisë me vlerë 300 mijë lekë
  - Parashikim për shpenzime mbështetëse për regjistrimin e pronave në sektorin e pyjeve dhe kullotave në vlerë 200 mijë lekë.
  - Shpenzime Karburant dhe vaj për mjetet motorsharra për prerjen e materialit drusor me vlerë 250 mijë lekë
  - Shpenzime mbështetëse të sektorit të pyjeve dhe kullota me vlerë 142 mijë lekë.

Shpenzimet operative analitike të programit 04260 në 000 lekë
Tabela nr.79

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Plan 2020	Plan 2021	Fakt 11 mujori 2021	I Pritshmi 2021	Plan 2022
6020	Kancelari	118	50	120	120	120	
6020	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik (Tabela Pyjesh)	90	120	120	120	120	
6022	Uniforma dhe Veshje Speciale (kundra zjarrit ne pyje)		120	200	200	200	
6022	Shpenzime interneti	80	71	40	40	40	
6022	Rregjistrim Pronash						200
6023	Karburant dhe vaj per motor sharra	535	250	256	260	260	250
	Udhetime dhe Dieta						60
6021	Plehra kimike, furnitura veterinare, farera, fidane e te tjera produkte agrokulturore.	432	300				
6026	Shpenzime per qiramarrje mjetesh transporti per transportin e druve			335	94	200	300
	Shpenzime per mirembajtjen e tokave dhe aktiveve natyrore Korrita	103	268	775	775	775	120
6029	Shpenzime per te tjera materiale vegla pune dhe mjete motor sharra		200	240	239	239	62
	Totali	1,358	1,379	2,086	1,848	1,954	992

Shpenzime te Programit 04260 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.80

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	04260	**Administrimi i pyjeve dhe kullotave**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	3,646	2,712	3,034	3,034	3,090	3,090	3,090
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	554	502	502	502	511	511	511
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	1,358	1,281	1,480	2,087	992	2,292	2,292
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								

Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**			650	770	1,300		
TOTALI		**5,558**	**4,495**	**5,666**	**6,393**	**5,893**	**5,893**	**5,893**

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Qëllimi i programit :

- Rehabilitimi dhe pyllëzimi i sipërfaqeve të degraduara si pasojë e shfrytëzimit të paligjshëm duke siguruar një përputheje me mjedisin natyror ku shtrihet sipërfaqja pyjore dhe kullosore.

Objektivi kryesor :

- Përdorimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave në funksion të rritjes ekonomike dhe rritjes së sipërfaqeve pyjore dhe kullosore në territorrin e bashkisë Berat .

Ky nënseksion ofron informacion mbi planet e Performancës së programit. Deklarata e Politikës së Programit është paraqitur në Tabelën 6, duke artikuluar qëllimet e politikës së programit, objektivat e politikës së programit dhe treguesit përkatës të Performancës për çdo vit të PBA-së.

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.81 në 000 lekë

Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Mjet Transporti per Drejtorine e Bujqesise	Transf. sektoriale	4,800		4,800	120			
Blerje Motor Sharre	Transf. sektoriale	116			120			
Ndertim Kullota	Transf. sektoriale					600		
Blerje Peme e fidane	Transf. sektoriale	415			530	700		

Të Dhëna mbi Programin

Tabela nr.82

Të Dhëna Bazë mbi Programin							
Sherbimi pyjor dhe kullosor							
EMERTIMI	njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Kontrata për grumbullimine bimëve Medicinale dhe qereje të fondit pyjor dhe kullosor	nr	2	2	7	7	10	10
Kontrolle dhe inspektime në pyje,kullota	nr	50	30	70	85	85	85
Numri i punonjësve të për menaxhimin pyje,kullota.	nr	4	4	9	9	9	9
Fondi total në pyje dhe kullota.	ha	16.203	16.203	17.542	17.542	17.542	17.542
Rezervuarë malore të rikonstruktuar	nr	1	1	1	2	2	3
Plane menaxhimi të fondit pyjor dhe kullosor 10- vjeçar	nr	0	0	5	0	0	0
Prita malore të rikonstrukruara	nr	1	0	1	1	1	1

7. PROGRAMI 04220: SHËRBIMET BUJQËSORE, INSPEKTIMI, USHQIMI DHE MBROJTJA E KONSUMATORËVE

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Programi mbulon mbështetjen e zhvillimit të qendrueshëm të prodhimit bujqësor, mbrojtjen e konsumatorëve, menaxhimin e ujitjes dhe kullimit		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve	• Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore,që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave • Informacion i përgjithshëm , dokumentacion teknik dhe statistika për çështjet dhe shërbimet bujqësore. • Administrim dhe mbrojtje e tokave bujqësore e të kategorive të tjera të resurseve. • Organizim ose mbështetje e shërbimeve për blegtorinë. • Administrim i shërbimeve të peshkimit dhe gjuetisë;mbrojtje, shtim dhe shfrytëzim racional të peshkut dhe kafshëve të egra ; mbikqyrje dhe disiplinim i peshkimit në ujra të ëmbla, peshkimit bregdetar, kultivimit të peshkut, gjuetisë së kafshëve të egra

		dhe liçensave të gjuetisë. • Krijimi dhe administrimi i skemave vendore të granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural. • Kontrolli ushqimor, mbrojtja e konsumatorit. Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të administrimit dhe mbrojtjes së tokes.
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :		• Drejtoria e Bujqësisë(për shpenzimet korrente) • Bashkia Berat (qendra)(për shpenzimet kapitale)

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 04220 Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatorëve është planifikuar në shumën 19,056 mijë Lekë, dhe zë 1.6% të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 1,009 mijë Lekë ose në masën 5.5 %. Rritja bëhet në shpenzimet kapitale të cilat trefishohen . Ndërsa shpenzimet operative parashikohen me ulje.

Ky program menaxhohet nga :
- Drejtoria e Bujqësisë për shpenzimet korrente, shuma 17,361 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 1,695 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 17,148 mijë lekë, për 24 punonjës. Numri i punonjësve është rritur me 2 nga viti 2021.

Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 213 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar me rënie në shumën 37 mijë lekë ose në masën -15%, nisur nga realizimi i vitit 2021. Për arsye se shërbimi veterinar ka kaluar në kompetencë të Drejtorisë Rajonale të Bujqësisë, shpenzimet e parashikuara për këtë shërbim nuk janë realizuar në vitin 2021 dhe nuk parashikohen për 2022.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 1,695 mijë lekë.
Në këtë program përfshihet 1 projekt :
1. Bashkëfinancim për projektin me financim të huaj OLIVE CULTURE

Projekti OLIVE CULTURE konsiston në forcimin e sektorit të vajit të ullirit, duke promovuar praktika të mira kultivimi, duke aplikuar teknologji precize të agrikulturës, duke krijuar produkte lokale inovative dhe mbështetje për fermat e vogla. Partnerë: Bashkia Berat, Qarku Vlorë, Bashkia Nicolaos Skoufas, Universiteti Ionian.
Viti i fillimit të projektit 2020 dhe viti i përfundimit 2022.
Aktivitetet e këtij projekti financohen plotësisht nga fondet e Bashkimit Europian, përveç vlerës së TVSH-së, e cila përballohet nga buxheti i bashkisë.

Vlera e plotë e projektit është 7,978 mijë lekë, nga e cila shuma e programuar për bashkëfinancim (kosto lokale TVSH) është 414 mijë lekë.
Përveç shumës së bashkëfinancimit për pagesën e kostove lokale të aktiviteteve të këtij projekti, Bashkia Berat do të angazhohet të kryejë edhe financim të përkohshmën të projektit në shumën 1,281 mijë lekë. Ky fond është i rimbursueshëm nga donatori.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, shpenzimet kapitale 0.

Shpenzimet e programit 04220 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.83

		Projekt Viti 2022										
Titulli Progr.	**Emertimi Programit**	**Totali**	**Shp. Korrente**	**600**	**601**	**602**	**603**	**604**	**606**	**Shp. Kapitale**	**230**	**231**
4220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbrojtja e konsumatorëve	**19,056**	17,361	14,715	2,433	213	0	0	0	1,695	0	1,695
4220	Bashkia Berat	**1,695**	0	0	0	0	0	0	0	1,695	0	1,695
4220	Drejtoria e Bujqesise	**17,361**	17,361	14,715	2,433	213	0	0	0	0	0	0

Në zërin e shpenzimeve operative kemi parashikuar shërbime mbështetëse për funksionimin dhe administrimin e sektorit të bujqësisë dhe mbrojtjen e konsumatorit me vlerë 213.000 lekë

Shpenzimet operative analitike të programit 04220 në 000 lekë
Tabela nr.84

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Plan 2020	Plan 2021	Fakt 11 mujori 2021	I Pritshmi 2021	Plan 2022
6020	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**620**	**340**	**0**	**0**	**0**	**0**
6020	Kancelari		120				
6020	Blerje dokumentacioni	540	100				
6020	Furnizime dhe materiale te tjera zyre	80	120				
6021	**Materiale dhe sherbime speciale**	**0**	**120**	**0**	**0**	**0**	**0**
6021	Uniforma dhe veshje speciale		120				
6022	**Sherbime nga te trete**	**63**	**320**	**0**	**0**	**0**	**100**
6022	Posta dhe sherbim korrier		120				
6022	Rregjistrim Pronash	63	100				100
6022	Sherbime te tjera nga te trete, internet		100				
6024	**Shpenzime udhetimi**	**35**	**50**	**0**	**0**	**0**	**50**
6024	Udhetim i brendshem.	35	50				50
6024	Udhetim jashte shtetit.						
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**100**	**120**	**0**	**0**	**0**	**63**
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve specifike	100	120				63
6029	**Shpenzime te tjera operative**	**0**	**50**	**250**	**72**	**72**	**0**
6029	Shpenzime per te tjera operative		50	250	72	72	0
	Totali	**818**	**1**	**250**	**72**	**72**	**213**

Shpenzime te Programit 04220 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.85

								PBA 2022-2024
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**							
Bashkia	**Berat**							
Programi	04220	**Shërbimet bujqësore, inspektimi, ushqimi dhe mbrojtja e konsumatoreve**						
		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2019**	**2020**	**2021**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**
		Fakt	**Fakt**	**Buxhet Fillestar**	**Buxhet i Pritshëm**	**Plani**	**Plani**	**Plani**
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	13,530	12,767	14,916	14,886	14,715	15,156	15,611
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	2,183	2,395	2,466	2,466	2,433	2,506	2,581
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	818	49	250	250	213	219	226
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**	43	131		30			
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**				2,621			
Aktive të Prekshme	**231**			415	1,947	1,695		
TOTALI		**16,574**	**15,342**	**18,047**	**22,200**	**19,056**	**17,882**	**18,418**

Qëllimet e politikës së Programit :

Qëllimi i politikës së programit është fuqizimi i sistemit të kontrollit dhe inspektimit, duke përfshirë të gjithë zinxhirin ushqimor nga ferma në tavolinë. Në terma konkrete programi synon adoptimin çdo vit të 4 standardeve të BE-së në kuadrin normativ vendas si dhe krijimi i një sistemi modern informacioni mbi tokën bujqësore si një instrument efektiv në realizimin e politikës për një administrim të qëndrueshëm të tokës bujqësore, përdorimit, mbrojtjes, konsolidimit dhe zhvillimit e tregut të saj.

Objektivat kryesorë :

Ky sektor është i fokusuar në zbatimin e Ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Ky realizim vjen si rezultat i bashkëpunimit me ZVRPP dhe prefekturën e Qarkut Berat.

Programi mbulon shërbimet mbështetëse për kryetarin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose këshillin. Ai siguron planifikimin e zhvillimit të njësisë, menaxhimin e financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera të njësisë dhe të burimeve njerëzore, funksionimin e proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimin me publikun, konsumatorëve të bashkisë Berat.

Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcelë për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave dhe mbrojta e konsumatorit.

Krijimi i sistemit të informacionit për administrimin, përdorimin e tokës mbështetur në teknologji bashkëkohore. Plotësimi i dokumentacioneve përkatëse të pronësive private dhe shtetërore.

Projektet e Investimeve të Programit

Nuk janë programuar projekte investimi në këtë program.

Të Dhëna mbi Programin

Tabela nr.86

Të Dhëna Bazë mbi Programin							
Sherbimet bujqesore mbrojtja e konsumatoreve							
EMERTIMI	njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Fondi i tokë bujqësore	ha	14.764	14.764	14.764	14.764	14.764	14.764
Tokë shtetërore	ha	3.324	3.324	3.324	3.324	3.324	3.324
Tokë e kultivuar	ha	11.44	11.44	11.44	11.44	11.44	11.44
Toka bujqësore të gërryera nga Lumi Osum	ha	42	43	43	43	43	43
Regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi	nr	221	195	149	200	225	250
Shërbime ndaj fermerëve	nr	250	350	159	200	320	360
Kontrolle dhe inspektime në thertore dhe tregje për kafshët e gjalla	nr	70	30	50	50	50	70

8. PROGRAMI 04520: RRJETI RUGOR RURAL DHE URBAN

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugorbrendajuridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**

04520	Rrjeti rrugor rural	• Ndërtimi dhe mirëmbajtja e sistemeve rrugore dhe strukturave të transportit (rrugë, ura, tunele, parkime, terminale autobusësh, rrugë këmbësore dhe korsi biçikletash etj.) dhe sinjalizimi rrugor i trotuareve dhe shesheve publike vendore nën administrimin dhe përgjegjësië e njësisë së vetëqeverisjesvendore; • Studime për rehabilitimin, përmirësimin, ndërtime të reja në sistemet e transportit për rrjetin rrugor nën administrimin e njësisë vendore; • Marrja e masave për lehtësimin etrafikut dhe kontrollin e sistemit rrugor rural të njësisë vendore;
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		• Agjencia e Shërbimeve Publike (për shpenzimet korrente) • Bashkia Berat qendër (për shpenzimet kapitale)

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 04220 Rrjeti rrugor është planifikuar në shumën 217,173 mijë Lekë, dhe zë 17.9 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 65,027 mijë Lekë ose në masën 43 %. Rriten shpenzimet për mirëmbajtjen e rrugëve me rreth 145 %, rriten shpenzimet për investime në infrastrukturën rrugore me rreth 52 % . Ndërsa shpenzimet për paga në këtë program parashikohen me rënie për shkak të riorganizimit të njësive shpenzuese, ristrukturimit dhe riklasifikimit të punonjësve edhe në programet buxhetore.

Ky program menaxhohet nga njësitë shpenzuese :
- Agjencia e Shërbimeve Publike për shpenzimet korrente, shuma 90,274 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 126,899 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 26,034 mijë lekë, për 46 punonjës. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rënie në shumën 16,380 mijë lekë ose në masën -39%. Kjo për arsye sepse me riorganizimin e njësive shpenzuese dhe sektorëve, një pjesë e punonjësve janë përfshirë në programin e shërbimeve publike.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 64,240 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 (plan) janë planifikuar me rritje në shumën 37,970 mijë lekë ose në masën 145 %. Është shtuar fondi për mirëmbajtjen e rrugëve dhe shesheve me asfaltobeton, duke prekur dhe ndërhyrë në gjithë lagjet e qytetit.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 126,899 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë parashikuar me rritje në shumën 43,437 mijë lekë ose në masën 52 %.

Në këtë program përfshihen 13 projekte :
1.Asfaltim dhe shtrim rrugesh me beton, mirembajtje me cakull dhe tombino e mure mbajtes ne njesite administrative dhe lagjet e qytetit, shuma 7,841 mijë lekë
2.Hartim Projekti"Rikualifikim Urban i Unazes se re Berat" i bypass, shuma 4,522 mijë lekë
3.Rikonstruksion rrugesh, trotuare dhe ndricim 30 vjetori ish pjeshkorja, shuma 5,820 mijë lekë
4.Shpronesime te zona ish-pjeshkorja, shuma 5,000 mijë lekë
5.Supervizim Ujesjellesi fshati Mbreshtan, shuma 628 mijë lekë
6.Kolaudim "Per objektet e ujitjes dhe kullimit (Skema ujites Bilce), shuma 12 mijë lekë
7.Mbikqyrje Ndertim ujesjellesi Prokopi-Paftal, shuma 22 mijë lekë
8.Permiresim shtresa rrugore rruga Antipatrea Kryqezimi i Spitalit Rajonal-By Pass,shuma 18,000 mijë lekë
9.Hartim Projekti "Ura e re mbi lumin Osum dhe rikonstruksioni i rruges Gorice-Bilce", shuma 8,252 mijë lekë
10.Supervizime, kolaudime objektesh, shuma 2,802 mijë lekë
11.Investime ne rrjetin rrugor, shuma 50,000 mijë lekë
12.Bashkefinancim per investime ne infrastrukturen rrugore, shuma17,000 mijë lekë
13.Shpronesime, shuma 7,000 mijë lekë

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3.3% dhe 6%, shpenzimet kapitale programohen 165,358 mijë në vitin 2023, dhe 224,857 mijë në vitin 2024.

Shpenzimet e programit 04520 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.87

		Projekt Viti 2022										
Titulli Progr.	**Emertimi Programit**	**Totali**	**Shp. Korrente**	**600**	**601**	**602**	**603**	**604**	**606**	**Shp. Kapitale**	**230**	**231**
4520	Rrjeti rrugor rural	**217,173**	90,274	22,340	3,694	64,240	0	0	0	126,899	12,774	114,126
4520	Agjencia e Sherbimeve Publike	**90,274**	90,274	22,340	3,694	64,240	0	0	0	0	0	0
4520	Bashkia Berat	**126,899**	0	0	0	0	0	0	0	126,899	12,774	114,126

Shpenzimet operative analitike të programit 04220 në 000 lekë
Tabela nr.88

Llog. Ekonomike	Emertimi	Fakti 2019	Fakti 2020	plani 2021	11 mujori 2021	Plani 2022
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	120	830	380	268	0
6020100	kanceleri	120	120	120	88	0
6020200	mat.per pastrim	0		60	60	0
6020500	blerje dokumentacioni	0	80	80	80	0
6020900	furniz.dhe mat.te ndryshme	0	120	120	40	0
6		0	510	0	0	0

6021	**Materiale dhe sherbime speciale**	**120**	**239**	**240**	**240**	**240**
6021001	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	120	120	120	120	120
6021099	Vegla pune		119	120	120	120
6022	**Sherbime nga te tretet**	**661**	**118**	**250**	**147**	**0**
6022001	energjia elektrike	581		0	0	0
6022002	uje	48	75	200	109	0
6022003	Interneti	32	43	50	38	0
6023	**Shpenzime transporti**	**2,128**	**11,890**	**12,650**	**7,884**	**0**
6023100	karburant dhe vaj	1,796	8,016	8,550	7,114	0
6023100	Vajra makine	234	316	450	365	0
6023200	pj.kembimi,goma ,bateri	98	3,206	3,000	405	0
6023300	shpenz. Te sigurac.te mjet.Transp	0	352	650	0	0
6024	**Dieta**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
6025	**shpenz. Miremb. te zakonsh.**	**1,649**	**10,412**	**32,194**	**31,743**	**64,000**
6025400	Shp. per miremb. Rrjeti elektrik etj	1,155		0	0	
6025400	Shp. Per mirembajtje rruge	376	10,352	21,000	21,800	50,000
6025400	Shpenzime dekori	118	60	1,700	0	
6025800	shpenz.per miremb.kompjutera	0		50	0	
6025400	Shp. Miremb. Rruge te kontraktuara			9,444	9,943	14,000
6029	**shpenz.te tj.operative**	**0**	**11**	**0**	**0**	
	Total	**4,678**	**23,500**	**45,714**	**40,282**	**64,240**

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit
Përshkrimi i Programit:

Programi Rrjeti rrugor rural në Rajonet Nr.1 , Nr. 2 , Nr. 3 dhe Njesitë Administrative Roshnik, Otllak,Velabisht, Sinjë parashikon :
Mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve kryesore, trotuareve, segmenteve rrugore, rehabilitimin e kalldrëmeve, urave dhe shesheve me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve për komunitetin.
Mirëmbajtjen e sinjalistikës rrugore, vertikale dhe horizontale duke ofruar kushte të përshtatshme në qarkullimin e mjeteve dhe këmbësorëve.

Politika e Programit
Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t'iu mundësojë qytetarëve qarkullimin normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të ndriçimit publik dhe për shtimin e sipërfaqeve të ndriçuara.

Objektivat e Programit

- Zhvillimi i një sistemi efikas të transportit, të integruar në rajon dhe në rrjetin e BE-së, që nxit zhvillimin ekonomik dhe cilësinë e jetës së qytetarit.
- Të mirëmbahen 98 km rrugë me cakull në zonat rurale.
- Përmirësimin e rrjetit ekzistues të rrugëve të asfaltuara, të shtrirë në të gjithë qytetin, që t'u mundësojë qytetarëve qarkullim normal dhe komoditet në ecjen e këmbësorëve dhe mjeteve.
- Rritja e sipërfaqeve te shtruara me kalldrëm në masën 3 %, për periudhën 2022
- Te mirëmbahen trotuarët , kalldrëmet ekzistuese dhe të shtohen sipërfaqet e reja të tyre.

Produktet që synohen të ofrohen:

1. Mirëmbajtja e Rrugëve dhe trotuareve

Mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuarëve, përfshirë mirëmbajtjen e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara, si dhe shtimi i pusetave .
Ndërhyrje në disa akse rrugore dhe plotësimin e çdo emergjence sipas nevojës.

Sipërfaqja totale e rrugëve është 857,323 m^2 në të gjithë territorin e Bashkisë nga të cilat 239,231m^2 janë të trajtuara me asfalt dhe 618,092 m^2 me stabilizant.

Tabela nr.89

Fshatrat	Stabilizant m^2	Per 2022 per trajtim	Cakull m3
Velabisht	125000	15500m2	1550 m3
Otllak	167100	12000m2	1200m3
Roshnik	57000	17000m2	1700m3
Berat	129692	7000 m2	700 m3
Sinje	139300	11000m2	1100m3
Totali	**618 092**	**62500 trajtim**	**6250 m3**

- **Mirëmbajtje e urave**
  1. Ura e Goricës me gurë
  2. Ura e Varur (konstruksion me kavo çeliku)
  3. Ura e Re (konstruksion beton arme me parmak druri)
  4. Ura e Varur e Gjorovenit me dërrasa
  5. Ura e Varur e Lapardhasë me dërrasa

2. Mirëmbajtja e Rrugëve me kalldrëm dhe e Trotuareve

Mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me kalldrëm dhe shtimi i sipërfaqeve të reja .
Gjithsej kemi 81 942 m2 rrugë që do të mirëmbahen.

- ✓ **Për vitin 2022 do të shtohen 950 m2 të reja në këto segmente rrugore me kalldrëm** :
  1. Në Rajonin Nr. 2 : Rruga Gaqi Gjika 500 m2
  2. Në Rajonin Nr. 2 : Rruga Kostaq Koxhaku 180 m2
  3. Në Rajonin Nr. 2 : Rruga Veri Zaloshnja 130 m2
  4. Në Rajonin Nr. 3 : Rruga Berberi 40 m2

- ✓ **Ndërtime sheshe me pllakë trotuari 180 m2 në total**
  1. Në Rajonin Nr 1 : Në rrugën Antipatrea 65 m2 pllakë trotuari nga vendi i quajtur Ypsiloni deri tek Pallatet 6 Katëshi
  2. Në Rajonin Nr. 2 : Sheshi pranë ish maternitetit rruga Kondas 90 m2 pllakë trotuari
  3. Në Rajonin Nr. 2 : Sheshi Bulevardi Republika 25 m2 Pllakë trotuari

3. Mirëmbajtja e Rrugëve (Riparim) me asfalt, 2438 m2
  1. Në Rajonin Nr. 1 : Rruga "Agron Elezi" 1800 m2
  2. Në Rajonin Nr. 2 : Rruga "Koli Vesho" dhe rrugicat e brendshme të pallateve përkrah Stadiumt të Vjetër, 98 m2

3. Në Rajonin Nr. 2 : Rruga "Barjam Lila" te Tregu Industrial, 400 m2
4. Në Rajonin Nr. 3 : Rruga "Pavarësia", 140 m2

4. Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha , të larta dhe i pusetave në Njësinë Administrative nr. 1, nr. 2, nr. 3, Velabisht, Sinjë, Otllak, Roshnik.

- Në Njësinë Administrative Sinjë do të vendosen 20 tubo betoni
- Në Njësinë Administrative Velabisht do të vendosen 10 tubo betoni
- Në Njësinë Administrative Roshnik do të vendosen 15 tubo betoni
- Në Njësinë Administrative Otllak do të vendosen 15 tubo betoni
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të bardha në 830 zgara të vogla ekzistuese në Njësitë Admin. Nr. 1 , nr. 2 , nr. 3.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të larta në 35 zgara pritëse të mëdha në të gjithë territorin e bashkisë.
- Parashikohet të vendosen zgara pritëse për ujërat e larta 45 copë në të gjithë territorin e Bashkisë.

Në Rajonin Nr 1 : 12 copë
Në Rajonin Nr. 2 : 18 copë

Në Rajonin Nr. 3 : 15 cope

- Pastrimi i përrenjve të mëposhtëm :
  Përroi i Kananit
  Përroi i Lisit i të Becit
  Përroi i Suelasit
  Përroi Pusi i Meçanit
  Përroi i MCR
  Përroi në lagjen "1 Maji'
- Sistemimi i përroit të Avramit në lagjen 13 Shtatori
- Sistemimi i ujërave të bardha në lagjen Kala.

5. Mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore

- Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave , duke kryer të gjitha proçeset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.
- Vijëzimi i vijave të bardha të këmbësorëve me përmasa 3 x 0.5 m , në total 1700 m^2 në rrugët :
  - Rruga Antipatrea (Ura e Hanit – Uznovë e Madhe)
  - Rruga Ura e Re
  - Shëtitore Osumi
  - Rr. Santa Lucia
  - Sheshi i Axhensisë.
- Vijëzimi i vijave gjatësore trafik ndarëse me gjerësi 12 cm , në total 23.400 ml në rrugët
  - Rruga Antipatrea (Ura e Hanit – Uznovë e Madhe)
  - Rruga Ura e Re
  - Shëtitore Osumi
  - Rr. Santa Lucia

6. Ndërtime mure mbajtës në Bashkinë e Beratit për vitin 2022 : në total 204 m3

1. Në Rajonin Nr. 3 : Rruga "Vangjel Zoto" 120 m3 mur mbajtës
2. Në NJA Sinjë : Ndërtim muri në Fshatin Levan ndërtim muri mbajtës të Rrugës 84 m3

7. Ndërtime Segmente rrugësh me beton në pjesë të vështira në Bashkinë e Beratit për vitin 2022 : në total 1330 m2.

1. Njësia Administrative Otllak : 340 m2
2. Rajoni NR. 3 : Uznovë 300 m2
3. Rajoni Nr 2 : 620 m2
4. Njësia Administrative Velabisht 700 m2

8. Mirëmbajtja e rrugëve rurale të asfaltuara

Do të mirëmbahen rrugët rurale të asfaltuara, të cilat janë : (Inventari i rrugëve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015)

1. Rruga K/ Dushniku – Roshnik 1.1 km
2. Rruga Duhanas – Roshnik 8 km
3. Rruga K/Velabishtit – Starovë 1.5 km
4. Rruga K/ Gjerovenit – Gjeroven 4 km
5. Rruga K/ Duhanasit – Duhanas 4 km
6. Rruga K/ Bilçë – Malinat 18 km
7. Rruga Berat – Sinjë 22 km

9. Shtesa rruge me asfalt për vitin 2022

1. Rajoni Nr. 1 : Lagjja "Barrikadë", 1800 m2
2. Rajoni Nr. 2 : Lagjja "Çlirim", Rruga "Nezim Frakulla", 560 m2
3. Rajoni Nr. 2 : Rruga " Barjam Lila", 400 m2

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Shpenzimet e Programit 04520 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.90

								PBA 2022-2024
Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike							
Bashkia	Berat							
Programi	04520	Rrjeti rrugor rural						
		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxhet Fillestar	Buxhet i Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								

Paga	**600**	37,148	35,310	36,396	36,396	22,340	23,010	23,701
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	6,011	5,894	6,018	6,018	3,694	3,805	3,919
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	4,678	22,992	26,270	45,714	64,240	66,435	71,285
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**	84	98					
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**	256	10,320	20,170	20,170	12,774		
Aktive të Prekshme	**231**	105,782	27,767	63,292	79,652	114,125	165,358	224,857
TOTALI		**153,959**	**102,380**	**152,146**	**187,950**	**217,173**	**258,608**	**323,762**

Projektet e Investimeve të Programit 04520

Tabela nr.91 në 000 lekë

Emërtimi i projektit	Burimi i Financim	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Kerkime, studime, hartim projektesh	Fondet e veta	10,576	256	10,320	20,170	12,774		
Supervizime e Kolaudime	Fondet e veta	4,182	4,039	143	3,004	3,464		
Rik. I rruges Stadium i Vjeter Stadium i Ri (	Fondet e veta	59,051	26,812		485			
Rokonstr rrugesh, trotuar dhe ndricim 30 vjetori ish pjeshkorja	Fondet e veta	76,904	5,678	17,000	910	5,820		
Rikonstruksion i rrugeve te brendeshme dhe KUZ fshati Morave	Fondet e veta	12,750	2,657					
Blerje mjeti Fadrome	Fondet e veta	9,850		653				
Fasadat ne lagjen M. Celebiu	Fondet e veta	44,430	27,273		15,909			
Asfaltim dhe shtrim rrugesh me beton, m	Fondet e veta	60,669	36,706		3,500	7,841	12,622	
Shpronesim per interes publik	Fondet e veta			1,819	28,836	12,000		
Ndricim rrugesh ne fshatin Dyshnik	Fondet e veta	8,157		7,000	1,157			
Permiresim shtresa rrugore rruga Antipatrea Kryqezimi I spitalit Rajonal - By Pass	Fondet e veta				25,851	18,000	9,387	
Investime ne infrastrukturen rrugore	Fondet e veta					50,000	143,349	224,857
Bashkefinancim per investim ne infrastrukturen Rrugore	Fondet e veta					17,000		
Blerje pajisje per ndricim	Fondet e veta	900		900				
Rik. I ures se perroit sheshi axhensia dhe largimi I aluvioneve MCR	Fondet e veta	1,019	1,019					
Ndertim mure mbajtese	veta	1,598	1,598					
Pajisje dhe mjete Ndermarrja e Sherbimeve Publike	Fondet e veta			252				
Shpronesim per interes publik rruga "Muzak Topia"	Buxheti i shtetit				13,300			
Siguria rrugore Sponsorizim TAP	Donatore				258			

9. PROGRAMI 05100 : MENAXHIMI I MBETJEVE

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Mbledhja, depozitimi i mbeturinave, trajtimi, pastrimi i rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
05100	Menaxhimi i mbetjeve	Administrim, mbikëqyrje, inspektim organizim ose mbështetje e sistemeve të grumbullimit, trajtimit dhe eliminimit të mbetjeve; Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake. Grante, hua ose financime për të mbështetur ndërtimin, mirëmbajtjen ose përmirësimin e këtyre sistemeve; Pastrimi i rrugëve,parqeve etj.
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin :		Bashkia Berat (qendra)

Programi i menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane parashikon pastrimin, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane të qytetit nga vend grumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit tonë me qëllim përmirësimin e ambjentit dhe uljen e ndotjes së tij në qytet. Ky shërbim është shtrirë edhe në njësitë administrative të Bashkisë Berat. Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve higjieno – sanitare dhe mjedisore brenda standardeve bashkëkohore, krijimit të një ambienti sa më të pastër në blloqet e lagjeve dhe pallateve ku jeton komuniteti, si dhe në ambientet ku qytetarët të çlodhen, apo kalojnë një pjesë të kohës së tyre (në institucione publike si kopshte, shkolla etj.)

a) Situata aktuale

Në vitin 2019 u unifikua kontrata e shërbimit të pastrimit qytet dhe njësive administrative në një kontraktor, në bazë të proçedurës së prokurimit për periudhën 5 vjecare 2019-2024.
Gjatë vitit 2020-2021, është bërë një hap cilësor, ndonëse jo ende në nivelet e kërkuara e të synuara , por edhe u dha një shërbim i shtuar gjatë periudhës pandemike.
Me këtë shërbim të shtrirë në të gjithë hapësirën urbane të bashkisë për nga ana territoriale, ne kemi ende lagje në njësitë administrative tek të cilat duhet shtuar ky shërbim, ashtu sikurse dhe duhen rishpërndarë pikat e grumbullimit apo dhe shtesa të tyre në numër.

Ky shërbim sipas ndarjes administrative ofrohet në katër zona:

- Zona 1. Qyteti Berat
- Zona 2. Njësia Administrative Otllak
- Zona 3. Nj.A Sinjë + Velabisht
- Zona 4. Nj.A Roshnik + Fshati Duhanas

Duke marrë në konsideratë kërkesat për përmirësim e shërbimit të grumbullimit, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill, janë parashikuar kostot optimale që marrin në konsideratë:

- Zgjerim i shërbimit në territor.
- Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve.
- Uljen e kostos së transportit.
- Përdorimin me efiçiencë të mjeteve.
- Llogaritje më e mirë e normës së prodhimit të mbetjeve për çdo njësi, për familje dhe biznese, referuar historikut të të dhënave dhe përllogaritjeve që marrin në konsideratë vendosjen e popullsisë, dhe të bizneseve.
- Shtim i pikave të grumbullimit.
- Shtim i kontenierëve.
- Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit.
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në mënyrë më të automatizuar në të gjithë territorin.
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër.

b) Synimi i vitit 2021-2022

- Mbulimin me shërbime të shtuara, krahas kontratës, në të gjithë hapësirën urbane Bashkisë.
- Rritje e frekuencës së shërbimit të mbledhjes, transportimit dhe depozitimit të mbetjeve në landfill.
- Optimizimin e kostove të transportit.
- Përdorimin me efiçiencë të mjeteve të punës.
- Përmirësimin e sigurisë në rrugë përmes krijimit të hapësirës së përshtatshme për vendosjen e pikave të grumbullimit.
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të paster.

c) Aktivitetet kryesore gjatë vitit 2021

- Realizimi i shërbimit të Pastrimit i kontraktuar me sipërmarrje private.
- Riorganizimi i PGM dhe rritja e numrit të tyre duke shtuar dhe numrin e kazanëve.
- Sensibilizimi për rritjen e bashkëpunimit me komunitetin dhe ndërgjegjesimi i tyre për diferencimin e mbetjeve që në burim.
- Bashkëpunimi me shkollat, institucionet dhe biznesin për rritjen e interesit për ndarjen e mbetjeve të ricikluesshme.
- Hartimi i rregullores për marëdhëniet mes pushtetit vendor, sipërmarrësve të shërbimit, bizneseve, institucioneve dhe familjarëve për mënyrën e trajtimit të mbetjeve urbane dhe masat administrative për kundravajtësit.
- Vazhdimi i depozitimit të të gjitha MU në Landfillin
- Sistem monitorimi me gjithëpërfshirës, inspektorët e lagjeve, administratorët e njësive, kryepleqtë si dhe duke bërë pjesë dhe komunitetin.
- Eliminimi i mbeturinave urbane nga vend depozitimet e palejueshme me mjetet e Bashkisë si dhe kryerjen e shërbimit në ato zona të paparashikuara në sipërmarrjet private.
- Investime për infrastrukturë mbështetëse për realizimin e shërbimit.

Rezultati i pritshëm për vitin 2022.

- Shërbim të shtuar në territorin e Bashkisë.
- Përditësim i kostos së këtij shërbimi.
- Monitorim i qëndrueshëm dhe raportim online nga supervizorët dhe inspektorët e lagjeve.

Për shërbimin e Pastrimit në Njësitë Administrative.

- Realizimi i shërbimit të grumbullim transportit të mbeturinave në të njëjtat standarte si në qytet.
- Plotësimi me kontenierë metalikë në pikat e grumbullimit të mbeturinave duke rritur rendimentin e punës, duke eleminuar problemet mjedisore si dhe ofrimin e shërbimit me përmirësim standartesh.
- Rritja e numrit të përfituesve të shërbimit në pjesën më të madhe të njësive administrative. Depozitimi i të gjitha mbetjeve urbane në landfillin dhe eleminimi i vend depozitimeve të pamiratuara.
- Eliminimi i mbeturinave urbane nga vendepozitimet e palejueshme.
- Rritje të ndërgjegjësimit dhe edukimit mjedisor për menaxhimin e mbetjeve urbane, nga ana e banorëve dhe bizneseve.
- Pika të vendgrumbullimit të mbetjeve të sistemuara dhe definitive, nga realizimi i xhepave.
- Reduktim i sasisë së mbetjeve që depozitohen në landfill, nëpërmjet rritjes së sasisë së mbetjeve të ricikluesshme në masën e programuar në projektin për trajtimin e mbetjeve.

Landfilli i mbetjeve Urbane

Investimi i realizuar nga projekti i Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve, financuar nga Sekretariati i Shtetit Zviceran për Çështje Ekonomike SECO, mbështetur nga INFRASTRUKTUR & UMËELT, në konsorcium me SEHLHOFF dhe FLAG, Faza 1, konsistoi në rehabilitimin e venddepozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Berat.

Situata e Vlerësuar

- U krye mbyllje e menjëhershme e vend depozitimit dhe rehabilitimi i zonës.
- Përmirësimi dhe përgatitja e territorit për një përdorim të mëtejshëm prej 5 vjetësh.
- Zgjerimi i zonës me 2 ha shtesë në veri, për të lejuar praktika më të mira efikase depozitimi.
- Ndërtimi i argjinaturës me gjatësi 400 m për të mbrojtur trupin e vend depozitimit nga Lumi Osum.
- Portë metalike dhe rrethimi i zonës së vend depozitimit për të kufizuar të drejtën e hyrjes në të.

Është përllogaritur kostoja për mirëmbajtjen dhe funskionimin e venddepozitimit aktual të mbetjeve për një periudhë 5-vjeçare, pasi investimi i kryer kërkon proçese pune të cilat nuk janë parashikuar në kontratën dhe buxhetin e pastrimit.

Sipas një përllogaritje paraprake kostoja për mirëmbajtjen dhe funksionimin e vend depozitimit aktual të mbetjeve për një periudhë 5-vjeçare është 28,058,400 lekë.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 05100 Menaxhimi i Mbetjeve është planifikuar në shumën 79,124 mijë Lekë, dhe zë 6.5% të buxhetit total.

Për vitin 2022 :
Kosto operacionale për të gjitha aktivitetet e këtij shërbimi është parashikuar 73,724 mijë lekë. Në buxhetin e vitit 2022 janë përfshirë 4,600 mijë lekw për mbulimin e efekteve të ndryshimit të pagës minimale, sipas kontratës me operatorin që kryen shërbimin.
Përveç shpenzimeve për shërbimin e pastrimit nga kontraktori, në koston operacionale të këij prorami janë përfshirë edhe 1,400 mijë lekë të parashikuara për mirëmbajtjen dhe funksionimin e landfill-it.
Shpenzimet kapitale janë parashikuar në shumën 5,400 mijë lekë.
Në këtë program përfshihet 1 projekt investimi:
1.Blerje kontenierë copë 180, projekt me vlerë 5,400 mijë lekë .

Sipas komunikimit të bërë nga zyrtarë të Ministrisë së Financave në ëebinarin e datës 09.12.2021, jemi njoftuar se në fillim të vitit 2022 do të kemi akordim fondesh për menaxhimin e mbetjeve.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 1%; shpenzimet kapitale për vitin 2023 sipas kontratës 3,780 mijë lekë, për vitin 2024 nuk janë planifikuar shenzime kapitale.

Shpenzimet e programit 05100 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.92

		Projekt Viti 2022										
Titulli Progr.	Emertimi Programit	Totali	Shp. Korrente	600	601	602	603	604	606	Shp. Kapitale	230	231
5100	Menaxhimi i mbetjeve	**79,124**	73,724	0	0	73,724	0	0	0	5,400	0	5,400

Shpenzimet e Programit 05100 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.93

PBA 2022-2024

Raport	Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike	
Bashkia	Berat	
Programi	05100	Planifikim, menaxhim, administrim

		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019	2020	2021	2021	2022	2023	2024
		Fakt	Fakt	Buxhet Fillestar	Buxhet i Pritshëm	Plani	Plani	Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	2,071						

Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	380						
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	35,350	56,399	83,436	110,625	73,724	74,461	75,206
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	1,800	6,999	20,247	20,247	5,400	3,780	
TOTALI		**39,601**	**63,398**	**103,683**	**130,872**	**79,124**	**78,241**	**75,206**

Projektet e Investimeve të Programit 05100

në 000 lekë

Tabela nr.94

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
05100	Bashkefinancim (Menaxhimi e mjeteve te ngurta ne Qarkun e Beratit, rruga inerte	Fondet e veta	21,486		3,399	18,087			
05100	Blerje kontenieresh	Fondet e veta	17,208	1,800	3,600	2,160	5,400	3,780	

10. PROGRAMI 06440 : NDRIÇIM RRUGËSH

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Sigurimi i ndriçimit të rrugëve dhe mjediseve publike në njësinë e vetëqeverisjes vendore.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
06440	Ndriçim rrugësh	Administrim, instalim, vënie në funksionim, mirëmbajtje, përmirësim i ndriçimit të rrugëve, mjediseve publike; Zhvillimi dhe rregullimi i standarteve të ndriçimit rrugor.
Njësia shpenzuese që menaxhon programin		• Agjencia e Shërbimeve Publike (për shërbimet korrente) • Bashkia Berat, (për shërbimet kapitale)

Buxheti i vitit 2022 për programin 06440 Ndriçim rrugësh është planifikuar në shumën 49,976 mijë Lekë, dhe zë 4.1 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 3,387 mijë Lekë ose në masën 7.3 %. Rritja bëhet në shpenzimet kapitale të cilat dyfishohen në raport me planin e vitit 2021 . Rritje ka edhe në shpenzimet për pagat, për arsye sepse është shtuar struktura me 3 punonjës.

Ky program menaxhohet nga njësitë shpenzuese :
- Agjencia e Shërbimeve Publike për shpenzimet korrente, shuma 43,786 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 6,190 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 4,186 mijë lekë, për 7 punonjës. Numri i punonjësve është rritur me 3 nga viti 2021. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me ritje në shumën 2,053 mijë lekë ose në masën 96 %.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 39,600 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me ulje në shumën 1,611 mijë lekë , pasi në vitin 2021 u programuan për likujdim detyrime të prapambetura.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 6,190 mijë lekë.
Në këtë program përfshihet 1 projekt :
1 Bashkëfinancim për projektin me financim të huaj SMART ENERGY
Projekti ‘’ **SMART ENERGY** ’’ financohet nga Qeveria Zviceriane në shumën prej 72,884,020 lekë dhe synon ndërhyrje pilot në ndriçimin e dhjetë akseve rrugore në qytet, duke përdorur energjinë efiçiente në ndriçim. Projekti do të zbatohet në periudhën Shtator 2021-Dhjetor 2023.
Bashkia Berat është një ndër katër Bashkitë e përfshira në Projekt , dhe sipas Marrëveshjes së Financimit duhet të mbulojë bashkëfinancimin në shumën 6,189,500 lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, shpenzimet kapitale 0.

Shpenzimet e programit 06440 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.95

Titulli Progr.	Emertimi Programit	Totali	Shp. Korrente	600	601	602	603	604	606	Shp. Kapitale	230	231
6440	Ndricimi Publik	**49,976**	43,786	3,592	594	39,600	-	-	-	6,190	-	6,190
6440	Bashkia Berat	**6,190**	0	-	-	-	-	-	-	6,190	-	6,190
6440	Agjencia e Sherbimeve Publike	**43,786**	43,786	3,592	594	39,600	-	-	-	-	-	-

Shpenzimet operative analitike të programit 06440 në 000 lekë
Tabela nr.96

Llog. Ekonomike	Emertimi	Fakti 2019	Fakti 2020	plani 2021	11 mujori 2021	Plani 2022
6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	0	0	0	0	0
6021	Materiale dhe sherbime speciale	0	0	0	0	0
6022	Sherbime nga te tretet	17,543	29,647	25,211	21,988	30,600
6022001	energjia elektrike	17,440	29,647	25,211	21,988	30,600
6022002	uje	79			0	
6022003	Interneti	24			0	
6025	Shpenz. Mirembajtje te zakonshme	1,996	120	6,000	945	9,000

6025400	Shp. per miremb. Rrjeti elektrik etj	1,960	0	6,000	945	9,000
6025400	Shp. Per mirembajtje rruge	36	120		0	
	te trasheguara 602	0		11,800		
	Total	19,539	29,767	43,011	22,933	39,600

Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit

Objektivat e Programit

- Të mirëmbahet rrjeti ekzistues i ndiçimit publik dhe të mundësohet mbulimi i zonave të reja me ndriçim. Shtimi i rrjetit te ndriçimit.

Produktet që synohen të ofrohen:
I . Mirëmbajtja e ndriçimit rrugor

- Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndriçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndriçuesish ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
- Programe manaxhimi dhe ekonomizimi te energjise elektrike nëpërmjet zëvendësimit të llampave ekzistuese me llampa ekonomike led.
- Shtim i gjatësive të ndricuara në masën 3 km (nga këto 2 km do të plotësohen me blerjen e ndricuesve të rinj dhe 1 km nga heqja e ndricuesve të vjetër).

Duke analizuar gjendjen dhe situatën faktike të rrjetit, në vitin 2022 janë planifikuar të blihen :

Rajoni Nr 1

- Zëvëndësimi i ndriçuesve me të rinj led, 50 copë
- Zëvëndësimi i telave me kabull deri në 2000 ml
- Zëvëndësimi i llambave me llamba të reja 40Ë, deri n 200 copë
- Sistemimi i ndriçimit të Rrugës së re "Stavër Naco".
- Sistemimi dhe mirëmbajtja e ndriçimit në rrugën Antipatrea, duke zëvendësuar llambat e djegura dhe duke riparuar shtyllat ekzistuese
- Sistemimi i kasetave me lëshues dhe automat dhe sensor muzgu
- Shtimi i sipërfaqes së ndricuar në lagjet që nuk ka ndriçim

Rajoni Nr 2

- Në lagjet "Mangalem" dhe "Goricë" do të bëhet sistemimi dhe riparimi i linjave ekzistuese, si edhe shtim i rrjetit të ndricimit. Do të vendosen llamba të reja dhe 2000 ml kabull, duke zëvendësuar telat
- Në lagjen "Ylli i Kuq" do të zëvendësohen llambat me koka Led të reja - 50 copë.
- Në lulishten dhe bulevardin kryesor dhe tek Rruga e Lumit do të bëhet zëvendësimi i kokave led të djegura me të reja
- Në lagjen "30 Vjetori" do të bëhet riparimi i linjave dhe zëvendësimi i llambave të djegura
- Në Lagjen "Kala" do të bëhet riparimi i ndriçuesve duke zëvendësuar me llambë injektor drozer.

- Në Lagjen "Jani Vruho" do të riparohen ndriçuesit ekzistues me llampa dhe koka të reja - 50 copë.
- Në lagjen "Gaqi Gjika" , do të bëhet riparimi i kokave me llamba drozer injektor 100 copë .

Rajoni Nr 3

- Në rrugën "Antipatrea" do të bëhet zëvëndësimi i kokave të vjetra me koka led 100ë të reja,100 copë.
- Në lagjen e quajtur "Vakëf" do të bëhet zëvendëismi i llambave të vjetra me llamba të reja led 50Ë, 50 copë
- Në lagjen "Vakëf" do të bëhet zëvëndësimi i linjave me kabull të ri deri në 1000 ml
- Në Uznovë do të riparohen kokat e vjetra me llampa të reja drozer dhe injector, 50 copë
- Tek Tregu Industrial do të bëhë zëvendësimi i kokave me koka Led 100 copë dhe zëvendësimi i telave me kabull 1000 ml.
- Në lagjen "Donika Kastrioti" do të bëhet riparimi i kokave me llamba droser , injektor , 100 copë.

Njësia Administrative Otllak

- Fshati Otllak, Riparimi i linjes me kabull ne gjatesine 1000 ml.
- Fshati Orize , zevendesimi i llambave me llamba led 40 Ë,50 copë
- Fshati Dushnik , Linje e re ndricimi 1000 ml
- Fshati Lapardha 1 , Linje e re ndricimi 1000 ml.
- Fshati lapardha 2 , Linje e re ndricimi 500 ml
- Fshati Morave ,riparimi i kokave me llamba drozer te reja, 50 copë

Njësia Administrative Sinjë

- Fshati Sinjë, zëvendësim llambash me llamba led. Cope 50 .
- Fshati Mbreshtan zëvendësim llambash dhe shtim ndricimi ml 1000
- Fshati Galinë , riparim i llamabve 20 cope

Njësia Adminitrative Velabisht

- Fshati Velabisht, Shtim i sip. se ndricuar me 1000 ml
- Fshati Starove, Shtim ndricim te ri me 1000 ml
- Fshati Veterrik, Shtim ndricim te ri me 1000 ml
- Fshati Duhanas, Shtim ndricim te ri me 1000 ml
- Fshati Bilçë, Shtim i ndricimit te ri me 1000 ml

Njësia Adminitrative Roshnik

- Fshati Roshnik , Riparim i linjes ekzistuese 2000 ml me kabull të ri dhe koka Led 50 copë.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Shpenzimet e Programit 06440 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.97

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia	**Berat**
Programi	06440 **Ndriçimi rrugor**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	1,094	1,680	1,830	1,819	3,592	3,700	3,811
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	280	255	303	303	594	612	630
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	19,539	29,767	41,211	43,011	39,600	40,788	42,012
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**			150	161			
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**			3,095	3,095	6,190		
TOTALI		**20,913**	**31,702**	**46,589**	**48,389**	**49,976**	**45,100**	**46,453**

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.98 në 000 lekë

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
06440	Projekti Smart energji, bashkefinancim	Fondet e veta				3,095	6,190		

11. PROGRAMI 06260: SHËRBIMET PUBLIKE

Përshkrim i Përgjithshëm i Programit		
Veprimtari për zhvillimin dhe përmirësimin e jetesës.		
Kodi i Programit	**Emri i Programit**	**Përshkrimi i Programit**
06260	Shërbimet publike vendore	Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin; Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbër të njësisë së vetëqeverisjes vendore; Shërbimi i dekorit të qytetit në raste festash Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e varrezave publike dhe të dëshmorëve, si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit; Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike. Të gjitha shërbimet e tjera publike sipas specifikimeve të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore;
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		• Agjencia e Shërbimeve Publike • Bashkia Berat (qendra)

A . SHËRBIMI I GJELBËRIMIT

Qëllimi : Sigurimi për mirëmbajtjen dhe rehabilitimin e të gjitha zonave aktuale të gjelbërta dhe miniparqeve .

Objektivi : Rritja e sipërfaqeve të gjelbërta dhe mirëmbajtja për vitin 2022 në 0.14%.

Produket e shërbimit të gjelbërimit jepen më poshtë :

1. Sipërfaqe të gjelbërta aktuale të mirëmbajtura me një kosto prej 1.980.000 lek
a. Blerja e karburantit për operacionet e automjeteve prej me një mesatare prej 500 km në javë
b. Blerje e 209 fidanëve
c. Kositja dhe krasitja e barit
2. Sipërfaqe fidanishte e mirëmbajtur me një kosto prej 400.000 lek
a. Prokurimi i plehrave organikë dhe kimikë
b. Hapje e një pusi për vaditjen e fidanishtes.

3. Siperfaqe të gjelbërta të reja të krijuara në qytet me një kosto prej 570.000 lek
a. Ndërtimin dhe sistemimin e parcelave te reja të gjelbërta në qytet
b. Prodhimin e 100 koshave per mbeturinat të cilat do të montohen në këto sipërfaqe të reja
4. Parqe të mirëmbajtura me një kosto prej 890.000 lek
a. Blerjen e karburantit per operacionin e automjeteve me një mesatare prej 500 km në javë
b. Prodhimin e 100 koshave për mbeturina
c. Mirëmbajtjen e 250 stolave
5. Mirëmbajtja e automjeteve dy herë në vit me një kosto 733.000 lek

a. Prokurimi për shërbimet kryesore dhe të vogla
b. Siguracionet dhe taksat për automjetet

6. Për të realizuar të gjitha produktet e parashikuara na nevojiten shpenzime për paga sigurime shoqërore në vlerën 30.291.000 lek

7. Shërbime mbështetëse 586.000 lek

Në total buxheti për vitin 2022 për shërbimin e gjelbërimit është 33,017 mijë lekë.
Për vitet 2023, 2024 eshtë parashikuar një rritje të shpenzimeve me 3% në vit.

B. MIRËMBAJTJA E VARREZAVE PUBLIKE DHE VARREZAVE TË DËSHMORËVE DHE SHËRBIMI I VARRIMIT

a) Situata e Shërbimit të mirëmbajtjes së Varrezave Publike
Gjatë vitit 2021 është realizuar mirëmbajtja e varrezave publike në Bashkinë Berat me sipërmarrje private me kontratë 5-vjeçare: Shërbimet kryesore që kryhen janë:

- Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave
- Mbjellje drurësh dekorativë
- Mbjellje në parcela bordurë e gjelbër

b) Shërbimi i ruajtjes për varrezat publike dhe ato të dëshmorëve.
Situata e Vlerësuar

1. Pjesë e shërbimit mungon një rregullore e përditësuar për ofrimin e shërbimit publik të varrezave.
2. Në pjesën më të madhe të njësive, administrimi i varrezave bëhet nga vetë komunitetet apo nga institucione fetare.
3. Në fshatra të njësitë administrative pjesë e Bashkisë Berat, kërkohet vlerësimi dhe planifikimi për shpronësim të hapësirave të reja në funksione të shërbimit të varrezave.

c) Në vitin 2022

- Ofrimi i shërbimit publik të mirëmbajtjes së varrezave dhe shërbimit funeral nga Bashkia Berat me burimet e veta, dhe shtim të ofrimit të këtij shërbimi në një sipërfaqe të shtuar të territorit administrativ të Bashkisë Berat .
- Fuqizim i bashkëpunimit me komunitetin, institucionet e besimeve fetare për një mbarëvajte komunitare të këtij shërbimi në të gjithë territorin.
- Pasi janë vlerësuar nevojat për zgjerim territori për varreza publike në Nj.A, pritet të përfundojnë proçedurat e shpronësimit.

Aktivitetet kryesore

- Hartimi i Planit të veprimit dhe rregullores për ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes dhe administrimit të varrezave.
- Vlerësimi i nevojave të Njësive Administrative për zgjerim territori për varreza
- Ofrim i shërbimit të standartizuar për varrezat publike.
- Rritje e performancës së ofrimit të shërbimit nëpërmjet një sistemi më efikas të matjes dhe monitorimit.
- Zgjerim territori për varreza në Njësitë Administrative.

Fondet e parashikuara për vitin 2022 për këtë shërbim janë 15,198 mijë lekë.

C. SHËRBIMI I DEKORIT PUBLIK

Shërbimin e dekorit Bashkia Shkodër e realizon me burimet e veta financiare, me mjetet logjistike e fuqinë punëtore të Agjencisë së Shërbimeve Publike. Shërbimi i dekorit konsiston në dekorimin e qytetit për festat e fund vitit, si edhe në rastet e festave të tjera zyrtare dhe aktivitete të ndryshme të Bashkisë gjatë gjithë vitit, si festat e nëntorit, dita e çlirimit të qytetit, festat fetare, dita e verës, festa e nënës, festa e fëmijëve, etj.
Fondet e parashikuara për vitin 2022 për këtë shërbim janë 1,697 mijë lekë.

Plani i Shpenzimeve Totale të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 06260 Shërbimet Publike Vendore është planifikuar në shumën 96,082 mijë Lekë, dhe zë 7.9 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 37,779 mijë Lekë ose në masën 65 %. Rritja bëhet për arsye të riorganizimit të njësive shpenzuese, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, por edhe për menxhimin eficient të burimeve njerëzore dhe mjeteve të shërbimeve publike.

Ky program menaxhohet nga njësitë shpenzuese :
- Agjencia e Shërbimeve Publike , shuma 89,787 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 6,295 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 59,125 mijë lekë, për 100 punonjës. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 19,514 mijë lekë ose në masën 49.3 %. Shtesa vjen për arsye të riorganizimit të njësive shpenzuese , si edhe për arsye të marrjes nga bashkia të shërbimit të mirëmbajtjes së varrezave publike dhe të dëshmorëve, i cili kërkon 17 punonjës shtesë për realizimin e shërbimit.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 29,662 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 20,970 mijë lekë. Rritja vjen për arsye të riorganizimit të njësive shpenzuese, me qëllim të përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, por edhe për menxhimin eficient të burimeve njerëzore dhe mjeteve të shërbimeve publike. Shpenzimet operative janë në mbështetje të funksionimi të Agjencisë së Shërbimeve Publike në sektorët e : gjelbërimit e dekorit , mirëmbajtjes së varrezave, sektorit mekanik dhe mjeteve të transportit të shërbimeve publike, si edhe të administratës së kësaj agjencie.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 7,295 mijë lekë.
Në këtë program përfshihen 4 projekte investimesh :
1. Pemë dekorative për lagjet e qytetit, në shumën 800 mijë lekë
2. Pus uji për vaditjen e fidanishtes, në shumën 200 mijë lekë
3. Blerje mjeti fadromë, bashkëfinancim me Ambasadën Japoneze, në shumën 2,013 mijë lekë
4. Blerje mjete të shërbimeve publike, bashkëfinancimi me TAP, në shumën 4,282 mijë lekë.

Ky projekt ka nisur në vitin 2021, dhe përfundon në janar 2022 me blerjen e mjetit të fundit.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, shpenzimet kapitale janë parashikuar për blerje pemë dekorative në shumat 820 mijë dhe 850 mijë sipas viteve 2023 e 2024.

Shpenzimet e programit 06440 për vitin 2022 në 000 lekë

Tabela nr.99

Titulli Progr.	Emertimi Programit	Totali	Shp. Korrente	600	601	602	603	604	606	Shp. Kapitale	230	231
6260	Shërbimet publike vendore	**96,082**	88,787	50,735	8,390	29,662	-	-	-	7,295	-	7,295
6260	Bashkia Berat	**6,295**	0	-	-	-	-	-	-	6,295	-	6,295
6260	Agjencia e Sherbimeve Publike	**89,787**	88,787	50,735	8,390	29,662	-	-	-	1,000	-	1,000

Shpenzimet e programit 06260 të Agjencisë së Shërbimeve Publike në 000 lekë

Tabela 100

Kod Programi	Agjencia e Sherbimeve Publike	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korre	Transf.per Buxh	Shp. Kapitale	Shp. Kapitale te
				600	601	602	603	604	606	230	231
6260	Sektori i Gjelbërimit dhe Pastrimit	54	**33,017**	25,993	4,298	1,726	0	0	0	0	1,000
6260	Dekori		**1,697**	0	0	**1,697**	0	0	0	0	0
6260	Sektori i Mirëmbajtjes së Varrezave F	18	15,198	9,072	1,500	4,626	0	0	0	0	0
6260	Sektori Mekanik dhe Transportit	13	**28,697**	6,748	1,116	20,833	0	0	0	0	0
6260	Administrata e Agjencise	6	6,213	4,662	771	780	0	0	0	0	0
6260	Roje & sanitare ne objekte dhe tregje	9	4,965	4,260	705	0	0	0	0	0	0
	Total	**100**	**89,787**	**50,735**	**8,390**	**29,662**	**0**	**0**	**0**	**0**	**1,000**

Shpenzimet e Programit 06260 sipas Kategorive ekonomike

Tabela nr.101

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	06260	**Sherbime publike vendore**

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	28,233	32,530	33,990	33,967	50,735	52,257	53,825
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	4,789	5,407	5,621	5,671	8,390	8,642	8,901

Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	5,608	6,755	8,610	8,995	29,662	30,552	31,468
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**	42	198	82	205			
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	150	240	10,000	11,300	7,295	820	850
TOTALI		**38,822**	**45,129**	**58,303**	**60,138**	**96,082**	**92,271**	**95,044**

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr.102 në 000 lekë

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
06260	Blerje mjete per sherbimet publike	Fondet e veta				11,300	4,282		
06260	Nd. Gjelberimit, (Hapesira te gjelberta, Lulishte, blerje pemesh)	Fondet e veta	240		240		800	820	850
06260	Pus Uji per vaditje Parku, Agjensia e Sherbimeve, Sektori I gjelberimit	Fondet e veta					200		
06260	Pajisje dhe mjete Ndermarrja e Gjelberimit	Fondet e veta	150	150			2,013		

12. PROGRAMI 08220: TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTE ARTISTIKE DHE KULTURORE

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Organizim, mbështetje e ngjarjeve kulturore në njësinë e vetëqeverisjes vendore; mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore.		
Emri i Programit	**Përshkrimi i programit**	**Përshkrimi i programit**
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	• Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i vlerave të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrim i objekteve që lidhen me ushtrimine këtyre funksioneve; • Mbështetja e vendeve historike, kopshteve zoologjike dhe botanike; • Zhvillim, mbrojtje dhe promovim i bibliotekave, e të ambienteve për lexim me qëllim edukimin e përgjithshëm qytatar; • Mbështetje për muzeumet, galeritë e arteve, teatrot, sallat e ekspozitave; • Organizim ose mbështetje për ngjarjet kulturore (koncerte, prodhime skenike dhe filma, shfaqje artistike etj.); • Sigurim i shërbimeve kulturore; administrim i çështjeve kulturore; mbikëqyrje dhe rregullim i strukturave kulturore; • Organizim i aktiviteteve kulturore dhepromovim i identitetit kombëtar e lokal.
Njësitë Shpenzuese që menaxhojnë programin		• Qendra Kulturore "M. Tutulani" • Bashkia Berat (qendra)

Politika e Programit: Politika e këtij programi synon krijimin e një jete sa më të pasur kulturore dhe sociale për qytetin e Beratit duke përfshirë të gjitha grupmoshat dhe nivelet e ndryshme sociale që bashkëjetojnë në Berat dhe promovimin e një qyteti sa më tërheqës dhe konkurrues për tregun e biznesit dhe të vizitorëve.

Objektivat e politikës së programit.
Rritja e cilësisë së shfaqeve artistike që jepen nga institucioni, me qëllim që t'i japë një hapësirë edhe më të plotë jetës artisike dhe kulturore jo vetëm duke u mbështetur në rivitalizimin e mëtejshem të projekteve ekzistuese , të cilat janë kthyer tashmë në një traditë për qytetin, por duke i dhënë hapësira të reja për projekte të tjera inovatore të cilat vijnë pranë qëndrës Kulturore nga persona të tretë.

Produkti 1.1.A Aktivitete kultorore dhe artistike.
Për vitin 2022 me kosto financiare 1,050,000 lekë
Buxheti i parashikuar për aktivitetet kulturore të vitit 2022 është 1,050,000 lekë.
Nga ana jonë janë hartuar projekte për aktivetete kulturore të cilat parashikohet të kenë kosto totale 4,012,000 lekë. Në këto kushte do të shihet mundësia për të gjetur donacione në shumën 2,962,000 lekë.
Duhet të cilësojmë se lista e projekteve artistike që do të marrin jetë në vitin 2022 do të miratohet nga Këshilli Artistik, deri në fazën përfundimtare të përgatitjes së buxhetit të vitit 2022 dhe pba 2022-2024.

Më poshtë japim listën e projekteve të ideuara në këtë fazë, të cilat do të kalojnë për shqyrtim e miratim në Këshillin Artistik.

Lista e Projekteve dhe vlerat përkatëse Qendra Kulturore "Margarita Tutulani"

Tabela nr. 103 ***në 000/lekë***

Nr	Emërtimi i aktivitetevev. 2022	Vlera	Financimi
1	"Karnavalet e Beratit"	400	Bashkia Berat, Donator
2	""I Pari Tingull"	100	Bashkia Berat, Donator
3	"Rock-n-roll day"	110	Bashkia Berat, Donator
4	."One Hoop Festival" Festivali Humorit Berat	600	Bashkia Berat, Donator
5	"Luaj dhe Vallëzo " 1 Qershor Dita e Femijeve	100	Bashkia Berat, Donator
6	Kampi veror	300	Bashkia Berat, Donator
7	Koncert " Vokal – Instrumental " Dita Nderkombëtare e Muzikës	72	Bashkia Berat, Donator
8	"Hapat festiv" Fundjavat ne berat qershor – gusht 2022	1.000	Bashkia Berat, Donator
9	Festivali "Folk Art" Dita e turizmit malor dhe Trashëgimisë Kulturore	300	Bashkia Berat, Donator
10	"Triptik Kulturor" 27 – 28 -29 Nëntor	150	Bashkia Berat, Donator
11	Java Artistike e Ditëve Festive 2022	550	Bashkia Berat, Donator
12	Konkurrimi i Kenges Qytetare Beratase ne Elbasan	70	Bashkia Berat, Donator
13	Konkurrim Festivali Folklorik Gjirokaster	200	Bashkia Berat, Donator
14	Konkurrim i Bandave frymore Shkoder	30	Bashkia Berat, Donator
15	Konkurrim i Orkestres simfonike Elbasan	30	Bashkia Berat, Donator
Total Kosto Financiare		**4.012**	

Projekti 1 : "Karnavalet e Beratit"

Pershkrim i Aktivitetit

Pjesëmarres ne aktivitet do të jenë grupet rinore. shkollat,kopshtet.Grupet do të mblidhen në orën 10.00 në sheshin kryesor të qytetit. Do të jenë gjithsej 16 grupe që do të marrin pjesë. Çdo grup do të ketë nga një flamur që do të simbolizojë shkollën pjesëmarrëse. Një anëtar i grupit do të mbajë flamurin e shkollës apo të grupit. Çdo grup do të ketë një vullnetar që do të kujdeset për shkollën apo për grupin përkatës gjatë gjithë karnavaleve. Në orën 9.30, në sheshin kryesor të qytetit do jetë një foni me muzike. Aty do të pozicionohenanimatorë me face-paiting dhe do të pikturohen fytyrat e njerëzve të cilëve nuk janë pikturuar. Ndërkohë në ritmin e muzikës do të performohen disa pantomima dhe numra magjie nga dy klonua të cilët bashkë me këmbëgjatin më pas do të nisen në paradë bashkë me të gjithë të pranishmit.Në orën 10.30 do të niset parada nga sheshi qendror i qytetit. Parada do të prihet nga një makinë e cila do të ketë muzikë karnavalesh si dhe nga Cirku Kombëtar.Nga sheshi qendror parada kalon te Sheshi i ish- Axhensisë, dhe vazhdon përgjatë rrugës ''Antipatrea'' deri tek busti i Babë Dudës (pranë

Urës së Varur). Më pas parada do të kthehet tek busti i Babë Dudës dhe hyn në shëtitoren pedonale '' Republika'' dhe ndalon para Pallatit të Kulturës.Përgjatë itinerarit do te ketë thirrje me gramafon për të marrë pjesë në shesh për karnavalet;Përpara Pallatit të Kulturës do të jenë

të vendosur fëmijë të vegjël të cilët do të fillojnë të lëvizin përpara. Grupet vijojnë të lëvizin nga Pallati i Kulturës përgjatë shëtitores Republika dhe do të mbërrijnë në sheshin qendror.Në Sheshin Qendror, vullnetari përkatës do t'i tregojë grupit pjesëmarrës se ku do të qëndrojë çdo grup gjatë karnavaleve.Në sheshin kryesor do të caktohet një vend se ku do të vendosen fëmijët e vegjël dhe do të ketë edhe shumë aktivitete të tjera për fëmijët si face-painting, kloun, maskota.Pas mbërritjes në shesh, do të vendoset muzikë karnavalesh dhe grupet do të kërcejnë sipas muzikës së vendosur. Pas kërcimit të grupeve do të ketë një performancë nga Cirku Kombëtar.Më pas do të ketë performancë muzikore nga grupe muzikore kombëtare dhe vendase. Në fund, juria do të japë çmimin e parë e cila do të simbolizohet përmes një trofeu si dhe dy çmime të tjera me anë të një certifikate.

Tabela nr.104 *në 000/lekë*

Buxheti				
Nr.	**Artikulli**	**Çmimi**	**Sasia**	**Shuma**
1	Printim i Ftesave	-	200	2
2	Postera	-	10	2
3	Printimi i Certifikatave	-	20	2
4	Maska kapele veshje		400	94
5	Pagesë për Artistë	-	4	100
6	Cirku	80	-	80
7	Materiale Dekori	-	-	100
8	Skenografi			20
	Totali			**400**

Projekti 2 : "I Pari Tingull"

Bashkia Berat,Qendra Kulturore "M.Tutulani", Q.K. Femijeve në kuadër të "Edukimit permes Artit" do të realizojnë projektin "Tingulli I Parë", me nxënësit e shkollave 9-vjecare. Ky projekt synon të njohë të rinjtë me elementët bazë të muzikës korale, si një nga përbërësit kryesorë të gjinisë operistike.

"Si tingulli i pare muzikor zëri mbetet edhe sot i pakonkurueshëm.Ky tingull i magjishëm merr një fuqi të jashtëzakonshme kur bashkohet me zëra të tjerë dhe këndojnë në kor

.Nëse asnjëherë nuk ke patur guximin të shprehesh lirshëm me zërin tënd, të mposhtësh ndrojtjen e të zësh miq të rinj, eja këndo me ne, që të kuptosh se kori është magji."

Kjo do të jetë motoja e këtij projekti të rëndësishëm, i cili organizohet nga Bashkia Berat Qendra Kulturore "M.Tutulani" për herë të parë, me publikun e vogël beratas.

Për realizmin e këtij projekti nevojitet ndihma e instruktorëve të Q.K të.fëmijëve
Mesues Kanto
Mesues Piano
Dirigjenti Renuard Mimani specialist i artit prane Q.K.M.T.

Preventivi:

Tabela nr.105

Nr	**Emërtimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Shuma** *në 000/lekë*
1	Ftesa	50		2

2	Certifikata	50		5
3	Instrumentiste pianist	2	10	20
4	Instruktoret	2	10	20
5	Skenografi&Dekori			23
6	Orkestrime			30
	Totali			**100**

Projekti 3 : *Ëorld Rock-n-roll Day*, 13 prill *Dita botërore e rokenrollit*

Përshkrim dhe Histori

Është festë e të gjithë atyre, për të cilët rokenrolli (rock-n-roll) nuk është vetëm muzikë, por edhe stil e mënyrë jetese.Kjo ditë ndërkombëtare festohet çdo vit më 13 prill, edhe pse ngjarja historike, e cila shërbeu si bazë për festimin, ndodhi një ditë më parë: më 12 prill 1954 kur Bill Hejlli (Haley) regjistroi këngën singëll "Rock Around The Clock", që u bë pikë referimi për një rrymë të re muzikore, e cila shumë shpejt kaloi kufijtë e Amerikës dhe u përhap nëpër vende dhe kontinente, duke sfiduar shoqërinë dhe traditat.Ndër themeluesit e rrymës ishte dhe legjendari Elvis Presli (Presley), i cili u bë idhull i adoleshentëve dhe të rinjve.Stili i veshjes, manierat dhe lëvizjet e tij u bënë model imitimi.

Qëllimi:

Me rastin e shtimit te fluksit te turistave ne qytetin e Beratit, te cilet gjate mbremjes shfaqin deshiren per te mbushur mbremjen me nje aktivitet artistik Qëndra Kulturore "Margarita Tutulani" mendon të organizojë nje aktivitet te tille për të krijuar atmosferë sa më festive.

Realizimi i projektit:

Aktiviteti do të zhvillohet në bulevardin "Republika" ne nje nga ambientet ku ne sfond mund te prezantohen edhe pjese te lagjeve muzeale te qytetit.

Rezultatet e pritshme:

1. Rritje e optimizmit të komuniteti për të ardhmen.
2. Rritjen e cilësisë dhe jetës artistike në qytet.
3. Perfshirjen ne listen e qyteteve qe kultivojne muzike te rrymave nderkombetare
4. Rritje e besimit të qytetarëve në politikat vendore.

Programi :

Qendra Kulturore "M.Tutulani" vjen tek publiku artdashës i Beratit me nje program "Live" mjaft interesante ku në të do të ketë kenge te artisteve me te shquar te rrymes se *rokenrollit si* Elvis Presli ,grupi "Beatles", "Nirvana"etj.

Per zhvillimin e aktivitetit ne nivel te larte artistik mendohet te kontraktohet nje grupe rokenrolli i cili do beje nje performance per rreth 2 ore.

Rokenrolli eshte edhe menyre jetes dhe si i tille mendohet te jete edhe kendi i fotografive. Tek kendi i fotografive do vendosen banera te disa Artisteve me te famshem te kesaj rryme dhe do sherbejë qe qytetarët te bejne foto.

Preventivi:

Tabela nr.106

Nr	**Emërtimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Shuma** *në 000/lekë*
1	*Udhëheqës Artistik*	1		0
2	*Regjisor*	1		0
3	*Band muzikore (rokenrolli Urban Band)*	1		70
4	*Prezantues*	1		0

5	*Baner per kendin e fotove*			40
6	*Balerinë*	10		0
-	***Totali***	**-**		**110**

Projekti 4 : "Festivali i Estradës"
Festivali humorit
Realizimi i Projektit
Projekti mendohet te organizohet ne muajt Prill Maj 2022 në skenën e Qëndrs Kulturore M.Tutulani"
Pershkrim i Projektit
Në këtë projekt synohet të realizohet nje festival humori ku per disa dite trupa estrade nga gjithe trevat shqip folese do shfaqin programin e tyre artistik ne forëm konkurrimi. Aktiviteti do zhvillohet në skenën e Qëndrës të Kulturës dhe vlerësimin do e bej një jurie profesionistesh.
Rezultat i pritshëm është rrikthimi i traditës së estradës Beratase zhaneri me i pelyer nga publiku dhe gjallerimi i jetës artistike.
Tabela nr.107

Buxheti				
Nr.	**Artikulli**	**Çmimi**	**Sasia**	**Total Shuma** *në 000/lekë*
	ftesa	-	-	4
	Postera	-	-	1
	Printimi i Certifikatave	-	-	5
	Juria			200
	Dekor	-	-	140
	Pagesë për Artistët vlerësime	-	-	200
	Skeograf			50
	Totali			**600**

Projekti 5 : *"Luaj dhe Vallëzo"*

1-Qershor " Dita e Femijeve "
Përshkrimi dhe realizimi i projektit:
Aktiviteti do realizohet me rastin e dites femijeve daten 1-Qershor. Ky aktivitete realizohet per here te pare ne qytetin tone dhe është menduar të kete ne programin e tij :

1. Përfshirjen e zhanerave të ndryshëm koreografik ku te rinj te talentuar te qytetit do performojne dhe demostrojne nga stile te zgjedhura muzikore per publikun. Ne kete Dite do ju kushtohet të gjitha llojeve e stileve të vallëzimit (dancit), që nga ai klasik, modern, popullor etj. dhe synon argëtimin nëpërmjet universalitetit të kësaj forme arti, për të kapërcyer të gjitha pengesat politike, kulturore dhe etnike dhe për të bashkuar të gjithë njerëzimin me një gjuhë -vallëzimin.
2. Lojrat popullore do ti prezantojne animator kërcimtar për fëmijë.E gjithë kjo atmosferë festive do ti serviret publikut në nje mbazditen argetuese "Diten e femijeve". Do te risillen ne menyre sa me autentike disa nga lojrat popullore te cilat sherbejne dhe argetojne te gjithe grup moshat. Realizimi në shetitoren e qytetit i jep rëndësi zhvillimit urban dhe turistik. Njëkohësisht aktiviteti shërben përgjallërimin e jetës kulturore të qytetit.

Situata aktuale:
Vallet popullore shqiptare janë tejet të larmishme dhe kanë fituar gjithashtu vlerësim ndërkombëtar. Në Shqipëri ka një Ansambël të Këngëve dhe Valleve Popullore, trupë baleti në Tetarin e Operës dhe Baletit, shkollë koreografike, trupa amatore etj.Prane Qendres Kulturore "Margarita Tutulani" eshte nje trupe amatoresh kercimtare e cila rifreskohet me te rinje te apasionuar dhe vazhdon te ndiqet kjo tradite prej shume vjetesh

Objektivat:
1.Organizimi i nje aktiviteti me cilesi te larte artistike
2. Angazhimi i shume te rinjve ne zhanerin e baletit
3. Rritjen e audiences ne aktivitetet që zhvillon Bashkia Berat
4.Kthimi ne tradite per qytetitn tone realizimi i ketij aktiviteti

Rezultatet e pritshme:
1. Argëtimin e publikut dhe afrimin me atmosferat festive.
2. Rritje e optimizmit të komunitetit për të ardhmen.
3. Rritjen e cilësisë dhe jetës artistike në qytet.
4. Promovimin e punes te te rinjeve te talentuar ne zhanerin e baletit ne nje ambient shume publik
5. Edukimin e auditorit me këtë zhanër artistik

Preventivi financiar
Tabela nr.108

Nr	Emërtimi	Njësia	Çmimi	Shuma *në 000/lekë*
1.	Udhëheqës Artistik	1		
2.	Regjisor	1		
3.	Koreografe	1		
4.	Balerin Solist	1		20
	Balerin te "Q.K.M.T"			
6.	Prezantues dhe animator	2		20
7.	Kostumografia			60
8.	Pergjegjes Muzikor	1		
-	**Totali**	**-**		**100**

Projekti 6 : Kampi Veror
Pershkrimi i projektit
Kampi Veror është një projekt dedikuar fëmijëve.Me mbarimin e shkollës lind nevoja në komunitet për aktivizimin e argëtimin e fëmijëve, pasi përballë teknologjisë dhe aparateve android, kompjutra etj. është një betejë që prindërit bëjnë cdo ditë.Një mënyrë për ti mbajtur fëmijët larg aparateve që sjellin probleme shëndetësore është realizimi i një kampi veror i konceptuar me lojra popullore i cili do realizohet gjatë disa ditëve në muajt Korrik dhe Gusht në parkun pranë shëtitores "Republika" .Kampi do të përfshijë gjithë fëmijët nga mosha 4-12 vjec që duan të bëhen pjesë e shumë prej lojra të cilat do organizohet nëpërmjet zbatimit të projektit
Synimi:
1.Rrikthimin e shume prej lojrave popullore pjesë e trashegimisë sonë burimore
2.Argetimin e femijeve
3.Edukimin e të jetuari në mënyrë të shëndetshme

Tabela nr.109

Buxheti				
Nr.	**Artikulli**	**Çmimi**	**Sasia**	**Shuma** *në 000/lekë*
1	Printim i Ftesave		200	2
2	Postera		10	2
3	Printimi i Certifikatave		200	20
4	Pagesë për Artistë Animator	-	4	76
5	Instruktore	50	2	100
6	Materiale Dekori	-	-	100
	Totali			**300**

Projekti 7 : Koncert "Vokal-Instrumental"
21- Qershori Dita Ndërkombëtare e Muzikes
Përshkrim i Projektit
Organizimi i këtij koncerti në këtë ditë të shënuar do të promovojë disa nga vlerat më të mira të trashgimisë botërore në muzikën klasike.Koncerti do të perfshijë në programin e tij vepra nga autorë Shqipëtar dhe të huaj me një premierë të mirfilltë simfonike, gjini e muzikes klasike. Koncerti mendohet të organizohet në sallën e madhe te Qëndrën Kulturore M.Tutulani.
Qellimi kryesor i ketij aktiviteti artistik premiere eshte:

1. Realizimi me suksese i një koncerti me nivel të lartë artistik,
2. Pasurimi i fondit me pjesë të reja nga muzika klasike botërore
3. Rujatja e vlerave më të mira të trashëgimisë botërore në muzikën klasike
4. Aktivizimi i talenteve të reja, interpretues të muzikës klasike
5. Gjallërimi i jetës artistike të qytetit tonë

Tabela nr.110

Buxheti				
Nr.	**Lloji i shpenzimit**	**Çmimi**	**Sasia**	**Shuma** *në 000/lekë*
1	*Udhëheqës Artistik*	-	1	
2	*Regjisor*		1	
3	*Banda muzikore*	-	26	
4	*Kengetar i ftuar Armando Lika (Solist i Operas dhe Baletit)*	-	1	**50**
5	*Prezantues*		1	
6	*Baner per kendin e fotove*	-		**20**
7	*Ftesa& Postera*			**2**
	Totali			**72**

Projekti 8 : *"Hapat Festivë*
Fundjavat ne Berat Qershor-Gusht 2022
Pershkrim i projektit
Me ardhjen e sezonit të verës ,numri i turistave rritet por rritet edhe nevoja për aktivitete artistike dhe kulturore në qytetin e Beratit dhe kryesisht ne zonen e pedonales aty ku zhvillohet shetitja tradicionale por dhe bizneset jane ne sherbim te fluksit te larte te popullimt . Aktivitete janë të rëndësishme për jetën sociale dhe kulturore por e bejne zonen BID dhe me atraktive për banorët për të kaluar kohën e lirë si dhe për pushuesit dhe vizitorët vendas dhe të huaj.

Në këtë kontekst, është studiuar paraprakisht aktiviteti "Fundjavat në Berat" i cili mendohet të shtrihet për një periudhë 10-javore ditet e premte dhe te shtuna. Përveç qëllimit artistik dhe kulturor, aktivitetet do të synojnë t'u japin mundësi bizneseve të vogla krijuese mundësi për të tregtuar produkte artizanale dhe suvenire si dhe produkte argëtuese verore, si lule, xhelateri, lodra për fëmijë etj. Kjo mundësi do të krijohet përmes krijimit të infrastrukturës së një panairi portativ, kryesisht me karrige dhe tavolina palosëse. Karriget dhe tavolinat do të lihen në menaxhimin e koordinatorit të artizanatit dhe bizneseve. Tavolinat dhe karriget palosëse do të huazohen nga Shoqata BID Berati e cila i ka këto pajisje në dispozicion. Koha e parashikuar e këtij aktiviteti është Qershor-Gusht 2022.

Në këtë kuadër Aktiviteti Fundjavat në Berat do të përbëhet nga këto aktivitete:

1. Aktivitete Artistike në Fundjava – dhjetë fundjava;
2. Përfshirja e artistëve të rinj dhe grupeve komunitare në aktivitete
3. Shfaqie teatrale për fëmijë – 4 fundjava
4. Animacion lojra argëtuese për fëmijë – 6 fundjava
5. Panairi i Artizanatit dhe Bizneseve krijuese – Dhjetë fundjava
6. Performanca Live të grupeve muzikore-Dhjetë fundjava

Tabela nr.111

Buxheti				
Nr.	**Artikulli**	**Numri i diteve**	**Çmimi**	**Çmimi Total Lekë /000**
1.	Ndricim	20	-	-
2.	Materiale per skenografi	20	-	60
3.	Fonia	20	-	-
4.	Teater ne natyre	4	15	60
5.	Animacione	6		180
6.	Grupet Artistike	10	-	700
7.	Koordinimi aktiviteteve, përfshirjen e Artizanëve dhe Biznese te tjera kreative	20	-	-
Totali				**1.000**

Projekti 9 : Festivali "Folk Art" Berat 2022

Përshkrim i Përmbledhur i Projektit

Me organizimin e Festivalit Folk-Art Berat për një periudhë prej tre ditësh në Datat 27, 28, 29 Shtator, synojmë të arrijmë të konsolidojmë një aktivitet identifikues për qytetin e Beratit në fushën e trashëgimisë shpirtërore. Në datën 27 Shtator është Dita Ndërkombëtare e Turizmit ndërsa në datën 29 Shtator është Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore. Dita Kombëtare e Trashëgimisë Kulturore është festuar vazhdimisht nga Bashkia Berat dhe partnerët me festivale të këngës dhe valles popullore, si dhe seminare dhe tryeza të rrumbullakëta në lidhje me trashëgiminë kulturore. Në fokus të kësaj dite është ndërgjegjësimi për mbrojtjen si dhe promovimi i trashëgimisë tonë të prekshme dhe të paprekshme (Shpirtërore). Me anë të këtij aktiviteti ne synojmë të konsolidojmë një festival karakteristik tradicional për qytetin e Beratit i cili të promovojë në mënyrë të përvitshme vlerat e folklorit muzikor dhe koreografik të Qytetit të Beratit dhe trevave të tij. Për realizimin e festivalit do të ftohen të marrin pjesë afërisht 5-6 grupe të këngëve dhe valleve popullore të cilët janë pjesë e Bashkive të Qarkut, përkatësisht Bashkisë Urë Vajgurore, Bashkisë Kuçove, Bashkisë Poliçan, Bashkisë Skrapar dhe Bashkisë Berat. Do të ftohen si grupe të ftuara Shoqata kulturore artistike Qyprilinjte e Roshnikut e

treves se Beratit edhe artistë të rinj nga Shkolla Artistike Ajet Xhindole si dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve.Një Komision i posaçëm i ngritur pranë Bashkisë Berat me specialistë te fushes dhe nga Qendra Kulturore Margarita Tutulani do të ndihmojë grupet para zhvillimit të festivalit për përzgjedhjen e repertorit. Në fund të festivalit, grupet do të vlerësohen me certifikata përkatëse nga komisioni artistik i cili do të vlerësojë festivalin. Gjatë organizimit dhe zbatimit të projektit do të synohet të identifikohen dhe dokumentohen vlerat e trashëgimisë shpirtërore në trevën e Beratit. Vallet, këngët, grupet si dhe veshjet popullore do të fotografohen si dhe regjistrohen me video për efekt dokumentimi.

Qëllimi

Qëllimi është krijimi i Festivalit Folklorik të Këngës dhe Valleve Popullore i cili do të identifikojë dhe promovojë te publiku i gjerë rajonal dhe kombëtar vlerat e spikatura të traditës së Qarkut Berat në tërësi në fushën e valleve, këngëve, kostumeve popullore, veglave muzikore dhe artizanatit. Një tjetër qëllim i rëndësishëm festivalit është të motivojë artistët e folklorit beratas që të rrokin më shumë këtë art si dhe ta përpunojmë në forma të ndryshme artistike për të pasur sa më shumë ndikim në audienca të gjera kombëtare dhe ndërkombëtare.

Tabela nr.112

Buxheti				
Nr.	**Artikulli**	**Çmimi**	**Sasia**	**Shuma** *në 000/lekë*
	Printim i Ftesave	-	60	**3**
	Postera	-	10	**2**
	Printimi i Certifikatave	-	20	**20**
	Pagesë për Artistët	40	6 grupe	**240**
	Ekran led	-	m^2	**20**
	Skenograf		1	**15**
	Totali			**300**

Projekti 10 : *"TRIPTIK KULTUROR"*

Përmbledhje e projektit:

Me Rastin e 28 Nentorit Festes së Pavarsisë dhe 29 Nëntorit Clirimit te Atdheut , lind nevoja për aktivitete artistike dhe kulturore në qytetin e Beratit. Këto aktivitete janë të rëndësishme për jetën sociale dhe kulturore në qytet duke e bërë Beratin një qytet atraktiv për banorët dhe për pushuesit e vizitorët në keto ditë të rëndësishme. Realizimi përgjatë shëtitores i jep rëndësi zhvillimit urban dhe turistik të qytetit. Njëkohësisht aktiviteti shërben për gjallërimin e jetës kulturore të qytetit, stimulimin e talenteve të reja dhe shtimi i qytetarëve beratas në jetën sociale.

Rezultatet e pritshme:

1. Ndikim në ecurinë e bizneseve në zonën BID.
2. Rritje e optimizmit të komunitetit për të ardhmen.
3. Rritje e cilësisë dhe jetës artistike në qytet.
4. Rritje e besimit të qytetarëve në politikat vendore.

Përmbajtja e aktivitete kulturore:

Aktivitetet do të zhvillohen përgjatë shëtitores përkatësisht në datat 27,28,29 Nëntor

Aktiviteti është menduar të jetë me përfshirje multikulturore ku do të zhvillohen ekspozita në natyrë, ekzekutim nga banda frymore, Dee Jay, performancë muzikore nga talentet e reja të qytetit, numra koreografike , teatër për fëmijë, të ftuar specialë etj…

Preventivi:
Tabela nr.113

Nr	**Emërtimi**	**Njësia**	**Çmimi**	**Ditë**	**Shuma** *në 000/lekë*
1	Regjisor	1	0	4	0
2	Të ftuar	2	0	2	80
3	Drejtues Muzike	2	0	4	0
4	Koreograf & balerine	10	2.000	3	20
5	Talentet e reja (këngetarë)	6	3.000	3	18
6	Dj	1	0	3	0
7	Band Frymore	27	0	1	0
8	Skenograf	1	0	4	12
9	Grupi i teatrit të kukullave			1	20
	TOTAL				**150**

Projekti 11 : Java Artistike e Ditëve Festive 2022
Qëllimi:
Me rastin e festave të fundvitit Bashkia Berat, Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" parashikon të organizojë një program të ngjeshur aktivitetesh për të krijuar një atmosferë sa më festive. Aktivitetet do të zhvillohen në sheshin "Teodor Muzaka", përkatesisht në datat 06,24, 25,26,27 28, 29, 30,31 dhjetor 2022.
Rezultatet e pritshme:

1. Rritje e optimizmit të komuniteti për të ardhmen.
2. Rritje e cilësisë dhe jetës artistike në qytet.
3. Rritje e besimit të qytetarëve në politikat vendore.

Programi :
Qëndra Kulturore "Margarita Tutulani" vjen tek publiku artdashës i Beratit me një program mjaft interesant ku në të do të ketë : Këngë, balet, humor, lojëra me fëmijët që do të jenë prezent, numra kërcimi Hip Pop personazhet e kukullave për fëmijë, do të jenë pjesë e shfaqjes fëmijët e vegjël të veshur si babagjyshë dhe do të kërcejnë së bashku, performanca live në instrumente muzikore, shfaqje e teatrit të kukullave etj.

Kalendari i aktiviteteve:

1. Data 06.12.2022 Ceremonia e ndezjes së dritave .Ora 17.00
2. Data 24. 12. 2022 Koncert popullor. Grupi i Këngës Qytetare. Ora 17:00.
3. Data 25. 12. 2022 Koncert festiv. Orkestra Frymore. Ora 11:00.
4. Data 25.12. 2022 Koncert live. Grup rock-u. Ora 19: 00
5. Data 26.12. 2022 Koncert live. Bandë Muzikore. Ora 19:00
6. Data 27. 12. 2022 Festa e Fëmijëve. Ora 17:30
7. Data 28. 12. 2022 Koncert festiv me fëmijë *(Këngë, balet etj).* Ora 17:00.
8. Data 29. 12. 2022 Teatri i Kukullave *(Shfaqe për fëmijë).* Ora 17:00.
9. Data 29. 12. 2022 Koncert live. Bandë Muzikore. Ora 19:00
10. Data 30. 12. 2022 Koncerti i fundvitit *(Gëzuar 2022).* Ora 18:00

11. Data 31. 12.2022 Marshe festive *(Banda frymore).* Ora 11:00
12. Data 31. 12. 2022 Performancë muzikore D.J. në sheshin "Teodor Muzaka". Ora 23:00

Tabela nr.114

Pozicioni	**Sasia**	**Shuma *në 000/lekë***
Udhëheqës Artistik	1	0
Regjisor	1	0
Koreografe	1	0
Bandë muzikore	3	150
Aktor humori	3	130
Prezantues	2	20
Kengetarë të ftuar	3	100
Këngëtarë të rinj	6	30
Këngëtarë popullor	20	70
Teatri i kukullave	3	20
Balerinë	10	30
Totali	**-**	**550**

Për konkurrimet priten ftesat nga organizatorët bashkangjitur dhe kriteret

Objektiv 2. Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit , çka do ta bënte jo vetëm qytetarin e Beratit , por edhe turistin dhe vizituesin e tij më aktraktiv.
Produkti 1.2A Sigurimi i Kontratave për formimn e formacioneve muzikore për vitin 2022 kosto financiare 3,918,000 lekë
TREGUESI: Marrëdhënia e punës së artistëve me Qendrën Kulturore "Margarita Tutulani" realizohet nëpërmjet një kotratë-marrvëeshje midis dy palëve.
Numri i artistëve total për Bandën është 27 artistë , për Orkestrën sinfonike 25 artistë, për Grupin e këngës 20 artistë, për Ansamblin e valles 12 artistë.
Grupi i këngës popullore 20 pjesëmarrës me kontratë.
Nr i shfaqeve të planifikuara: 10. Për vitin 2022 kosto financiare e planifikuar 1,001,000 lekë.
Orketra Simfonike 25 pjesëmarrës me kontratë.
Nr i shfaqeve të planifikuara për vitin 2022 me kosto financiare e planifikuar 952, 000 lekë.
Banda Frymore 27 pjesëmarrës me kontratë.
Nr i shfaqeve të planifikuara për vitin 2022 me kosto financiare e planifikuar 1,669,000 lekë.
Ansambli i Valles 12 pjesëmarrës me kontratë.
Nr i shfaqeve të planifikuara për vitin 2022 me kosto financiare 297,000 lekë.

Objektiv 3. Prezenca dinjitoze e formacioneve muzikore në çdo festë, event dhe ngjarje të rëndësishme të qytetit.
Produkti 1.3.A Sigurimi i një mjeti për të siguruar lëvizshmërinë e formacioneve për Aktivitete. Për vitin 2022 kosto financiare e planifikuar 103,000 lekë
TREGUESI: Sigurimi i një mjeti për të siguruar lëvizshmërinë e formacioneve

Objektiv 4 Prezenca dinjitoze e ansamblit të valles në çdo festë, event dhe ngjarje të rëndësishme të qytetit

Produkti 1.4.A Uniforma dhe veshje speciale (Popullore). Për vitin 2022 kosto financiare e planifikuar 412,000 lekë
TREGUESI.Realizimi i procedurave të prokurimit për uniforma veshje special (Popullore).
Prezenca dinjitoze e ansamblit të valles në çdo festë .
Ruajtja dhe promovimi I vlerave të trashëgimisë kulturore të qytetit.

Objektiv 5. Prezenca dinjitoze e formacioneve në çdo festë, event dhe ngjarje të rëndësishme të qytetit
Produkti 1.5.A Pjesëmarrja në aktivitete kulturore. Për vitin 2022 kosto financiare për dieta parashikohet 206,000 lekë
TREGUESI. Realizimi i procedurave. Ftesa në festivale konkurime evente .Prezenca dinjitoze e formacioneve në çdo festë .
Ruajtja dhe promovimi i vlerave të trashegimise kulturore të qytetit.

Objektiv 6 Sigurimi i kushteve të nevojshme të punës për punonjësit e Qëndrës Kulturore "Margarita Tutulani" si edhe të institucioneve në varësinë e saj : Biblioteka "Vexhi Buharaja", Galeria"Edëard Lear", Sporti-Argëtimi", "Muzeu Sinjë".
Produkti 1.1.B
Sigurim për Materiale zyre dhe të përgjithshme
TREGUESI: Përmirësimi i mëtejshëm i Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani"
Realizimi i procedurave të prokurimit për Materiale zyre dhe të përgjithshme. Për vitin 2022 kosto financiare 453,000 lekë.

Objektiv 7 Mirëmbajtja e Qendrës Kulturore "Margarita Tutulani" dhe në varësinë e saj janë Bbiblioteka "Vexhi-Buharaja", Galeria"E.Lear", Sporti-Argëtimi", "Muzeu Sinjë".
Produkti 1.2.B Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme. Për vitin 2022 kosto financiare 342,000 lekë.
TREGUESI: Krijimi i hapësirave të nevojshme dhe të mjaftueshme për ruajtjen , mirëmbajtjen dhe ekspozimin e fondit Galeria "E.Lear".
Mirëmbajtja e fondit të bibliotekës "Vexhi Buharaja".
Zgjerimi dhe kompletimi i ambienteve në funksion të krijimit të kushteve bashkëkohore.
Mirëmbajtja e veshjeve popullore.

Objektiv 8 Shërbime nga të tretë për Qëndrën Kulturore "Margarita Tutulani" dhe në varësinë e saj : Biblioteka "Vexhi Buharaja",Galeria "Edëard Lear", Sporti-Argëtimi", "Muzeu Sinjë".
Produkti 1.3.B Shërbime nga të tretë. Për vitin 2022 kosto financiare 922,000 lekë.
TREGUESI:. Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" organizon të gjithë eventet kulturore-artistike apo bashkëpunimet e ndryshme , me një numër personeli prej 29 punonjësish. Elektricitet Ujë Shërbime telefonike.
Posta dhe shërbimi korrier(abonim gazeta për lidhjen e periodikut) Pasurimi i fondeve të bibliotekës me libra dhe periodikë.

Objektiv 9 Nr i punonjësve të punonjës Qëndrës Kulturore "Margarita Tutulani" dhe në varësinë e saj janë Biblioteka "Vexhi Buharja", Galeria"E. Lear", Sporti-Argëtimi", "Muzeu-Sinjë".
Produkti 1.2.A Paga sigurime. Për vitin 2022 kosto financiare 20,798,000 lekë
TREGUESI:. Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" organizon të gjithë eventet kulturore-artistike apo bashkëpunimet e ndryshme, me një personel prej 29 punonjësish.

Objektiv10 Tërheqja e sa më shumë lexuesve, afrimi me librin e të gjithave moshave, zhvillimin e aktivitetve promovuese e nxitëse në funksion të shtimit të lexuesve e kryesisht atyre të rinj, në funksion të promovimit të kulturës dhe edukimit.

Produkti 1.3.A Pasurimi i fondeve të bibliotekës me libra dhe botime periodike. Për vitin 2022 kosto financiare 500,000 lekë.
TREGUESI**:**. Realizimi i procedurave të prokurimit për blerjen e librave me qëllim pasurimin e bibliotekës. Promovimi i krijimtarisë dhe produktit letrar lokal dhe kombëtar

Biblioteka Publike ka në fondin e saj aktualisht :
Tabela nr.115

Nr.	**Sektorët**	**Tituj**	**Ekzemplarë**
1	Libri shqip	16.673	33.730
2	Libri për fëmijë	2.666	6.636
3	Periodiku shqip	200	5.126
-	Periodiku i huaj	120	3.153
-	Libri i huaj	9.200	13.270
Gjithsej		**28.859**	**61.915**

Ofrimi i mundësisë, që lexuesit e rinj në mënyrë online të lexojnë koleksionin e veprave të bibliotekës.
Anëtarësia :
Tabela nr.116

Nr.	**Sektorët**	**Nr. Lexuesve të kartelizuar**
1	Libri shqip	510
2	Libri për fëmijë	450
3	Periodiku dhe libri i huaj	150
Gjithsej : 1.110		

Organizimi i aktiviteteve rinore që nxisin kulturën e të lexuarit.
Frekuentimi :
Tabela nr.117

Nr.	**Sektorët**	**Frekuentues ditorë**	**Lexues në sallë**
1	Libri shqip	50	12
2	Libri per femije	30	20
3	Periodiku dhe libri i huaj	25	25
Gjithsej		**105**	**57**

3.13.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 08220 Trashëgimia kulturore, evente artistike dhe kulturore është planifikuar në shumën 49,820 mijë Lekë, dhe zë 4.1% të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 16,075 mijë Lekë ose në masën 48 %. Rritja është programuar në shpenzimet kapitale.

Ky program menaxhohet nga njësitë shpenzuese :
- Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” , shuma 20,610 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 29,210 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 20,798 mijë lekë, për 27 punonjës. Numri i punonjësve nuk ka ndryshuar nga viti 2021. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me ritje në shumën 606 mijë lekë ose në masën 3 %.

Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 7,912 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 231 mijë lekë ose në masën 3%.

Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 21,110 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 15,238 mijë lekë ose në masën 260%.

Në këtë program përfshihen 5 projekte investimi:
1.Blerje libra për shtimin e fondit të bibliotekës së qytetit në shumën 500 mijë lekë.
2.Projekti "Për rivitalizimin e 100 fshtatrave – nderhyrjet në fshatin Roshnik" , bashkëfinancim në shumën 3,000 mijë lekë.
Projekti financohet nga Skema e Granteve të Agjensisë Austriake dhe Zviceriane dhe zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit në bashkëpunim me disa Bashki në Shqipëri.
Në Projekt janë parashikuar ndërhyrjet më poshtë :
-Rivitalizimi i''Sheshit Roshniku'' për organizim eventesh agrobizesi dhe eventesh me fokus ekoturizmin dhe panaire.
Sheshi ''Roshnik'' do të shërbeje për organizimin e panaireve, koncerteve, festivaleve, festave lokale.
-Krijimin e 3 shtigjeve turistike, vendosje sinjalistike orientuese, vendosje stolash përgjatë shtigjeve, pastrim dhe sheshim të shtigjeve.
-Pastrim , rregullim dhe ambiente shlodhese i shtegut të rezervuarit të Bovës, ku mund të zhvillohen aktivitete rekreative. Në Liqenin e Bovës do të ndërtohet një shesh panoramik, vendqëndrim ku banorët vendas dhe vizitorët të kenë mundësi të qetësohen dhe të shijojnë bukuritë e natyrës përreth dhe liqenit. Liqeni i Bovës ofron mundësinë për të kryer sporte të ndryshme ujore si zhytje, xhiro me kanoe, xhiro me varkë. Mund të ushtrosh aktivititetin e të peshkuarit.
-Përgatitjen e një pakete promocionale të Roshnikut me informacion mbi zonë përreth, e cila përfshin, harta, fletëpalosje.
-Blerjen e një ekrani ledëall (përmasat 4x3 metër) për eventet dhe aktivitetet në Roshnik.
Shuma totale e Projektit është 15,000,000 lekë , ku Bashkië Berat duhet të mbulojë TVSH e Projektit në shumën 3,000,000 lekë.

3. Projekti " ACCESSIBLE TOURISM 4ALL", në shumën 9,502 mijë lekë
Projekti ACCESSIBLE TOURISM 4ALL financohet plotësisht nga fondet e BE-së, përveç vlerës së TVSH-së, e cila përballohet nga buxheti i bashkisë. Vlera e plotë e projektit është 16,036 mijë lekë dhe shuma e programuar për bashkëfinancim në vitin 2022 (kosto lokale TVSH) është 2,118 mijë lekë.
Përveç pagesës së TVSH-së së aktiviteteve të këtij projekti, Bashkia Berat angazhohet të kryejë edhe financim të përkohshmën të projektit në shumën 7,384 mijë lekë. Ky fond është i rimbursueshëm nga donatori.
Projekti ka nisur të zbatohet në vitin 2020 dhe parashikohet të përfundojë në 3-mujorin e parë 2022.

4.Projekti "CULTURE LANDS", në shumën 959 mijë lekë
Projekti CULTURE LANDS financohet plotësisht nga fondet e BE-së, përveç vlerës së TVSH-së, e cila përballohet nga buxheti i bashkisë. Vlera e plotë e projektit është 4,852 mijë dhe shuma e programuar për bashkëfinancim në vitin (kosto lokale TVSH) është 234 mijë lekë.

Përveç pagesës së TVSH-së së aktiviteteve të këtij projekti, Bashkia Berat është angazhuar të kryejë edhe financim të përkohshmën të projektit në shumën 725 mijë lekë. Ky fond është i rimbursueshëm nga donatori.
Buxheti i projektit parashikohet të realizohet në 3-mujorin e fundit 2021.
Projekti ka nisur të zbatohet në vitin 2020 dhe parashikohet të përfundojë në 3-mujorin e parë 2022.

5. Projekti "E-NATURA", në shumën 7,149 mijë lekë

Projekti E-NATURA financohet plotësisht nga fondet e BE-së, përveç vlerës së TVSH-së, e cila përballohet nga buxheti i bashkisë. Vlera e plotë e projektit është 11,419 mijë lekë.

Bashkia Berat angazhohëet të kryejë financim të përkohshmën të projektit në shumën 7,149 mijë lekë. Ky fond është i rimbursueshëm nga donatori.

Projekti ka nisur të zbatohet në vitin 2020 dhe parashikohet të përfundojë në 3-mujorin e parë 2022.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, shpenzimet kapitale janë programuar në shumën 500 mijë për secilin vit.

Shpenzimet e programit 08220 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.118

		Projekt Viti 2022										
Titulli Progr.	**Emertimi Programit**	**Totali**	**Shp. Korrente**	**600**	**601**	**602**	**603**	**604**	**606**	**Shp. Kapitale**	**230**	**231**
8220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	**49,820**	28,710	17,847	2,951	7,912	-	-	-	21,110	-	21,110
8220	Bashkia Berat	**20,610**	0	0	0	0	0	0	0	20,610	0	20,610
8220	Qendra Kulturore "M. Tutulani"	**29,210**	28,710	17,847	2,951	7,912	0	0	0	500	0	500

Pasqyra e shpenzimeve operative analitike për vitin 2022 në programin 08220 : në 000 lekë
Tabela nr.119

Art.	Emertimi	Plan 2021	Plan 2022
6020	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**700**	**865**
6020	Kancelari	100	150
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim, ngrohje dhe ndriçim	100	200
6020	Materiale Te ndryshme	100	103
6021	Uniforma veshje speciale	400	412
6022	**Sherbime nga te trete**	**895**	**922**
6022	Elektricitet	600	618
6022	Uje	105	108
6022	Sherbime telefonike	100	103
6022	Posta dhe sherbimi korrier(abonim)	90	93
6024	**Shpenzime udhetimi**	**200**	**206**
6024	Udhetim i brendshem.	100	103
6024	Udhetim jashte shtetit.	100	103
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**332**	**342**
6025	Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	100	103
6025	Shpenzime per mirembajtjen e kornizave	32	33
6025	Shpenzime per mirembajtje te objekteve specifike	100	103
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	100	103
6026	**Shpenzime per qiramarrje**	**100**	**103**
6026	Shpenzime per qiramarrje mjetesh transporti	100	103

6029	Shpenzime te tjera operative	1,050	1,556
6029	Shpenzime per te tjera Aktivitete	1,000	1,056
6029	Shpenzime per te tjera pjesmarje ne ftesa aktivitetesh	50	500
	Shpenzime te tjera operative	3,804	3,918
6029	Shpenzime per te tjera Banda,	1,620	1,669
6029	Shpenzime per te tjera Orkestra Sinfonike	924	952
6029	Shpenzime per te tjera Grupi I kenges	972	1,001
6029	Shpenzime per te tjera Grupi i Valles	288	297
Totali		7,081	7,912

Shpenzimet e Programit 08220 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.120

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**	
Bashkia	**Berat**	
Programi	08220	**Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore**

		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Emri i Artikullit	**Kodi i Artikullit**	**2019**	**2020**	**2021**	**2021**	**2022**	**2023**	**2024**
		Fakt	**Fakt**	**Buxhet Fillestar**	**Buxhet i Pritshëm**	**Plani**	**Plani**	**Plani**
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	18,101	15,129	17,327	17,327	17,847	18,383	18,933
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	3,028	2,608	2,865	2,865	2,951	3,039	3,131
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	6,776	6,640	7,681	8,623	7,912	8,148	8,393
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**		164					
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**				1,113			
Aktive të Prekshme	**231**	13,737		5,872	15,718	500	500	500
TOTALI		**41,642**	**24,541**	**33,745**	**45,646**	**29,210**	**30,070**	**30,957**

Projektet e Investimeve të Programit

Tabela nr121 në 000 lekë

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
08220	Muri Kala	Fondet e veta	8,191	5,419					
08220	Ndertim i Muzeut Sinje+ mobilim	Fondet e veta	9,161	7,830		191			
08220	Projekti Accessible Tourism 4 all	Fondet e veta				10,213	9,502		
08220	Projektime e Studime Projekti Culture Lands	Fondet e veta				1,113	725		
08220	Projekti Culture Lands	Fondet e veta				234	234		

08220	Projekti per rivitalizimin e 100 fshatrave turistike (Roshnik)	Fondet e veta					3,000		
08220	Projekti E-Natura	Fondet e veta				3,380	7,149		
08220	Ndertimi I Qendres Rinore	Fondet e veta				1,200			
08220	Pajisje Qendra Kulturore	Fondet e veta	90	90					
08220	Blerje librash per Qendren Kulturore	Fondet e veta	398	398		500	500	500	500

13. PROGRAMI 08130 : SPORTI DHE ARGËTIMI

Vështrim i përgjithshëm i programit		
Programi mbulon operimin ose mbështetjen e strukturave për aktivitete çlodhëse dhe sportive dhe kontribut financiar për promovimin e sporteve.		
08130	Sport dhe argëtim	• Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturavepër veprimtari ose ngjarje sportive aktive; mbështetje për ekipet përfaqësuese vendore në veprimtaritë sportive. • Vënie në funksionim ose mbështetje e strukturave për veprimtari ose ngjarje sportive pasive (strukturapër qëndrimin e spektatorëve; sidomos vende të pajisura për lojëra me letra, lojëra me tabelë etj.) • Grante, hua ose financime për të mbështetur ekipeose konkurues apo lojtarë individualë
Njësia Shpenzuese që menaxhon programin		• Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” • Bashkia Berat (qendra)

Qëllimet dhe objektivat e politikës së programit

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja, në të gjithë veprimtarinë sportive kombëtare dhe ndërkombëtare me të gjitha disiplinat sportive të njohura nga Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) dhe të gjitha Federatat Shqiptare Sportive të njohura nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë sipas legjislacionit shqiptar në fuqi dhe me Ligjin Nr 79/2017, "Për Sportin". Vazhdimi i traditës sportive, zhvillimin dhe rritjen e cilësisë sportive në të gjitha sportet që ushtrohen dhe përfaqësojnë Bashkine Berat. Krijimin e ekipeve zinxhirë të grupmoshave të ndryshme në sportet e etj. Krijimin e lidhjeve miqësore, shkëmbimeve të eksperiencave me klubet sportive, shoqatat sportive dhe shoqëritë brenda dhe jashtë vendit. Manaxhimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e objekteve sportive që janë në pronësi të Klubit Shumësportesh “Tomori”.

Objektivat e programit

1. Të promovojmë dhe të nxisim pjesëmarrjen aktive te të rinjve në aktivitete sportive dhe sociale.
2. Garantimin e pjesëmarrjes së të gjithë ekipeve të Klubit Shumësportësh “Tomori” si në Kampionatet Kombëtare me synim arritjen e rezultateve cilësore

Sportistët dhe trajnerët që trajtohen me trajtim ushqimor janë të shpëndarë me numër sipas disiplinave në tabelën e më poshtme:

Tabela nr.122

Nr	Emërtimi	Nr. trajnerëve	Nr. Sportistëve
1	Pjateli	1	2
2	Mundja	2	5
3	Peshengritja	1	4
4	Boks	1	4
5	Basketbolli	1	0
6	Karateja	1	1
7	Pingpongu	2	8
8	Gjimnastika	2	9
9	Shahu	1	3
Total		**12**	**36**

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 08130 Sport dhe Argëtim është planifikuar në shumën 38,570 mijë Lekë, dhe zë 3.2 % të buxhetit total.

Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 6,498 mijë Lekë ose në masën 20 %. Rritja është programuar në shpenzimet operative.

Ky program menaxhohet nga njësitë shpenzuese :
- Qendra Kulturore "Margarita Tutulani" , shuma 5,570 mijë lekë
- Bashkia Berat (qendra) për shpenzimet kapitale, shuma 33,000 mijë lekë

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 1,490 mijë lekë, për 2 punonjës. Numri i punonjësve nuk ka ndryshuar nga viti 2021. Në krahasim më planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 43 mijë lekë ose në masën 3 %.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 4,080 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 455 mijë lekë ose në masën 13%.
Shpenzime për subvencione (art.603) janë planifikuar në shumën 33,000 mijë lekë. Kjo vlerë përfaqëson subvencionin për Futboll FK Tomori 1923. Në vitin 2022 është programuar e njëjta vlerë me vitin 2021 (plani fillestar ishte 27,000 mijë dhe me ndryshimet gjatë vitit u bë 33,000 mijë lekë).
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 0 lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, shpenzimet kapitale janë programuar në shumën 500 mijë për secilin vit.
Në shpenzimet kapitale, për vitin 2023 është planifikuar likujdimi i detyrimit të prapambetur për investimin Rikonstruksion i Palestrës së Gjimnastikës., me vlerë 2,164 mijë lekë.

Shpenzimet e programit 08130 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.123

		Projekt Viti 2022										
Titulli Progr.	Emertimi Programit	Totali	Shp. Korrente	600	601	602	603	604	606	Shp. Kapitale	230	231
8130	Sport dhe argëtim	**38,570**	38,570	1,278	212	4,080	33,000	-	-	-	-	-
8130	Bashkia Berat	**33,000**	33,000	0	0	0	33,000	-	-		-	-
8130	Qendra Kulturore "M. Tutulani"	**5,570**	5,570	1,278	212	4,080	0	-	-	-		-

Shpenzimet operative analitike të programit 08130 në 000 lekë
Tabela nr.124

Art.	Emertimi	Plan 2021	Plan 2022
6021	**Materiale dhe sherbime speciale**	**0**	**260**
6021	Uniforma dhe veshje te tjera speciale	0	110
6021	Shpenzime per objekte specifike speciale		100
6021	Materiale ndertimi, m. elektrike, m. hidraulike		50
6022	**Sherbime nga te trete**	**275**	**290**
6022	Elektricitet	50	80
6022	Uje	225	210
6023	**Shpenzime transporti**		
6024	**Shpenzime udhetimi**		**40**
6024	Udhetim i brendshem. (dietat e personelit)		40
6024	Udhetim jashte shtetit.		
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**100**	**0**
6026	**Shpenzime per qiramarrje**	**0**	**0**
6028	**Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua**	**0**	**0**
6029	**Shpenzime te tjera operative**	**3,250**	**3,490**
6029	Spenzime Licensime (federimet e ekipeve+trajnereve+sportisteve)		90
6029	Shpenzime per te tjera furnizim per menca (trajtim Ushqimor)	2,800	2,800
6029	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime operative (aktivitete)	450	600
	Totali	**3,625**	**4,080**

Shpenzimet e Programit 08130 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.125

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia	**Berat**
Programi	08130 **Sport dhe argëtim**

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	1,080	1,119	1,241	1,241	1,278	1,316	1,356
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	175	63	206	206	212	218	225
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	2,423	2,419	3,625	3,625	4,080	4,202	4,328
Subvencion	**603**	23,000	25,000	27,000	33,000	33,000	33,990	35,010
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							

Aktive të Prekshme	**231**	20,365					2,664	500
TOTALI		**47,043**	**28,601**	**32,072**	**38,072**	**38,570**	**42,391**	**41,419**

Projektet e Investimeve të Programit 08130

Tabela nr.126 në 000 lekë

Kod Programi	Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
08130	Rikonstruksion i stadiumit Tomori	Fondet e veta	49,458	19,185				2,164	
08130	Rionstruksion i palestres se gjimnastikes	Fondet e veta	5,898	1,180					
08130	Pajisje sportive	Fondet e veta						500	500

14. PROGRAMI 09120: ARSIMI BAZË PËRFSHIRË ARSIMIN PARASHKOLLOR

Përshkrimi i programit:

Ky program parashikon ndërhyrjet për ndërtimin e rikonstruksionin e objekteve shkollore të arsimit bazë dhe atë parashkollor, pajisjen dhe kompletimin e tyre me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme.
Garantimin e mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve në kopshte dhe arsimi bazë.
Shërbimin cilësor të ushqimit të fëmijëve.

Politika e programit:

Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore mësimore për fëmijët, si dhe përmirësimin e infrastrukturës për rritjen dhe edukimin e fëmijëve të shëndetshëm

Objektivat e programit, performanca, problematikat dhe produktet që kontribuojnë në arritjen e objektivave :

Objektivi 1. Vlerësimi i nevojave dhe studimi i prioriteteve afatmesme dhe afatgjata si dhe studimi i përmirësimit të infrastrukturës arsimore në Berat duke përfshirë investime dhe mirëmbajtje të IA.**Numri i godinave të IA që duhen mirëmbajtur janë 64 në total.** Arsimi bazë [**37 shkolla 9 vjecare dhe 40 kopshte (22 kopshte brenda shkollave dhe 18 kopshte në godina më vete)**]. U shërbehet **6486** nxënësve sipas statistikave qershor 2021 që frekuentojnë këto institucione (kopshte dhe shkolla 9 vjeçare).

Informacion mbi Institucionet Arsimore :

Tabela nr.127

Nr	Njësia	Nr. i shkollave	Nr i kopshteve	Nr fëmijësh total
1	Berat	7 shkolla 9- vjeçare 2 shkolla të mesme të bashkuara 2 gjimnaze të përgjithshëm 1 konvikt vajza - djem	9 kopshte 4 çerdhe	5819 fëmijë
2	Roshnik	5 shkolla 9- vjeçare 1 shkollë e mesme e bashkuar	5 kopshte	295 fëmijë
3	Sinjë	5 shkolla 9 -vjeçare 1 shkolle e mesme e bashkuar	5 kopshte	361 fëmijë
4	Velabisht	9 shkolla 9-vjecare 1 shkolle e mesme e bashkuar	11 kopshte	972 fëmijë
5	Otllak	5 shkolla 9 vjecare 1 shkolle e mesme e bashkuar	11 kopshte	779 femije

Tabelë përmbledhëse e listës së objekteve nën administrim të Drejtorisë së Arsimit		
1	Kopshte total	40
2	Çerdhe total	4
3	Shkolla 9 vjeçare total	37
4	Shkolla të mesme total	8
5	Konvikte	2
6	Magazina	1
7	QKF	1
	Total institucione	**93**
	Total godina	**64**
	Total sip/m2	**81000 m2**
	Total femijë / nxënës	**8226 nx**

Të dhënat për problematikat në Institucionet Arsimore :

Tabela nr.128

Problematikat e IA		
Nr	**Lagje/njësi administrative**	**Problematikat e institucioneve**
1	Shkolla Rroshnik/ Rroshnik	Ka nevojë për investime në : Hidroizolim solete, rehabilitim të rrjetit elektrik, Shtrim i oborrit me pllaka,
2	Shkolla Kostren / Rroshnik	Tualetet janë jashtë godinës së shkollës
3	Shkolla Bogdan/Rroshnik	Ka nevoje për investime në: Rikonstruksion i çatisë së shkollës, sistemim i rrethimit të shkollës.
4	Shkolla Qafe Dardhe/ Rroshnik	Ka nevojë për lyerje totale
5	Shkolla Vojnik / Rroshnik	Eshte ambient me qera.

6	Shkolla Karkanjoz/ Rroshnik	Tualetet janë jashtë godines së shkollës.
7	Cerdhja nr.1	Është në gjendje të mirë
8	Cerdhja nr.7	Është në gjendje të mirë
9	Kopshti Uznove +Cerdhe	investime në : Rrethim i ballkoneve me kangjella.
10	Kopshti D.Kastrioti	Rikonstruksion te pjesshëm, Lyerje të grupeve, F.V të dyerve dhe dritareve, Rehabilitim i rrjetit elektrik.
11	Kopshti 10 Korriku	**Godina është e mirëmbajtur sistematikisht**, por ka nevojë për një rikonstruksion total (riparime të shtresave të suvasë, shtrim dyshemeje me parket, rehabilitim të nyjeve sanitare , lyerje totale, sistemim territori)
12	Kopshti 1 Qershori	Godina është e mirëmbajtur sistematikisht, por ka problematika që konsistojnë në : Riparim i pjesshëm i çatisë , riparime të shtresave të suvasë, lyerje totale, punime hidraulike dhe elektrike. Ka nevojë për investim në mbylljen e ballkoneve me vetrata xhami.
13	Kopshti Clirim nr.1	Ka nevojë për hidroizolim të xokolit në pjesën perëndimore të objektit. Ka prezencë lagështie në dhomat e fjetjes dhe tualete. Duhet ndërhyrë në riparimin e rrjetit elektrik dhe hidraulik. Ka nevojë për një lyerje totale të objektit.
14	Kopshti Clirim nr.2	Lyerje totale e fasadës. Rehabilitim i rrjetit elektrik.
15	Kopshti Barikade 2+3 + CERDHE nr.5	Rikonstruksion i tualeteve dhe rrjetit hidraulik. Rehabilitim total i rrjetit elektrik.
16	Kopshti Barikade e Re.(Llambrini Puli)	Është në gjendje të mirë
17	Kopshti 28 Nëntori	Lyerje totale të godinës. Riparime në sistemin e ulluqeve. Riparim i shtresës së pllakave në ballkonet e katit të tretë. Prishja e depos ngjitur me godinën e kopshtit, menaxhimi i hapësirës së jashtme dhe evitimi i lagështise në katin e parë.
18	Shkolla Uznovë	Është nën afat garancie.
19	Shkolla Shyqeri Lakra	Lyerje totale te shkollës. Sistemim i këndit sportiv.
20	Shkolla Thimi Tani	Lyerje totale të godinës. (fasada dhe ambjente brenda)
21	Shkolla 22 Tetori	Rikonstruksion i tavaneve tip reskallam në Tavan të varur gipsi. Riparime në palestren e shkollës . Lyerje e të gjitha klasave dhe fasadës. Mobilim me banka dhe karrike të përshtatshme. Rehabilitim i nyjeve sanitare. Mungon sistemi i ngrohjes.
22	Shkolla 28 Nëntori	Riparime në kalçeton e shkollës. Lyerje të pjesshme në ambjentet e brendshme dhe pjesërisht fasadës. Hidroizolim i pjesshëm i strehës në hyrjen e shkollës.
23	Shkolla M.A.Vrioni	Lyerje totale, rehabilitim i rrjetit elektrik.
24	Shkolla Z.Toska	Shkolla është në gjendje të mirë
25	Shkolla. A.Xhindole	Punime hidroizolimi të soletës. Lyerje të klasave dhe pjesërisht fasades. Hidroizolim xokoli në anën perëndimore të objektit. Ka prezencë lageshtie në 4 klasa. Ka nevojë për investime në shtrimin e dyshemese me pllaka. Rehabilitim të nyjeve sanitare.

26	Shkolla 1 Maj	Rehabilitim i sistemit të kullimit në oborrin e shkollës. Është në garanci .
27	Gjimnasi B.D. Karbunara(pergj)	RINDËRTIM Ka prezencë të larte lageshtie, sistem kullimi te demtuar, ka nevoje per hidroizolim tarrace, rehabilitim te rrjetit hidraulik dhe elektrik, rikonstruksion te palestrave..) Mungon sistemi i ngrohjes.
28	Gjimnasi Kristaq Capo	Mungon sistemi i ngrohjes.
29	Shkolla Mbreshtan +kopësht	Ka plasaritje te godines nga termeti dhe duhen bere riparime te shtresave te suvase. Nga inspektimi teknik i grupit te inxhiniereve eshte hartuar projekti per te bere perforcim te godines me kolona antisizmike . Eshte e nevojshme te behet nje nderhyrje ne sistemimin e terrenit sportiv. KA NEVOJE PËR SISTEMIM TË OBORRIT.
30	Shkolla Paftal+ Kopësht	Për shkollën Paftal është e nevojshme rrethimi I shkolles . Rehabilitim te nyjeve sanitare. Lyerje te klasave, fasades . Sistemi i terrenit sportiv.
31	Shkolla Mbjeshove + kopësht	Ka nevojë per lyerje totale te godines.
32	Shkolla Levan	Shkolla eshte e amortizuar, perbehet vetem nga nje klase e bashkuar e cila mirembahet.
33	Shkolla Molisht + kopesht	Rikonstruksion i catise, mirembjatje te zakonshme dhe lyerje te pjesshme. Ndertim muri rrethues .
34	Shkolla e mesme e bashkuar Sinje + kopësht	F.V dyer të brendshme dhe e jashtme e blinduar. Lyerje totale të klasave dhe fasades. Sistemim territori, shtrim oborri me pllaka betoni. Hidroizolim i tarracës.
35	Kopshti Bilcë	Godina është në gjendje të mirë
36	Shkolla Velabisht + Kopësht	Shkolla ka munges ete furnizimit me uje te rrjedhshem. Nuk ka akses ujesjellesi dhe furnzimi behet pjeserisht me ane te pusit te xhamise. Godina eshte e mirembajtur. Ka nevoje per sistemim te territorit dhe ndertim kendi sportiv.
37	Shkolla Gjeroven + kopësht	Eshte emergjente shtrimi i oborrit me pllaka guri dhe rrethimi i shkolles. Ka mungese te terrreneve sportive. Duhet investuar ne F.V te dyerve dhe dritareve.
38	Shkolla Veleshnje + kopësht	Eshte emergjente rrethimi i shkolles dhe ndertimi i nje muri rrethues. Duhet krijuar terren sportiv. Duhen ber elyerje totale te klasave dhe pjeserisht fasades. Ka nevoje per riparim te catise.Duhet hapur nje pus uji per furnizim te panderprere.
39	Shkolla Drobonik+ kopësht	shkolla ka nevoje per vendosje te dyer dhe dritare te reja. Ambjenti i kopshtit eshte demtuar nga aktiviteti sizmik per te cilin eshte hartuar edhe projekt nga zyra e urbanistikes. Projekti duhet te vihet ne zbatim per qendrueshmerine dhe shmangien e cdo rrezikshmerie.

40	Shkolla Duhanas + Kopësht	1. Rikonstruksion i pjesshem (rifinitura dhe lyerje totale, shtrim i dyshemese me pllaka, FV dyer/dritare) 2. Shkalle emergjence. 3. Rehabilitim i nyjeve sanitare qe ndodhen jashte godines 4. Ndertimi i nje tualeti per kopshtin brenda godines. 5. Riparimi i kangjellave rrethuese dhe portes kryesore.
41	Shkolla Bilçë +Kopësht	Territori i shkollës ka nevojë për rrethim Çatia e shkollës ka nevojë për riparim të pjesshëm të tjegullave dhe ulluqeve . Shkallët në hyrje të shkolles kane nevoje për zevendsim te pllakave te thyera.
42	Shkolla Veterrik + kopësht	Shkolla eshte ne gjendje te mire
43	Shkolla Starovë + kopësht	Shkolla eshte ne gjendje te mire . Problematike eshte situata me kanalizimet ne oborrin e shkolles
44	kopshti Remanicë	Godina ka nevoje per hidroizolim. Shfrytezohet vetem nje pjese e objektit per grupin e kopshtit i cili eshte i mirëmbajtur vazhdimisht.
45	Shkolla Bardhaj i Ri + kopësht	Hidroizolim solete, ndertim sistem oxhakesh..
46	Shkolla Malinat	Rikonstruksion total., Ka kerkesa per hapjen e nje kopshti.
47	Shkolla Qoshk + kopësht	F.V dyer te brendshme dhe e jashtme e blinduar. Lyerje totale te klasave dhe fasades.
48	Kopshti Lapardha 2	Sistemim i terrenit dhe shtrim i oborrit me pllaka guri.
49	Kopshti Qëndër Lapardha	RIKONSTRUKSION TOTAL GODINA. Ambjenti i kopshtit eshte i mirembajtur.
50	Kopshti Dyshnik	Duhet ndertuar linje evecante elektrike per kopshtin, (e shkeputur nga shkolla)
51	Shkolla Dyshnik	RIKONSTRUKSION TOTAL . Shkolla ka lageshti prej catise dhe xokolit, degradim te shtresave te suvase. Duhen zevendesuar dyert dhe dritaret. Ka nevoje per lyerje totale.
52	Kopshti Ullinjas	Grupi I kopështi eshte ne gjendje te rregullt, I mirembajtur, me hapsira te medha, pa lageshti. Ne terresi te structures u vune re poblematika qe kryesisht jane si rezultat I forcave prerese (ulje ose rreshqitje dheu, forca sizmike, neglizhence ne zbatimin e projektit..) Ka ulje te dyshemese, zgjerime te fugave ndarese mes pllakave. Kerkohet nje ekspertize strukture.
53	Kopshti Orizaj	Eshte ne gjendje te mire
54	Shkolla Moravë	Shkolla eshte ne gjendje te mire.
55	Kopshti Moravë	Godina eshte e mbyllur si pasoje rrezikshmerie per jeten. Kopshti eshte transferuar ne nje ambjent me qera.
56	Kopshti Morave Hatillare	Lyerje totale fasade.
57	Shkolla Otllak + kopesht	Rikonstruksion total i godines. Riparim i catise, izolim i xokolit, sistem kullimi dhe drenazhimi. Punime rifinitura dhe suvatime te mureve, tavaneve. Riparim ne shtresen e dyshemese, shtrim me pllaka. Duhet bere F.V dyer dhe dritare, punime hidraulike dhe rehabilitim total i rrjetit elektrik.

58	Kopshti Stan Morave	Godina eshte ne gjendje te mire
59	Shkolla Qereshnik + Kopesht	Godina eshte e amortizuar dhe me lageshti . Duhet rikonstruksion total i godines.Duhen bere suvatime dhe lyerje totale. Sistemim i terrenit te jashtem.
60	Shkolla e mesme e bashkuar Lapardha	Hidroizolim solete + sistem kullimi. Suvatime te pjesshme dhe lyerje totale. Nderhyrje ne nyjet higjenosanitare. F.V dyer te reja. Rikonstruksion total ne dyshemen e katit te pare dhe pjeserisht ne katin e 4. Objekti ka ulje ne strukture si pasoje e aktivitetit sizmik dhe themeleve jo te perforcuar te cilen jane vazhdimisht ne kontakt lageshtie. Duhet bere nderhyrje ne sistemimin e territorit te jashtë, perforcimit te themeleve dhe linjes drenazhuese.

Burimi i krijimit të database janë : inspektimet nga drejtoria dhe sektori teknik i DA, informacion nga drejtorët e IA dhe përgjegjësit e sektorëve të DA.
Takime me grupet e interesit (prindërit, punonjesit mbështetës, specialistët e sektorit teknik etj.

Objektivi 2. Mbrojtja dhe mirëmbajtja e IA.

2.1 Mirëmbatjtja e sistemeve hidraulike dhe elektrike, mirëmbajtja e bazës materiale (punime marangozi) , lyerje dhe meremetime .

Gjatë 2 viteve të fundit është bërë ndryshim i ndjeshëm në sasi dhe në cilësinë e shërbimeve, duke patur parasysh gjendjen fizike të godinave , nga këto 20 godina kanë nevojë për rikonstruksion, 15 kanë nevojë për mirëmbajtje të thelluar, 29 kanë nevojë për mirëmbajtje të zakonshme. Synojmë rritjen e mëtejshme të këtyre shërbimeve.
Për virin 2022 planifikojmë të rrisim nr. e ndërhyrjeve elektrike në masën 30% dhe hidraulike 25%. Shërbimet e marangozit do të rriten në masën 33% për shkak të vënies në punë të sharrës kombinat.

2.2 Ndërtimi i mureve rrethues në 5 objekte, kryesisht në NJA e parashikuar në një vlerë totale 821.000 lekë. Ndërtimi I këtyre rrethimeve është domosdoshmëri për të rritur sigurinë në këto institucione. *Shih shtojca 2.*

2.3 Hidroizolimi I taracave dhe meremtimi çative të godinave për shmangjen e lagështisë , për të siguruar një mjedis të shëndetshëm. *Shih shtojca 2.*

Në vitin 2021 janë hidroizoluar taracat e 5 shkollave (Zihni Toska, 22 Tetori, Thimi Tani, Sinjë, 28 Nëntori dhe kopshti " 28 Nnëtori)". Hidroizolimi dhe sistemet e kullimit është planifikuar në 2022 për 4 godina të tjera (Shk.Ajet Xhindole, Shk. Rroshnik, Shk Lapardha, Mbjeshovë) Mirembajtje çatie dhe sisteme kullimi ne shkollën Dushnik. *Shih shtojca 2.*

2.4 Sigurimi i mbrojtjes së godinave nga zjarri

Do të bëhet kolaudimi dhe rimbushja e 200 fikseve të zjarrit dhe trajnim personeli në institucionet e arsimit.

Objektivi 3. Sigurimi I kushteve higjeno sanitare

Në përputhje më udhëzimet e Ministrisë së Shëndetsisë dhe të Ministrise se Arsimit Rinisë dhe Sporteve do të synohet :

3.1 Rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e nyjeve sanitare.

Në total janë **197 tualete** per tu mirembajtur ne te gjitha godinat . Në vitin 2019 u gjendëm përballë një situate skandaloze përsa I përket gjendjes së nyjeve sanitare në IA. Në **5** prej këtyre institucioneve tualet mungonin, tek të tjerat kishte mungesë ujë të rrjedhshëm , mungesë pajisje hidrosanitare dhe kanalizime të bllokuara dhe të amortizuara. Sot nuk ka asnjë institucion pa tualete. Janë bërë ndërhyrje të fuqishme në kanalizime në **7 shkolla** Moravë, Starovë, Lapardha, Qoshk, Bab Dudë Karbunarë, Ajet Xhindole , Kopshti 10 korriku etj. Në Njësitë Administrative 9 godina i kanë tualetet jashtë ndërtesës.

3.2 Furnizimi me ujë të rrjedhshëm.

Të gjitha godinat furnizohen me ujë. Aty ku nuk ka akses rrjeti I ujësjellësit janë siguruar kontrata furnizimi me subjekte private. (11 kontrata uji)

Në dhjetor 2021 shkollat Lapardha dhe Starovë u lidhën me rrjetin qëndror të ujësjellësit.

3.3 Furnizimi I mjaftueshëm me materiale pastrimi dhe dezinfektant.

Në situatën covid rëndësia e ruajtjes së higjenës se ambjenteve dhe asaj personale të fëmijëve ka qënë primare. Shpenzimet kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit për sigurimin e këtyre materialeve. Nga studimi I bërë është vënë re se nevojat janë 45 % më shumë se plani në total

Tabela nr.129

Nr.	Emërtimi	Planifikimi	Nevojat	Diferenca ne %
1	Materiale pastrimi	1,375,000	2,011,656	46.22
2	Materiale dezinfektimi	1,235,000	2,473,968	100
	Totali	**2,610,000**	**4,485,624**	**71.8**

3.4 Shërbimi DDD.

Për herë të parë u arrit të sigurohej shërbim DDD në vitin 2020 në të gjitha institucionet arsimore (**798990 m2 sipërfaqe e dezinfektuar**). Ky shërbim do vazhdojë të kryhet në cdo vit buxhetor.

Objekti 4. Sigurimi i ngrohjes.

Është parashikuar një rritje e kohës ditore të përdorimit të kaldajave dhe sobave (Nga 3 në 5 orë ngrohje në ditë , duke patur parasysh mësimin me turne që mund të praktikohet). Kjo kërkon një rritje prej 60 % të planit për ngrohjen me naftë dhe dru (drutë sigurohen nga Drejtoria e Bujqësisë).

Shkolla 22 Tetori dhe shkollat e mesme dhe ciklet e larta të të gjitha shkollave të tjera në qytet nuk kanë ngrohje . Në Njësitë Administrative kanë ngrohje me dru zjarri rreth 90% e tyre. Ka nevojë për zëvendësimin e 35 sobave të amortizuara.

.

4.1 Zëvendësimi i sobave të vjetra dhe shtimi i sobave të reja nëpër shkolla. *Shih shtojca 2.*

4.2Furnizimi I mjaftueshëm me lëndë djegësë, dru, naftë dhe pelet.

4.3 Mirëmbajtja, kontrolli teknik i kaldajave dhe certifikimi i personelit.

Ky është një detyrim ligjor që filloi të zbatohej vetëm në vitin 2021 dhe në vazhdim.

Objektivi 5. Ofrimi i një shërbimi cilësor për ushqyerjen e shëndetshme.

Ushqimi ofrohet në 4 kopshte , 4 cerdhe dhe në konvikt duke filluar nga data 15 mars 2021. Ofrimi I shërbimit të ushqimit ka patur impakt pozitiv te prindërit e fëmijvë si për sasinë ashtu edhe për cilësinë e ushqimit. Janë regjistruar deri në nëntor 2021 , 412 fëmijë në kopshte me drekë.

5.1 Plotësimi I nevojave për mirëmbajtjen e ambjenteve dhe pajisjeve elektroshtëpiake të kuzhinave. (9 kuzhina)
5.2 Plotësimi I nevojave me gaz të lëngshëm për gatim dhe energji elektrike.
5.3 Plotësimi me asortimente ushqimore sipas kontratës së lidhur.

Objektivi 6. Sigurimi I shërbimit cilësor për punonjësit e DA dhe komunitetin.

Numri i punonjësve për këtë program buxhetor është 252 punonjës (Administrata, sektori teknik, edukatorë kopshti, personeli mbështetës, punonësit e kuzhinës .)

Drejtoria Arsimore i ofron ish punonjësve të arsimit, punonjësve të saj, prindërve të fëmijëve, nxënës përfitues të bursave, shërbime të ndryshme administrative .

6.1 Sigurimi i bazës materiale me kompjutera, kancelari , dokumentacion, pajisje zyre etj.
6.2 Mirëmbajtja e 2 mjeteve të transportit në mbështetje të sektorit teknik dhe ushqimor, në vlerë prej 180 mijë lekë. Nevojat janë në rritje sepse : është shtuar nr. i makinave , makina e punëtoreve është e amortizuar me shumë probleme dhe është rritur ndjeshëm aktiviteti i shërbimeve .
6.3 Sigurimi I sasisë së mjaftueshme të karburantit.

Objektivi 7. Garantimin e mirërritjes dhe edukimit të fëmijëve në kopshte .

Drejtoria e Arsimit ka të gjithë përgjegjësinë për mbarëvajtjen e gjithë procesit mësimor dhe edukativ në kopshte si dhë ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik të fëmijëve.

7.1 Sigurimi I mjeteve didaktike të nevojshme për 1275 fëmijë kopshtesh .
7.2 Krijimi I një ambjenti komod, argëtues dhe edukativ .
7.3 Krijimi I klasave zhvillimore për një trajtim profesional të fëmijëve me AK.

Objektivi 8. Realizimi I investimeve të rëndësishme në infrastrukturë që kanë të bëjnë me rindërtime dhe rikonstruksione totale të shkollave. *Shih shtojca 2.*

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 9120 Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor është planifikuar në shumën 203,362 mijë lekë dhe zë 16.8% të buxhetit total.
Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 10,824 mijë lekë ose 6 %. Rritja bëhet në shpenzimet kapitale të cilat pothuajse dyfishohen në raport me planin e vitit 2021. Rritje ka edhe në shpenzimet për pagat , për arsye sepse është shtuar struktura me 4 punonjës.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 175,214 mijë lekë për 250 punonjës. Numri i punonjësve është rritur me 4 nga viti 2021. Në krahasim me planin e vitit 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 5,483 mijë lekë ose në masën 3.2 %.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 24,438 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me ulje në shumën 11,611 mijë lekë , pasi në vitin 2021 u programuan për likujdim detyrime të prapambetura.
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 3,710 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikar me rritje në shumën 1,745 mijë ose në masën 89%.
Në këtë program përfshihen 2 projekte :

1.Investime punime në objektet arsimore në Arsimin bazë dhe parashkollor në shumën 2,710 mijë lekë.

2.Blerje pajisje në Arsimin bazë dhe parashkollor, në shumën 1,000 mijë lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%, Shpenzimet kapitale programohen të jenë 11,500 mijë në vitin 2023 dhe 2,500 mijë në vitin 2024.

Shpenzimet e programit 091200 për vitin 2022 në 000 lekë
Tabela nr.130

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korren	Transf. per Buxhet.	Shp. Kapitale patrupe	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
9120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	250	**203,362**	150,353	24,861	24,438					3,710

Pasqyra e shpenzimeve operative analitike për vitin 2022 të programit 09120 : në 000 lekë
Tabela nr.131

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 11 mujor'21	I pritshem 2021	Plan 2022
6020	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**1,423**	**1,175**	**1,669**	**2,615**	**3,015**
6020	Kancelari+leter A4	0	160	327	480	250
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim	537	351	712	1,400	1,200
6020	Materiale per ngrohje, pelet	117	235	256	300	400
6020	Materiale per funksion. Tonera + fikse zjarri	769	169	239	250	500
6020	Blerje dokumentacioni		260	65	65	65
6020	Furnizime dhe materiale te tjera zyre/mjete didaktike		0	70	120	600
6021	**Materiale dhe sherbime speciale**	**4,767**	**3,769**	**16,538**	**19,950**	**14,180**
6021	Veshje profesionale pune			100	150	
6021	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencat	4,767	3,769	13,863	16,500	12,080

6021	Furnizim me gaz te lengshem per gatim		0	342	400	300
6021	materiale te tjera (mat elektrike, hidraulike, zdrukthari,boje, lyerje, ndertimi) Ene Guzhine			2,233	2,900	1,800
6021	materiale te tjera/covid 19		1,912			-
6022	**Sherbime nga te trete**	**2,864**	**4,122**	**4,837**	**6,010**	**2,680**
6022	Elektricitet	1,215	2,469	2,621	3,500	1,100
6022	Uje	1,556	1,558	1,725	2,000	1,050
6022	Sherbim per telefon			134		-
6022	Sherbime posta	0	5	7	10	30
6022	Materiale per dezinfektim/DDD			200	200	450
6022	Te tjera sherbime nga te trete	93	90	150	300	50
6023	**Shpenzime transporti**	**643**	**1,986**	**1,043**	**1,284**	**1,053**
6023	Karburant dhe vaj	600	1,886	893	1,200	943
6023	Pjese kembimi, goma dhe bateri		100	150	84	110
6024	**Shpenzime udhetimi**	**0**	**0**	**0**	**0**	**-**
6024	Udhetim i brendshem.					-
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**647**	**542**	**952**	**2,240**	**1,010**
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore. Sh. Hidroizolim			834	1,500	700
6025	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore,rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	473	542		500	-
6025	Shp. per miremb. e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes, kaldaja			118	120	150
6025	Shpenzime per mirembajtjen e mjeteve te transportit	174			120	160
6026	**Shpenzime per qiramarrje**	**799**	**1,203**	**911**	**1,300**	1,000
6026	Shpenzime per qiramarrje ambjentesh	799	1,203	911	1,300	1,000
6029	**Shpenzime te tjera operative**	**1,428**	**1,833**	**206**	**2,650**	**1,500**
6029	Shpenzime per honorare	1,375	1,763	0	1,850	1,400
6029	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime op, blerje pelhure			150	300	
6029	Shpenzime per te tjera materiale dhe sherbime op. Internet, mirembajtje dhe ripoarime te ndryshme etj	53	70	56	500	100
	Total	**12,571**	**14,630**	**26,156**	**36,049**	**24,438**

Shpenzimet e Programit 09120 sipas Kategorive ekonomike
Tabela nr.132

		PBA	2022-2024
Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**		
Bashkia	**Berat**		
Programi	09120	**Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor.**	

Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
		Shpenzimet e Programit (000 ALL)						
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	130,029	130,509	135,747	138,933	150,353	154,864	159,509
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	21,595	21,854	22,446	22,973	24,861	25,607	26,375
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	12,572	15,822	31,780	34,662	24,438	25,171	25,926
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**	268	603	600	744			
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**	18,155	29,890	1,965	11,965	3,710	11,500	2,500
TOTALI		**182,619**	**198,679**	**192,538**	**209,277**	**203,362**	**217,142**	**214,311**

Projektet e Investimeve të Programit 09120

Tabela nr.133 në 000 lekë

Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Mirembajtje dhe riparime ne kopeshtin dhe Cerdhen 2+3 lagja Barrikade, lagja M. Celebiu	Fondet e veta	3,778	170					
Rikonstruksion Shkolla "1 Maji" + Superv. + Kolaud.	Fondet e veta	58,150	17,014	27,000	10,236			
Investime, punime ne objektet arsimore ne arsimin baze dhe parashkollor	Fondet e veta					2,710	10,500	2,500
Punime riparimi ne shkollen "Thimi Tani"	Fondet e veta	678			679			
Pajisje gatimi per konviktet cerdhet dhe kopshtet	Fondet e veta	2,435			694			
Pajisje Drejtoria Arsimore, Bashkia Berat	Fondet e veta	3,861	971	2,890		1,000	1,000	
Blerje mjet frigoriferik Dr. Arsimore	F.e veta	756			356			
Blerje mjet frigoriferik Dr. Arsimore	F. e veta	756			800			

15. PROGRAMI 09230 PROGRAMI I ARSIMIT TË MESËM TË PËRGJITHSHËM

Përshkrimi i programit
Ky program parashikon ndërhyrjet për ndërtimin e rikonstruksionin e objekteve shkollore te arsimit të mesëm të përgjithshëm, pajisjen dhe kompletimin e tyre pjesërisht me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme

Politika e programit
Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës arsimore dhe kushteve të mësimdhënies me synim arritjen e standarteve optimale bashkëkohore në IA.

Objektivat e programit , performance, problematikat dhe produktet që kontribuojnë në arritjen e objektivave :

Objektivi 1. Vlerësimi i nevojave dhe studimi i prioriteteve afatmesme dhe afatgjata si dhe studimi i përmirësimit të infrastrukturës arsimore në Berat, duke përfshirë investime dhe mirëmbajtje të IA.
Janë 8 shkolla të mesme, 2 prej të cilave janë gjimnaze të përgjithshme. Numri i nxënësve që frekuentojnë shkollat e mesme është 1494. Për numrin total të godinave të shkollave të mesme referojuni tabelës përkatëse të objektivit 1 të programit buxhetor 09120.

1.1.Ndërhyrja me investime në arsimin e mesëm të përgjithshëm për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e objekteve përkatëse
Investime për krijimin e lehtësirave për nxënësit AK (si ndërtim rampe etj..)
Ndërhyrje për plotësimin e infrastrukturës së brendshme dhe të jashtme dhe për pajisjen me të gjithë elementët e nevojshëm, duke krijuar një infrastrukturë argëtuese dhe edukuese për nxënësit.

Objektivi 2. Mbrojtja dhe mirëmbajtja e IA.

2.1 Mirëmbajtja e sistemeve hidraulike dhe elektrike, mirëmbajtja e bazës materiale (punime marangozi) , lyerje dhe meremetime .
Gjatë 2 viteve të fundit është bërë ndryshim i ndjeshëm në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve, duke patur parasysh gjendjen fizike të godinave , nga këto 1 godinë ka nevojë për rindërtim, 3 godina kanë nevojë për rikonstruksion, 2 kanë nevojë për mirëmbajtje të thelluar, 2 kanë nevojë për mirëmbajtje të zakonshme. Synojmë rritjen e mëtejshme të këtyre shërbimeve.
Për 2022 planifikojmë të rrisim nr. e ndërhyrjeve elektrike në masën 30% dhe hidraulike 25%

2.2 Hidroizolimi i taracave dhe meremtimi i çative i 4 godinave për shmangjen e lagështisë , për të siguruar një mjedis të shëndetshëm.
Për vitin 2021 u krye ndërhyrje në shkollën e mesme Sinjë.
Për vitin 2022 do të bëjmë hidroizolime në 3 shkolla të mesme. *Shih tabela D, shtojca 2.*

2.3 Sigurimi i mbrojtjes së godinave nga zjarri.
Do të bëhet rimbushja e fikseve të zjarrit dhe trajnimi i personelit.

Objektivi 3. Sigurimi i kushteve higjieno sanitare
Në përputhje më udhëzimet e Ministrisë së Shëndetsisë dhe MASR

3.1 Mirëmbajtja e nyjeve sanitare.
Do të kryhet mirëmbajtja e tyre në të gjitha godinat e shkollave të mesme.

3.2 Furnizimi i mjaftueshëm me materiale pastrimi dhe dezinfektant.
Në situatën covid rëndësia e ruajtjes së higjenës se ambienteve dhe asaj personale të nxënësve ka qënë primare. Shpenzimet kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit për sigurimin e këtyre materialeve.

3.3 Shërbimi DDD.
Për herë të parë u arrit të sigurohej shërbim DDD në vitin 2020 në të gjitha institucionet arsimore. Ky shërbim do vazhdojë të kryhet në cdo vit buxhetor.

Objekti 4. Sigurimi i ngrohjes.

Sigurimi i ngrohjes në shkollat e mesme mungon në 7 prej tyre. Vetëm shkolla Starovë ka ngrohje qëndrore me kaldajë

4.1 Blerja e sobave te reja . Zgjidh rreth 30 % të nevojave të shkollave të mesme.

4.2 Furnizimi i mjaftueshëm me lëndë djegëse me dru dhe naftë .

4.3 Mirëmbajtja, kontrolli teknik i kaldajave dhe çertifikimi i personelit.
Ky është një detyrim ligjor që filloi të zbatohej vetëm në vitin 2021 dhe në vazhdim.

Objektivi 5. Realizimi i investimeve të rëndësishme në infrastrukturë që kanë
të bëjnë me rindërtime dhe rikonstruksione totale të shkollave. Problematikë më e madhe është shkolla Bab Dudë Karbunara. *Shih shtojca 2.*

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 9230 është planifikuar në shumën 15,836 mijë lekë dhe zë 1.3 % të buxhetit total.
Në krahasim me vitin 2021 buxheti i vitit 2022 për këtë program është rritur me 1,849 mijë lekë ose 13%. Rritja bëhet në shpenzimet kapitale të cilat kanë një rritje prej 135 % në raport me planin e vitit 2021.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 11,725 mijë lekë për 20 punonjës. Numri i punonjësve nuk pëson ndryshime nga viti 2021.
Shpenzime operative (art. 602) janë planifikuar në shumën 2,821 mijë lekë. Në krahasim me vitin 2021 janë planifikuar me rritje në shumën 481 mijë lekë ose 21% .
Shpenzime kapitale (art. 230&231) janë planifikuar në shumën 1,290 mijë lekë.
Në këtë program përfshihen 1 projekte:
1.Investime punime ne objektet arsimore ne Arsimin e mesëm të përgjithshem, në shumën 1,290 mijë lekë.

Për vitet 2023 dhe 2024 shpenzimet korrente të këtij programi janë planifikuar me rritje 3%.
Shpenzimet kapitale janë programuar në shumën 1,000 mijë në secilin prej viteve 2023,2024.

Shpenzimet e programit 09230 për vitin 2022
Tabela nr.134 në 000 lekë

Kod progr.	Emertimi i Programit	nr i punonjesve	Buxhet 2022	Paga	Sig. Shoqërore	Mallra&Shërbime	Subvencione	Transf. korren	Transf. per Buxhet.	Shp. Kapitale patrupe	Shp. Kapitale te trupezuara
				600	601	602	603	604	606	230	231
9230	Arsimi parauniversitar	20	15,836	10,061	1,664	2,821					1,290

Pasqyra e shpenzimeve operative analitike të programit 09230 :

Tabela nr.135 në 000 lekë

Art.	Emertimi	Fakt 2019	Fakt 2020	Fakt 11 mujor 2021	I pritshmi 2021	Plan 2022
6020	**Materiale zyre dhe te pergjithshme**	**397**	**185**	**360**	**400**	**150**
6020	Materiale per pastrim, dezinfektim	397	185	360	400	150
6021	**Materiale dhe sherbime speciale**	**58**	**474**	**440**	**440**	**750**
6021	Furnizime dhe sherbime me ushqim per mencat	58				0
6021	materiale te tjera	0		440	440	750
6021	materiale te tjera/covid-19		474			0
6022	**Sherbime nga te trete**	**993**	**1,230**	**1,359**	**1,410**	**1,689**
6022	Elektricitet	724	792	879	910	1,039
6022	Uje	269	438	430	450	600
6022	Sherbim dezinfektim DDD			50	50	50
6023	**Shpenzime transporti**	**399**	**50**	**108**	**310**	**202**
6023	Karburant dhe vaj	399	50	108	310	202
6024	**Shpenzime udhetimi**	**0**			**0**	-
6025	**Shpenzime per mirembajtje te zakonshme**	**20**	**90**	**0**	**0**	30
6025	Shpenzime per mirembajtjen e objekteve ndertimore.	20				-
6025	Shpenz.per miremb.e rrugeve, veprave ujore,rrjeteve hidraulike, elektrike, telefonike, ngrohje etj	0	90			-
6025	Shp. per miremb. e aparateve, paisjeve teknike dhe veglave te punes, kaldaja	0				30
6026	**Shpenzime per qiramarrje**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**
6029	**Shpenzime te tjera operative**	**0**	**26**	**0**	**0**	**0**
6029	Tarife permbarimi		26			
602	**Total**	**1,867**	**2,055**	**2,267**	**2,560**	**2,821**

Shpenzimet e Programit 09230 sipas Kategorive ekonomike

Tabela nr.136

PBA 2022-2024

Raport	**Shpenzimet Totale të Programit sipas Kategorive Ekonomike**
Bashkia	**Berat**
Programi	09230 **Arsimi i mesëm i përgjithshëm.**

Shpenzimet e Programit (000 ALL)								
Emri i Artikullit	Kodi i Artikullit	2019 Fakt	2020 Fakt	2021 Buxhet Fillestar	2021 Buxhet i Pritshëm	2022 Plani	2023 Plani	2024 Plani
Paga dhe Sigurime								
Paga	**600**	9,710	9,445	9,994	9,994	10,061	10,363	10,674
Sigurime Shoqërore & Shëndetësore	**601**	1,569	1,548	1,653	1,653	1,664	1,714	1,765
Korente								
Mallra dhe Shërbime	**602**	1,867	2,055	2,340	2,560	2,821	2,906	2,993
Subvencion	**603**							
Transferta të Brendshme	**604**							
Transferta të Jashtme	**605**							
Transferta për Familje & Individë	**606**							
Shpenzime Kapitale								
Aktive të Paprekshme	**230**							
Aktive të Prekshme	**231**				549	1,290	1,000	1,000
TOTALI		**13,146**	**13,049**	**13,987**	**14,756**	**15,836**	**15,982**	**16,432**

Projektet e Investimeve të Programit 09230

Tabela nr.137 në 000 lekë

Emërtimi i projektit	Burimi i Financimit	Vlera e kontratës	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Punime riparimi ne shkollat e mesme	Fondet e veta				549	1,290	1,000	1,000

16. PROGRAMI 09240 ARSIMI I MESËM PROFESIONAL

Përshkrimi i programit :

Ky program parashikon ndërhyrjet për krijimin e kushteve sa më të përshtatshme të qëndrimit të konviktorëve, kompletimin e ambienteve me bazë materiale, si dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të godinave të konvikteve.

DA kujdeset për 2 godina konviktesh , konvikti i Industriales dhe konvikti Kristo Isak. Shfrytëzohet për akomodim vetëm 1 prej tyre, konvikti Kristo Isak . Ky konvikt është rikonstruktuar në vitin 2019.

Politika e programit :

Konsiston në përmirësimin e infrastrukturës së konvikteve për kushte më të mira të akomodimit dhe shërbim ushqimor me cilësi

Objektivat e programit, performanca, problematikat dhe produktet që kontribuojnë në arritjen e objektivave :

Objektivi 1. Vlerësimi i nevojave dhe studimi i prioriteteve afatmesme dhe afatgjata, për mirëmbajtje , krijimi i kushteve akomoduese dhe shërbim ushqimor cilësor.

Objektivi 2. Mbrojtja dhe mirëmbajtja e IA.

2.1 Mirëmbajtja e sistemeve hidraulike dhe elektrike, mirëmbajtja e bazës materiale (punime marangozi) , lyerje dhe meremetime .

Godina e konviktit është rikosntruktuar e plotë në vitin 2019 .

2.2 Sigurimi i mbrojtjes së godinave nga zjarri (materiale dhe trajnim punonjësve ndihmës në shkolla)

Objektivi 3. Sigurimi i kushteve higjieno sanitare
Në përputhje më udhëzimet e Ministrisë së Shëndetsisë dhe të MASR.

3.1 Furnizimi i mjaftueshëm me materiale pastrimi dhe dezinfektant.
Në situatën covid rëndësia e ruajtjes së higjienës së ambienteve dhe asaj personale të nxënësve konviktorë ka qënë primare. Shpenzimet kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit për sigurimin e këtyre materialeve .

3.2 Shërbimi DDD.
Për herë të parë u arrit të sigurohej shërbim DDD në vitin 2020 në të gjitha institucionet arsimore. Ky shërbim do vazhdojë të kryhet në çdo vit buxhetor.

Objekti 4. Sigurimi i kushteve për ngrohje me metoda alternative bashkëkohore.
Pavarësisht rikonstruksionit, ngrohja mbetet problem i pazgjidhur. Nxënësit ngrohen me furnela elektrike. Kaldaja e amortizuar përdoret për ngrohjen e ujit të dusheve. Synojmë sigurimin e ngrohjes me panele diellore. Ky investim planifikohet të realizohet nëpërmjet të ardhurës së trashëguar e cila është e konsiderueshme.

4.1 Mirëmbajtja, kontrolli teknik i kaldajave dhe çertifikimi i personelit.
Ky është një detyrim ligjor që filloi të zbatohej vetëm në vitin 2021 dhe në vazhdim.

4.2 Planifikohet të instalohet panel diellor që do të mundësojë ngrohjen e ujit dhe të ambientit.

Objektivi 5. Ofrimi i një shërbimi cilësor për ushqyerjen e shëndetshme.

Ushqimi ofrohet në konvikt duke filluar nga data 15 mars 2021. Ofrimi i shërbimit të ushqimit ka patur impakt pozitiv te prindërit e fëmijvë si për sasinë ashtu edhe për cilësinë e ushqimit. Janë 28 nxënës konviktorë të regjistruar.

5.1 Plotësimi i nevojave të ambienteve për mirëmbajtjen e kuzhinave.
5.2 Plotësimi i nevojave me gaz të lëngshëm për gatim dhe energji elektrike.
5.4 Plotësimi me asortimente ushqimore sipas kontratës së lidhur.

Objektivi 6. Krijimi i një ambienti komod, argëtues dhe edukativ .

Planifikojmë të kryejmë një investim në lidhje me ndërtimin e sallave të studimit, bibliotekë, dhoma ndenjëje etj.
Ky investim planifikohet të realizohet nëpërmjet të ardhurës së trashëguar e cila është e konsiderueshme.

Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit

Buxheti i vitit 2022 për programin 09240 është planifikuar në shumën 27,665 mijë lekë dhe zë 2.3% të buxhetit total.
Ky program financohet tërësisht me transfertën sektoriale. Në mbyllje te vitit 2021 bashkia trashëgon në vitin 2022 një shumë të konsiderueshme (prej vitesh) , e cila do të rialokohet për shtimin e buxhetit të zërave të shpenzimeve operative të mirëmbajtjes dhe per shpenzime kapitale në këtë program buxhetor.

Për vitin 2022:
Shpenzime për paga & sigurime (art. 600+601) janë planifikuar në shumën 11,049 mijë lekë për 18 punonjës. Numri i punonjësve nuk pëson ndryshime nga viti 2021.
